# Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (157) / 2019. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!
në Peshkopi vjen me super oferta!


Profil

## Shaban Bitri, njeriu i urave dhe digave të mëdha

Nga **SHAQIR SKARRA**


16

Reportazh

## Maqellara, vendi i njerëzve pozitivë

Nga **DIONIS XHAFA**


14

Sport

## Golloborda, aty ku mundja kthehet në festë!

Nga **DEFRIM METHASANI**


21

**PROJEKTI:** TUNELI PARASHIKON MARRJEN E MASAVE TË SIGURISË SIPAS STANDARDEVE EUROPIANE. NË RASTE EMERGJENCE APO ZJARRI NË TUNEL AI U MUNDËSON PLOTËSISHT UDHËTARËVE TË LËNË MJETET E TYRE DHE TË SHKOJNË NË NJË VEND TË SIGURT, NDËRKOHË QË GARANTON AKSES TË SHPEJTË TË EKIPEVE TË ZJARRFIKËSAVE DHE TË SHPËTIMIT.

# Tuneli i Murrizit: ndërpriten përkohësisht punimet në Zall Bastar, nisin në Xibër

- "Pritej, pasi terreni në njërin nga tunelet ka qëlluar shumë i rrëshqitshëm. Gjithashtu, edhe shirat e ditëve të fundit nuk kanë favorizuar vazhdimin e punimeve dhe për sigurinë e punonjësve tanë puna është ndërprerë".
- "Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Shembja ka ndodhur rreth 2 javë më parë dhe ishte e pritshme. Formacioni në hyrje të tunelit të Murrizit është shumë i dobët. Për momentin puna është ndërprerë përkohësisht nga ana e Tiranës, pasi ndërkohë po kryejmë disa studime".
- Prof. Bashkim Lleshi: Shembja nuk ka ndodhur për arsye gjeologo-teknike, por për moszbatim të teknikës së avancimit të tuneleve, ndoshta për përdorje mbi masën e duhur të lëndës eksplozive. Duke komentuar fotografitë e përhapura në media, ai thekson për gazetën "Rruga e Arbërit" se shembja e ndodhur në mes të majit nuk përbën argument për ndërprerjen e punimeve.

FAQE 2-3

KONFERENCA SHKENCORE / STUDIMI

# Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit

të Njësive Administrative të Peshkopisë, Kastriotit, Çidhnës, Lurës, Dardhës, Reçit, Sllovës, Kalasë së Dodës, Tominit dhe Melanit – me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, turizmit malor e Historik

*Autorë:* **VESEL HOXHA**, ***Bashkim Lleshi, Bardhok Rajta, Hajredin Toca, Ali Hoxha, Mustafa Tola, Osman Xhili***



Konferenca shkencore me temë: ***"Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit historik e malor në Qarkun e Dibrës"***, thirret në momentin e duhur dhe historik. Problemet që do të lindin dhe përspektivat që do të hapen pas ndërtimit të Rrugës së Arbërit, do të jenë të mëdha e të shumanshme, realizimi i të cilave do ta zhvilloj më tej rajonin duke e ngritur në një stad të ri të përparimit ekonomik. Duke sjellë në këtë konferencë gjendjen e rrugëve të brendshme brenda njësive përkatëse administrative, përmirësimet që kërkohen apo propozimet për ndërtimin e akseve të reja, aty ku ata mungojnë për t'u lidhur me aksin e Rrugës së Arbërit, do ti shërbehet e do ti paraprihet të ardhmes së zhvillimit të ekonomisë në tërësi, bazuar në pasuritë nëntokësore e mbitokësore të njohura dhe atyre që mund të gjenden si dhe pasurive ujore, pyjore, kullotave, tokave arë për prodhimet bujqësore e frutikulturën, zhvillimin e mëtejshëm të turizmit historik e malor duke evidentuar e propoganduar vendet historike të zonës, monumentet e natyrës dhe pejsazhet mahnitëse që natyra ja ka falur Qarkut të Dibrës e, veçanërisht, rajoneve që do të përfitojnë drejtpërdrejt nga ndërtimi i kësaj rruge jetike për ta.

**(SPECIALE NË FAQEN 4-9)**

**NË BRENDËSI:**


- Një udhëtim në **Zall-Dardhë**, bahçen e artistëve
- **Turi i Korabit**, mali më i lartë në Shqipëri
- **Shefik Fisniku**, një jetë mes eksperimenteve
- **Murat Koltraka,** stërnipi i Kastriotëve…
- Vëllezërit Xhaferri: **Isufi** dhe **Hamiti**
- **Ramadan Perhati,** luftoi si spartan, jetoi si skllav
- Shqipëria me syrin e **Justin Godart**
- Dr. **Bajram Ndreu** njeriu që flet me heshtjen e tij!
- TREGIM ALEGORIK: **Takimi me belanë**
- Nderim për **tre dëshmorët** e Tërnovës
- Dëshmori **Klodian Tanushi**
- **Qemal Xhafa,** mbetesh fisnik dhe madhështor në kujtesën tonë


**Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe**

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të shkruajnë email në adresën <rrugaearberit@gmail.com>

**Redaksia e gazetës ju uron Gëzuar Fitër Bajramin!**

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.



Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 5 (157). Maj 2019
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Qershor 2019.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.
Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
**GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.**
**JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".**
Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Vesel HOXHA
Defrim METHASANI
Bashkim LLESHI
Bernard ZOTAJ
Xhafer MARTINI
Qeram LLESHI
Dionis XHAFA
Selman MËZIU
Ilmi DERVISHI
Isuf MIHA
Eduart RAMÇI

**KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE**

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

# Tuneli i Murrizit: ndërpriten

"Pritej, pasi terreni në njërin nga tunelet ka qëlluar shumë i rrëshqitshëm. Gjithashtu edhe shirat e ditëve të fundit nuk kanë favorizuar vazhdimin e punimeve dhe për sigurinë e punonjësve tanë puna është ndërprerë".

"Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Shembja ka ndodhur rreth 2 javë më parë dhe ishte e pritshme. Formacioni në hyrje të tunelit të Murrizit është shumë i dobët. Për momentin puna është ndërprerë përkohësisht nga ana e Tiranës, pasi ndërkohë po kryejmë disa studime".


*Pamje nga kantieri i Tunelit të Murrizit. Foto e datës 1 qershor 2019*

Nga **BUJAR KAROSHI**

Më 16 maj kryeministri Edi Rama postoi një video nga punimet në Rrugën e Arbërit, ashtu siç e ka bërë zakon që kur nisën punimet në pranverën e vitit të kaluar, duke iu uruar shqiptarëve mëngjesin e 16 majit dhe duke treguar punimet.

Në sekondën e 25-të të videos shfaqen pamje të punimeve të njërit nga tunelet e Murrizit, ndërkohë që në brendësi të tunelit tjetër, që është edhe kryesori, ka ndodhur një shembje.

Lajmi i shembjes u përhap në fillim si teori konspiracioni në rrjetet sociale, me burime të paidentifikuara brenda punonjësve të kompanisë, ndërkohë që nuk pati asnjë reagim zyrtar as nga kompania dhe as nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Ndërsa mëngjesin e së shtunës, më 1 qershor, shumica e mediave të Tiranës, kryesisht online, treguan disa foto nga shembja e tunelit, pa specifikuar se për cilin tunel bëhej fjalë. Fotot që shfaqeshin gjithkund si ekskluzive, ishin të njëjta.

Pas këtij lajmi, nga një vëzhgim në terren, mësuam se shembja ka ndodhur në brendësi të tunelit kryesor, në një segment të izoluar prej 15 metra, por kjo nuk është aq problematike saç shkruanin mediat.

Megjithëse ora ishte 16:30 e datës 1 qershor, disa punëtorë ishin në kantier, por punimet në brendësi ishin ndërprerë.

Një punonjës i kompanisë, që na pret në hyrje të tunelit, tregon se ka një shembje në brendësi dhe po punohet për pastrimin.

"Pritej, - tha ai, - pasi terreni në njërin nga tunelet ka qëlluar shumë i rrëshqitshëm. Gjithashtu edhe shirat e ditëve të fundit nuk kanë favorizuar vazhdimin e punimeve dhe për sigurinë e punonjësve tanë puna është ndërprerë".

Për arsye sigurie nuk u lejuam të verifikojmë terrenin. Përmes telefonit, një punonjës i kompanisë, në mirëbesim na premtoi se ishte i gatshëm të negocionte që në ditët në vazhdim, specialistë të kompanisë të na shoqëronin në kantier, por për këtë duhet të njoftojmë më parë.

"Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, - tha ai përmes telefonit. Shembja ka ndodhur rreth 2 javë më parë dhe ishte e pritshme. Formacioni në hyrje të tunelit të Murrizit është shumë i dobët. Për momentin puna është ndërprerë përkohësisht nga ana e Tiranës, pasi ndërkohë po kryejmë disa studime".

Përmes burimeve të informacionit pranë drejtuesve të kompanisë mësuam se puna vërtet është ndërprerë në Zall Bastar, por vazhdon normalisht në kantieret e tjerë të rrugës. "Nga ana tjetër e tunelit të Murrizit, në Xibër, kanë filluar punimet dhe puna po ecën shumë mirë".

Burime pranë kompanisë thonë se deri më tani janë hapur 5 tunele të vegjël të Rrugës, nga 350-500 metra, ku në dy prej të cilëve kanë përfunduar edhe armaturat.

Problematikat që shoqërojnë ndërtimin e Tunelit të Murrizit nuk janë të panjohura për publikun. Ato janë përdorur vite më parë si shkak për të argumentuar vonesat në fillimin e punimeve në Rrugën e Arbrit. Por, prof. Bashkim Lleshi, njëri nga anëtarët e grupit të studimit të fizibilitetit, ka qenë njëri nga oponentët kryesore, i cili ka argumentuar se formacionet gjeologjike të terrenit nuk janë argument për ngritjen e lartësisë së tunelit, rrjedhimisht shkurtimin e gjatësisë së tij, duke dëmtuar cilësinë e rrugës.

Duke komentuar fotografitë e përhapura në media, ai thekson për gazetën "Rruga e Arbërit" se shembja e ndodhur në mes të majit nuk përbën argument për ndërprerjen e punimeve.

"Shembja nuk ka ndodhur për arsye gjeologo-teknike, por për moszbatim të teknikës së avancimit të tuneleve, ndoshta për përdorje mbi masën e duhur të lëndës eksplozive", thotë gjeologu Bashkim Lleshi.

Sipas prof. Bashkim Lleshi, "në zonën pas Malit të Dajtit janë hapur me qindra metra tunele të ushtrisë në po të njëjtat formacione, pa armaturë, të cilët kanë shërbyer për depozitimin e rezervave të ushtrisë dhe janë në gjendje pune edhe sot. Është e pajustifikueshme ndërprerja e punimeve në këto formacione gjeologjike, kur specialistët tanë të minierave (ndërtimit të minierave) kanë drejtuar dhe hapur mijëra metra tunele në formacione më të vështira gjeologjike se këto të tunelit të Murrizës, si në Qafë Thanë me formacione të paqëndrueshme gjeologjike dhe prurje të mëdha uji, apo mbi 7 km tunel nga Shëngjuni në thellësi të Bulqizës me prurje të mëdha uji etj. Në këto formacione janë hapur mijëra metër linear tunele në rrugën Janinë - Selanik".

**EKSKURSION NË KANTIER: SI PO ECIN PUNIMET?**

Një muaj më parë, më datë 20 dhe 27 mars, një grup nga Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" e vizituan kantierin, në një ekskursion që kishte qëllim të shikonte në terren ecurinë e punimeve. Grupi prej 30 vetash, i udhëhequr nga ing. Bashkim Lleshi, njëri nga anëtarët e grupit të studimit të fizibilitetit si dhe aktivistë, më datë 20 mars ndoqën punimet te Ura e Vashës dhe tre tunelet pranë saj, si dhe rrugën që kalon nëpër Gjoricë, përfshirë edhe dy urat, atë mbi lumin Drin dhe Zalli i Bulqizës. Ndërsa më 27 mars, megjithëse një ditë me shi, mbi 45 vetë u bashkuan për ekskursionin e dytë në Rrugën e Arbrit, në dalje të Tiranës deri te tuneli i Murrizit.

Qëllimi i ekskursioneve ishte vrojtimi i ecurisë së punimeve të Rrugës së Arbërit, pasi më 12 maj 2019, Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" mbajti në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë një konferencë me temë "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit historik e malor në Qarkun e Dibrës".

Konferenca u fokusua kryesisht në zhvillimin e degëve të ekonomisë, sidomos për zhvillimin e turizmit, bujqësisë e blegtorisë, të cilët nuk kanë pasur një zhvillim të qëndrueshëm për shkak të infrastrukturës rrugore. Në referatet që u mbajtën, u përshkrua gjendja e rrugëve brenda njësive administrative të Dibrës, përmirësimi dhe ndërtimi i tyre për t'u lidhur me aksin kryesor të Rrugës së Arbrit, për t'i shërbyer në të ardhmen zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë, duke përshkruar shkurt pasuritë nën tokësore e mbitokësore, pasuritë minerale, ujore, pyjore, kullotat, tokat arë për prodhimet bujqësore e frutikulturën, dhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit historik e malor, vendet historike të zonës dhe gjeomonumentet, hidromonumentet, biomonumentet dhe bukuritë e tjera natyrore që i ka falur natyra këtyre zonave të begata.

Konferenca theksoi nevojën e shtrirjes së Rrugës së Arbërit në territorin e Maqedonisë së Veriut, nga Bllata në Dibër të Madhe, Mavrovë e Gostivar.

Në përshëndetjen që i bëri konferencës, ing.Shaban Bitri, i vlerësoi punimet në terren.

"Njëra nga ëndrrat shekullore të dibranëve, Rruga e Arbërit, duket se po bëhet realitet. Me gjithë vështirësitë e deritanishme, raportet nga terreni tregojnë se mbi 30% e punimeve ka mbaruar, kështu që duket se nuk ka kthim pas. Brenda 2-3 viteve ne do të fillojmë të lëvizim në atë rrugë, e bashkë me të edhe potencialet ekonomike që Dibra mban brenda", theksoi Bitri.

Duke vënë theksin se kjo konferencë kishte synim orientimin e investimeve të ardhshme publike dhe private në ekonominë e Dibrës, ai u ndal edhe te akuzat që i bëhen

**Prof. BASHKIM LLESHI: "Shembja nuk ka ndodhur për arsye gjeologo-teknike, por për moszbatim të teknikës së avancimit të tuneleve, ndoshta për përdorje mbi masën e duhur të lëndës eksplozive. Duke komentuar fotografitë e përhapura në media, ai thekson për gazetën "Rruga e Arbërit" se shembja e ndodhur në mes të majit nuk përbën argument për ndërprerjen e punimeve**

# punimet në Zall Bastar, nisin në Xibër

**"Anëtarët e Shoqatës sonë kanë qenë të shqetësuar për standardet e ndërtimit të rrugës dhe për këtë janë përpjekur të krijojnë gjithmonë një rrugë komunikimi me institucionet përgjegjëse qeveritare. Raporti i specialistëve tanë për devijimet e vazhdueshme të projektimit, pikat kyçe ku duhej ndërhyrë në projekt për përmirësimin e cilësisë së rrugës, e cila u është dërguar zyrtarisht këtyre institucioneve 6 vite më parë, nuk u mor parasysh, por ne shpresojmë që një pjesë të atyre problematikave t'i kenë gjetur dhe përmirësuar inxhinierët e kompanisë që po ndërtojnë rrugën".**

shoqatës për bashkëpunim me qeverinë si dhe te mbështetja indirekte që shoqata i jep kompanisë ndërtuese.

"Do të ishim të kënaqur që në këtë veprimtari apo edhe në të tjerat në të ardhmen, jo vetëm shoqata jonë, por të gjithë shoqatat e tjera të kishin bashkëpunim me qeverinë apo institucionet qeveritare. Kjo nuk është mëkat, përkundrazi, tregon vullnetin e mirë se kur jemi bashkë, pavarësisht bindjeve, mund të bëhen gjëra të mira për vendin. Por fatkeqësisht, në këtë veprimtari nuk ka asnjë ndikim qeveritar. Në këtë konferencë është vullneti i mirë i anëtarëve të saj, i kryesisë së Shoqatës, për të zhvilluar një konferencë shkencore për të vënë pikat mbi "i" mbi atë se ku duhet të përqendrohen investimet qeveritare, që Dibra, qytetarët e saj dhe gjithë shqiptarët ta ndjejnë menjëherë përfitimin ekonomik", - tha ing.Shaban Bitri gjatë fjalës së tij.

"Anëtarët e Shoqatës sonë kanë qenë të shqetësuar për standardet e ndërtimit të rrugës dhe për këtë janë përpjekur të krijojnë gjithmonë një rrugë komunikimi me institucionet përgjegjëse qeveritare. Raporti i specialistëve tanë për devijimet e vazhdueshme të projektimit, pikat kyçe ku duhej ndërhyrë në projekt për përmirësimin e cilësisë së rrugës, e cila u është dërguar zyrtarisht këtyre institucioneve 6 vite më parë, nuk u mor parasysh", tha Bitri, por ne shpresojmë që një pjesë të atyre problematikave t'i kenë gjetur dhe përmirësuar inxhinierët e kompanisë që po ndërtojnë rrugën".


Gjatë vizitës në terren, disa specialistë te fushës shprehën rezervat e tyre në lidhje ecurinë e punimeve, sidomos për sa i përket sjelljes me mjedisin. Por ata refuzuan të shpreheshin, pasi nuk kishin informacion e duhur për të gjykuar në mënyrë shkencore.

Për sa u përket akuzave që i bëhen shoqatës LID në lidhje me mbështetjen e PPP-ve, në këtë rast për investitorin që po ndërton Rrugën e Arbërit, anëtarët e kryesisë vendosën unanimisht që të mos u përgjigjeshin këtyre akuzave të frymëzuara politikisht.

"Ne nuk kemi paragjykime për kompaninë ndërtuese. Ne kemi qenë të informuar dhe vazhdimisht është folur se ndërtuesit e rrugës mund të jenë italianë, anglezë, turq e kinezë. Ne nuk kemi pasur asnjë paragjykim për asnjërin prej tyre, dhe sigurisht as për kompaninë "Gjoka Konstruksion", e cila është shqiptare", - tha për gazetën një nga anëtarët e kryesisë.

"Ne i urojmë kompanisë që punët t'i ecin mirë. Çdo problematikë që ndeshet gjatë punimeve është çështje e vetë kompanisë dhe qeverisë shqiptare".

## TUNELI I MURRIZIT, JA TË DHËNAT TEKNIKE



Tuneli i Murrizit do të ndërtohet nga km 19+054 deri në km 22+300. Gjatësia e tij totale është 3246 ml. Ai do të ketë një tub për trafikun normal me dy korsi me gjerësi 3.5 m secila, si dhe një tub emergjence, paralel me atë të trafikut në një distance aksiale 25m. Këto dy tunele paralele bashkohen midis tyre me anë të 6 galerive të kalimeve tërthore, nga të cilat 4 janë për shpëtimin e këmbësorëve në një rast eventual (quhen Galeri Shërbimi), dhe 2 të tjerët janë për nevojat emergjente të automjeteve (quhen Tunel/Galeri Emergjence). Seksionet përkatëse tërthore janë projektuar për të mundësuar për arritjen e qëllimit të këtyre galerive. Galeritë tërthore vendosen në largësinë 500m midis tyre përgjatë tërë tunelit.

Kuota në hyrje është 835.95m mbi Nivelin e Detit. Hapja e tunelit të Murrizit (tuneli i trafikut, emergjencës dhe galeritë) është sipas Metodës së Re Austriake të hapjes së Tuneleve (NAMT – Në Austrian Method of Tunneling). Pjerrësia tërthore brënda në tunel është 2.5%. Pjerrësia gjatësore e tunelit është: nga hyrja deri në pikën më të lartë (km 19+054-20+754.44) kemi pjerrësi rritëse i=2.25%. Nga km 20+754.44 deri km 22+300 (dalja) kemi pjerrësi zbritëse i = 1..

Tuneli parashikon marrjen e masave të sigurisë sipas standarteve europiane. Në raste emergjence apo zjarri në tunel ai u mundëson plotësisht udhëtarëve të lënë mjetet e tyre dhe të shkojnë në një vend të sigurtë, ndërkohë që garanton akses të shpejtë të ekipeve të zjarrfikësave dhe të shpëtimit. Për këtë është parashikuar të ndërtohet një tunel emergjence paralel me atë të trafikut. Po kështu janë projektuar edhe galeritë e kalimit nga tuneli i trafikut në atë të emergjencës dhe anasjelltas (çdo 500m). Këto vendkalime do të jenë 2 cope galeri mjetesh dhe 4 cope galeri këmbësorësh, të gjitha të pajisura me dyer sipas kërkesave të mbrojtjes nga zjarri e tymi. Sheshet e portaleve të tunelit mundësojnë hyrje/daljen e shpejtë të mjeteve të emergjencës në tunelin/galerinë e emergjencës, ndërsa nëntakimet e galerive të mjeteve me tunelin e trafikut dhe atë të emergjencës do të mundësojnë edhe hapësira vendqendrimi për mjete.

Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri brenda në tunel përfshin hidrante, linja uji për hidrantet, sisteme fikje zjarri të veçanta, detektor zjarri e tymi, niqe (dhomëza) të mbrotjes nga zjarri çdo 250m, rezervuar uji të posaçëm, prurje uji jo më pak se 1200 l/min për gjatë të paktën një ore, etj. Brenda në tunel çdo 125m ka niqe/dhomëza të thirrjes/lajmërimit të emergjencës. Tuneli është projektuar për t'u pajisur me instalimet e kërkuara elektro-mekanike të sigurisë dhe ventilimit.

Gjërësia e tunelit të trafikut me L=3246m përbëhet nga: dy korsitë e trafikut më gjerësi 3.5m secial (2x3.5), dy kuneta anësore 0.35m të gjëra secila (2x0.35m), dy trotuare: 2x0.85m, që kanë pjerrësi tërthore 2% në drejtim të kunetave përkatëse, pjerrësia tërthore e korsive është -2.5%, lartësia e lirë për trafikun është 5.00m.

Përmasat gabarite brenda për brenda të tunelit te trafikut janë: b=10.1m, h=6.8m.

Tuneli i Emergjencës me L=3246m përmban (i) Koridorin e kalimit të mjeteve me b=3.5m, (ii) dy trotuare me b=2x-0.7m=1.4m, (iii) Lartësi të lirë kalimi H=4m, dhe (iv) Pjerrësi tërthore të pjesës kaluese 2.5%. Përmasat e tij gabarite janë: b=6.04m, h=4.7m.

Tuneli/Galeria e kalimit nga tuneli i trafikut në atë të emergjencës është i ngjashëm me vetë Tunelin e Emergjencës. Të këtillë do të jenë dy: km 20+300 dhe 21+300 me L=2x15.47m dhe përbëhen nga: korridori i kalimit të mjeteve - b=3.50m, dy trotuare anësore - b=2x1.00m=2.00m, lartësi të lirë kalimi - H=4.00m, pjerrësi tërthore të pjesës kaluese - i=0%. Përmasat e tij gabarite janë: b=7.7m, h=5.0m.

Galeria e shërbimit/kalimit të këmbësorëve në tunelin e emergjencës konsiston në (i) koridorin e kalimit me b=2.5m, (ii) lartësinë e koridorit të kalimit h=2.2m, dhe (iii) pjerrësi tërthore i=0%. Galeri këmbësorësh do të jenë 4 copë: km 19+300, 19+800, 20+800 dhe 21+800 me L=4x15.62 m. Përmasat gabarite këtu janë: b=3.4m, h=3.1m.

Seksioni tërthor i niqes/aneksit për vend-qëndrimin e mjeteve në tunelin e emergjencës do të realizohet në km 20+300 dhe 21+300, secili me L=60m, me këta tregues: Korridori i kalimit - b=3.5+2.5=6m, dy trotuare anësore - b=2x0.7=1.4m, lartësi të lirë kalimi - h=4m

pjerrësia tërthore e pjesës kaluese – i=2.5% . Përmasat gabarite në këtë rast janë: b=9.04m, h=5.35m.

Në të njëjtin progresiv me tunelin e emergjencës si më sipër, edhe Tuneli i kryesor (i trafikut) ka 2 anekse vendqëndrimi mjetesh në të dy anët e tij (km 20+300 dhe 21+300) me L2x60m. Seksioni tërthor i këtij aneksi ka këto tregues: dy korsi udhëtimi - b=2x3.5=7m, dy korsi parkimi - b=2x3.5=7m, dy kuneta anësore - b=2x0.35=0.7m, trotuare në të dy anët e tij - b=2x0.7=1.4m, lartësi kalimi të korsive të udhëtimit - H=5m, lartësi kalimi të korsive të parkimit - H=4.8m, pjerrësi tërthore të korsive të udhëtimit - i=2.5%, pjerrësi tërthore të korsive të parkimit - i=2%. Përmasat gabarite të vendqëndrimit të jetëve këtu janë b=15.6m, h=7.65m.

Tuneli i Murrizit parashikohet të ketë dy anekse të tillë vendqëndrimi me gjatësi 60m secili. Në këtë 60 metërsh 40 do të përdorën për vendparkimin e mjeteve, 5m për aneksin e thirrjes/lajmërimit të emergjencës, 5m për aneksin e panelit elektrik, dhe 10m për shuarsin e goditjeve. Pra gjithsej janë 25 Niqe Emergjence dhe 12 Niqe të Mbrojtjes nga Zjarri.

Të gjitha seksionet tërthore tipe të tuneleve, apo galerive, do të kenë dy veshje: (i) veshja primare, dhe (ii) veshja e brendshme.

(i) Veshja primare përbëhet nga: shtresa e torkretit me trashësi t=10-30cm, rrjetë hekuri (deri në tre rrjeta) tip Q189 me 3.03kg/m2, vendosja e kapriatës metalike harkore tip 50/26/18 me 10 kg/ml. Ankera të gjatësive dhe tipeve të ndryshme për përforcimin e shkembit (ii) Veshja e brendëshme përbëhet nga: 25-40cm trashësi betoni e hedhur në segmente tuneli 12m të gjata, hekur betoni sipas rastit.

Portalet e tuneleve do të trajtohen me perforcime të skarpatave të gërmimit me ankera, sikurse edhe tek gërmimet për trupin e rrugës.

Gërmimi i tunelit të trafikut do të bëhet me mjete mekanike, ose eksploziv. Ai ka tre faza: (i) gërmimi i pjesës së harkut të sipërm, (ii) gërmimi i shkallës, që shkon deri në nivelin e harkut të poshtëm, dhe (iii) gërmimi i harkut të poshtëm.

Gërmimi i tunelit të emergjencës, dhe atyre të kalimit, do të bëhet njeherësh përsa i përket pjesës së harkut të sipërm, dhe shkallëzimit.

Hapi i Avancimit i rekomanduar/llogaritur i gërmimit të fazës (i) – harku i sipërm - është 1.3 deri 1.8m, për fazën (ii) – shkallëzimin – hapi do të jetë 3.6m, dhe për fazën (iii) – harkun e poshtëm – hapi i avancimit do të jetë 12m.

Gërmimi gjatë fazës (i) dhe (ii) do të përforcohet duke i paraprirë me anë të tubave të injektimit të ballit, e pastaj menjëherë pas hapjes do të hidhet 20 cm torkrit, futen ankera SN (shufër), apo IBO (me injektim) me L=4-6m, vendosen deri 2 shtresa rrjetë hekuri/teli, e në fund fiksohen kapriatat hark metalike.

Gërmimi i Seksioneve më të vegjël (tuneli i emergjencës dhe tunelet/galeritë e kalimeve) do të kenë një masë më të vogël përforcimi. Kështu, torkriti është me t=10-15cm, ankerat do të jenë rreth 3m të gjatë, rrjeta/zgara e hekurit është vetëm një.

Drenazhimi i tunelit do të realizohet në të dy anët e tij mbi thembrën përkatëse të tunelit me anë të tubave të drenazhimit PEHD ϕ200mm, ku grumbullohen ujërat nëntokësore. Nën pjesën kaluese ndodhet kolektori i drenazhimit me tub PEHD ϕ300mm, ku grumbullohen ujërat e drenazheve anësore nëpërmjet pusetave të kolektorit, që do të jenë çdo 100m.

Sistemi i kullimit të ujërave sipërfaqësor të tunelit do të jetë prerazi veçmas atij të drenazhimit nëntokësor. Ai vendoset nën kunetë dhe përbëhet nga një tub beton-armeje sikurse tregohet në seksionet tërthore të tunelit. Në dalje të të dy anëve të tunelit do të ndërtohet një rezervuar që grumbullon ujërat e ndotura të këtij sistemi. Volumi i këtij rezervuari është 105 m3.

*(Shënim: Informacioni i mësipërm është marrë nga relacioni teknik i përgatitur nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, korrik 2017.)*

**Ndërkohë, njëra nga ëndrrat shekullore të dibranëve, Rruga e Arbërit, duket se po bëhet realitet. Me gjithë vështirësitë e deritanishme, raporti nga terreni tregojnë se mbi 30% e punimeve ka mbaruar, kështu që duket se nuk ka kthim pas. Brenda 2-3 viteve në do të fillojmë të lëvizim në atë rrugë, e bashkë me të edhe potencialet ekonomike që Dibra mban brenda.**

**Ne shpresojmë dhe besojmë, se materialet e kësaj Konference, të shërbejnë për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimi e mëtejshëm, gjithëpërfshirës, të shoqatave, deputetëve, pushtetarëve, intelektualëve e biznesmenëve dibranë, duke praktikuar me efikasitetin e duhur të gjitha rrugët dhe mjetet demokratike.**



# "Brenda 2-3 viteve në do të fillojmë të lëvizim në Rrugën e Arbërit bashkë me potencialet ekonomike që Dibra mban brenda"

Nga ing. **SHABAN BITRI***



Ndjehem tepër i nderuar që në emër të Kryesisë së Shoqatës LID t'ju uroj mirëseardhjen.

Sot këtu do fliste kryetarja e shoqatës, zonja Edlira Haxhiymeri, por për shkaqe shëndetësore ajo nuk mund të jetë e pranishme sot. Duke ju përcjellë përshëndetjet dhe falënderimet e saj, i urojmë të gjithë së bashku shërim të shpejt dhe kthim mes nesh, plot energji e vitalitet, si më parë.

Kjo Konferencë Shkencore që po mbajmë sot, nuk është caktuar rastësisht. 13 vite më parë, shoqata jonë nisi hapat e parë. Që atëherë, edhe në bashkëpunim me simotrat e tjera, kemi kryer disa veprimtari, çdo vit, duke u përpjekur kështu të bëjmë sadopak përpjekje për më të mirën për Dibrën. Me këtë rast, falënderojmë gazetën Rruga e Arbërit për pasqyrimin e të gjitha veprimtarive tona gjatë këtyre 13 viteve.

Ndërkohë, njëra nga ëndrrat shekullore të dibranëve, Rruga e Arbërit, duket se po bëhet realitet. Me gjithë vështirësitë e deritanishme, raporti nga terreni tregojnë se mbi 30% e punimeve ka mbaruar, kështu që duket se nuk ka kthim pas. Brenda 2-3 viteve në do të fillojmë të lëvizim në atë rrugë, e bashkë me të edhe potencialet ekonomike që Dibra mban brenda.

Pikërisht për këtë fakt, për të orientuar investimet e ardhshme publike dhe private në ekonominë e Dibrës, zhvillohet kjo Konferencë Shkencore, më qëllimin e mirë, argumentimin e domosdoshmërisë për përmirësimin dhe ndërtimin e rrugëve lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit historik e malor në Qarkun e Dibrës.

Kemi dëgjuar shpesh, por veçmas këto ditë, se kjo veprimtari e shoqatës është në mbështetje të qeverisë.

Do të ishim të kënaqur që në këtë veprimtari, apo edhe në të tjerat në të ardhmen, jo vetëm shoqata jonë, por të gjithë shoqatat e tjera të kishin bashkëpunim me qeverinë apo institucionet qeveritare. Kjo nuk është mëkat, përkundrazi, tregon vullnetin e mirë se kur jemi bashkë, pavarësisht bindjeve, mund të bëhen gjëra të mira për vendin.

Por fatkeqësisht, në këtë veprimtari nuk ka asnjë ndikim qeveritar. Në këtë konferencë është vullneti i mirë i anëtarëve të saj, i kryesisë së shoqatës, për të zhvilluar një konferencë shkencore për të vënë pikat mbi "i" mbi atë se ku duhet të përqendrohen investimet qeveritarë, që Dibra, qytetarët e saj dhe gjithë shqiptarët, ta ndjejnë menjëherë përfitimin ekonomik.

Kjo Konferencë Shkencore, përveç të tjerash është edhe dëshmi e vitalitetit të intelektualëve tanë, e vetëdijes së tyre profesionale, e përkushtimit atdhetar dhe e idealeve të tyre kombëtare. Në të, jo vetëm marrin pjesë, por japin dhe ndihmesën e tyre të vyer, specialistë nga Tirana, Dibra e Madhe, Mati, të cilët do të përcaktojnë pikat kyçe se ku duhet të përqendrohen investimet në rajon. Këto materiale, të cilat do të botohen në gazetën Rruga e Arbërit dhe onlinë, do të jenë një burim i mirë informacioni për qeverinë vendore dhe qendrore, majtas e djathtas, që e duan vendin e tyre të zhvilluar ekonomikisht.

Ne shpresojmë dhe besojmë, se materialet e kësaj Konference, të shërbejnë për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimi e mëtejshëm, gjithëpërfshirës, të shoqatave, deputetëve, pushtetarëve, intelektualëve e biznesmenëve dibranë, duke praktikuar me efikasitetin e duhur të gjitha rrugët dhe mjetet demokratike.

Anëtarët e shoqatës sonë kanë qenë të shqetësuar për standardet e ndërtimit të rrugës, dhe për këtë janë përpjekur të krijojnë gjithmonë një rrugë komunikimi me institucionet përgjegjëse qeveritare. Raporti i specialistëve tanë për devijimet e projektimit, pikat kyçe ku duhej ndërhyrë në projekt për përmirësimin e cilësisë së rrugës, e cila u është dërguar zyrtarisht këtyre institucioneve 6 vite më parë, nuk u mor parasysh.

Ne shpresojmë që një pjesë të atyre problematikave t'i kenë gjetur dhe përmirësuar inxhinierët e kompanisë që po ndërtojnë rrugën.

Duke përfunduar, duam të theksojmë se organizmi i këtij tubimi shkencor, përbën një ndërmarrje serioze dhe nuk mund të realizohej pa ndihmën e madhe të të gjithë anëtarëve të kryesisë, sidomos biznesmenëve Latif Miha, Musa Riçku e Shaban Bitri. Por, duhet veçuar dhe falenderuar puna e profesor Bashkim Lleshit, i cili ishte ideatori dhe kontributori kryesor për realizimin e kësaj konference.

Gjithashtu, kjo konferencë nuk mund të zhvillohej pa ndihmën e inxhinierëve dhe specialistëve, profesorëve tanë të nderuar, të cilët kanë përgatitur materialet e këtij kuvendi që do t'i ndjekim në vazhdim.

Në emër të kryesisë së LID, duke ju falënderuar të gjithëve, i urojmë kësaj Konference punë të mbarë!

** Nënkryetar i shoqatës LID.*

## KRONIKA E KONFERENCËS

Më 12 maj 2019 Shoqata e LID në Tiranë zhvilloi Konferencën shkencore "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit historik e malor në Qarkun e Dibrës". Në konferencë përveç anëtarëve të kryesisë së LID: Shaban Bitri, Musa Riçku, Latif Miha, Shpëtim Cami, Bashkim Lleshi, Enver Hysa, Nazmi Koçi, Miranda Goleci, Demir Osmani e Shaqir Skarra, muarën pjesë shumë intelektualë, studjues e qytetarë dibranë dhe të ftuar të tjerë nga shoqata të ndryshme të Dibrës dhe të ftuar nga Peshkopia, Bulqiza, Mati, Tirana, etj. Konferencën e hapi anëtari i kryesisë së LID Demir Osmani i cili ia dha fjalën zv/kryetarit të LID Shaban Bitri i cili përshëndeti të pranishmit në emër të kryesisë së LID.

Pas një dokumentari të shkurtër televiziv për eskursionin e datës 20 prill në aksin e Rrugës së Arbërit nga Ura e Vashës në Shupenzë e Gjoricë të përgatitur nga gazetari Dëfrim Methasani u mbajtën referatet e konferencës:

1. "Ndjekja nga LID dhe Gazeta "Ruga e Arbërit" e punës së kryer për ndërtimin e Rrugës së Arbërit gjatë viteve 2007-2018 dhe Ecuria e punimeve të ndërtimit të kësaj rruge në periudhën 2018–prill 2019." përgatitur nga: Bashkim Lleshi, Musa Riçku, Bujar Karoshi, Hysen Uka e referoi Bashkim Lleshi.

2. Vazhdimi i Rrugës së Arbërit në teritorin e Maqedonisë dhe përmirësimi i rrugëve lidhëse në zonën e Maqellarës dhe Dibrës së Madhe (Koxhaxhik, Mavrovë, Rekë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit të kësaj zone." përgatitur nga: Shaban Bitri, Qeram Lleshi, Shuip Marku, Demir Osmani e referoi Demir Osmani.

3. "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të njësive Administrative të Peshkopisë, Tominit, Kastriotit, Lurës, Çidhnës, Reçit, Dardhës, Sllovës dhe Kalasë së Dodës" përgatitur nga: Vesel Hoxha, Bashkim Lleshi, Hajredin Toca, Ali Hoxha, Mustafa Tola, Bardhok Rajta e referoi Vesel Hoxha.

4. "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të njësive Administrative të Selishtës (4 Grykëve) Muhurit e Luznisë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit të kësaj zone" përgatitur nga: Osman Miha, Agim Totraku, Elmas Lala e referoi Agim Totraku.

5. "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të njësive Administrative të Grykës së Vogël e Gollobordës për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit të kësaj zone" përgatitur nga: Zabit Lleshi, Shehat Cami, Nazmi Koçi, Mehdi Dema e referoi Zabit Lleshi.

6. "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të njësive Administrative të Bulqizës, Zerqanit dhe Martaneshit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit të kësaj zone." përgatitur nga: Sefedin Shabani e Naim Karaj e referoi Naim Karaj.

7. "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të njësive Administrative të Bashkive të Klosit e Burrelit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit të kësaj zone." përgatitur nga: Ramazan Ceni, Sali Bushi, Zenel Hysa, Agim Shenjatari e referoi Sali Bushi.

Pas referimeve diskutuan: Xhafer Martini, Hysen Uka dhe Dëfrim Methasani të cilët vlerësuan punimet e kësaj konference.

***SHËNIM I REDAKSISË:***

Duke filluar nga ky numër dhe në vazhdim, redaksia do të botojë materialet e plota të përgatitura për këtë konferencë. Të gjitha punimet janë materiale origjinale, ndaj ndalohet përdorimi i tyre, me çdo lloj apo mjet, përveç rasteve kur kjo do të shërbejë si burim referimi. Çdo shpërndarje përmes internetit duhet të ruajë linkun e botimit origjinal.

# Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit

## të Njësive Administrative të Peshkopisë, Kastriotit, Çidhnës, Lurës, Dardhës, Reçit, Sllovës, Kalasë së Dodës, Tominit dhe Melanit – me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, turizmit malor e Historik

*Autorë:* **VESEL HOXHA**, ***Bashkim Lleshi, Bardhok Rajta, Hajredin Toca, Ali Hoxha, Mustafa Tola, Osman Xhili***




*Në foto: Prof.dr. Vesel Hoxha duke mbajtur referimin.*

Konferenca shkencore me temë: ***"Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit historik e malor në Qarkun e Dibrës"***, thirret në momentin e duhur dhe historik. Problemet që do të lindin dhe përspektivat që do të hapen pas ndërtimit të Rrugës së Arbërit, do të jenë të mëdha e të shumanshme, realizimi i të cilave do ta zhvilloj më tej rajonin duke e ngritur në një stad të ri të përparimit ekonomik.

Duke sjellë në këtë konferencë gjendjen e rrugëve të brendshme brenda njësive përkatëse administrative, përmirësimet që kërkohen apo propozimet për ndërtimin e akseve të reja, aty ku ata mungojnë për t'u lidhur me aksin e Rrugës së Arbërit, do ti shërbehet e do ti paraprihet të ardhmes së zhvillimit të ekonomisë në tërësi, bazuar në pasuritë nëntokësore e mbitokësore të njohura dhe atyre që mund të gjenden si dhe pasurive ujore, pyjore, kullotave, tokave arë për prodhimet bujqësore e frutikulturën, zhvillimin e mëtejshëm të turizmit historik e malor duke evidentuar e propoganduar vendet historike të zonës, monumentet e natyrës dhe pejsazhet mahnitëse që natyra ja ka falur Qarkut të Dibrës e, veçanërisht, rajoneve që do të përfitojnë drejtpërdrejt nga ndërtimi i kësaj rruge jetike për ta. Rrugët sjellin zhvillim, zhvillimi përmirëson jetesën e popullatës dhe e bën më të gëzueshme jetën edhe në zonat më të thella malore.

***

Rajoni në studim përfshin Njësitë Administrative të Peshkopisë (qyteti i Peshkopisë), Kastriotit (Fshatrat: Kastriot, Brest i Sipërm, Brest i Poshtëm, Kishavec, Kandër, Kukaj, Vakuf, Fushë-Kastriot, Borovjan, Deshat, Limjan, Sohodoll, Sohodoll i Vogël, Vrenjt, Përgjegje), Lurës (Fshatrat: Fushë-Lurë, Borie-Lurë, Arth, Gurë-Lurë, Lurë e Vjetër, Arrëmollë, Krejë -Lurë, Pregjë - Lurë, Sumej, Vlashej), Fushë Çidhnës (Fshatrat: Fushë Çidhën, Blliçe, Laçes, Rrenz), Zall Reçit (Fshatrat: Zall-Reç, Bardhaj-Reç, Draj-Reç, Gur-Reç, HurdhëReç, Kraj-Reç, Ndërshenë, Qafdraj, Tharkë), Zall Dardhës (Fshatrat: Zall-Dardhës, Lashkizë, Lugjej, Menesh, Nezhaj, Qa, Soricë, Shënlleshën, Tartaj), Sllovës (Fshatrat: Sllovë, Kallë, Vleshë, Zall-Kalis, Dypjakë, Palaman, Sllatinë, Shumbat, Venisht, Trojak); Kalasë së Dodës (Fshatrat: Ceren, Kullas, Ploshtan, Radomirë, Shullan, Tejzë, Ujëmirë, Vasie). Tominit (Fshatrat: Tomin, Brezhdan, Cetush, Dohoshisht, Pilafe, Pollozhan, Rrashnapojë, Selane, Ushtelenxë, Bahute, Staravec, Shimçan, Zimur, Zdojan); Melanit (Fshatrat: Melan, Cerjan, Rabdisht, Zagrad, Begjunec, Trepçë, Grevë, Ilnicë, Bellovë, Pejkë, Pjeçë, Trenë);

Dibra rregjistron 79 000 banorë rezident dhe rezulton me një sipërfaqe prej 938 km katror. Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Peshkopi, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishtë, Sllovë, Kala e Dodës, Zall - Dardhë, Zall - Reç, Fushë Çidhën dhe Arras. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Dibrës dhe qarkut të Dibrës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 141 fshatra. *(faqja zyrtare e Bashkisë Dibër).*

Shtrihet kryesisht në rajonin veri - lindor të Shqipërisë me një reliev përgjthësisht malor, pak kodrinor dhe me terrene fushore që përkojnë me terracat në Luginën e Lumit Drini i Zi.

Ky lum e përshkon bashkinë për së gjati pothuajse sipas drejtimit jug – veri duke e ndarë atë në dy pjesë, ku në lindje veçojmë Malin e Sorokolit, Kullën e Zyberit, Qafën e Rosnikut, Malin e Rosnikut, Malin e Korabit, Portat e Korabit, Majat e Bjeshkës së Shehut, Malin e Bardhë, Lakun e Xhipit, Bjeshkën dhe Malin e Gramës, Skërtecin, Majën e Plloçës, Majën e Visokës, Malin e Velivarit, Malin e Kërçinit etj. dhe në perëndim veçojmë Gurin e Kuq të Krejë Lurës, Nezhdën me Kunorën e Lurës, Majën e Rrasës, Majën e Batrave, Majën e Kështenit, Majën e Gjukshajve, Majën e Madhe, Lanë Lurën e Vëltushin, Malin e Xharxhishtit me Majën e Kacimares dhe Majen e Shqerrave, Qafë Kumbullën, Runjën e Lurës, Majën e Gjatë, Majën e Vogël, Majat e Zeza në Malin e Pllajut, Runjën e Vogël, Malin e Runjës, Malin e Pratit, Majen e Bataçes, Malet e Balgjajt, Kodrën e Kalasë etj. Qendra e bashkisë është qyteti i Peshkopisë.

Teritori i saj ka një ndërtim gjeologjik tejet të komplikuar. Këtu takohen formacionet gjeologjike më të vjetrat e Shqipërisë. Herë pas here është prekur nga lëvizjet neotektonike ngritëse që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në formimin dhe modelimin e relievit. Lartësitë malore e kodrinore - fushore variojnë nga 340 m mbi nivelin e detit (në zonën e Reçit në luginën e lumit të Drinit të Zi), e deri në lartësinë 2754 m (2764 m, jepet dhe kjo shifër lartësie në disa harta sidomos ato të Maqedonisë së Veriut) në Majën e Korabit, majën më të lartë të vendit tonë.

Ajo bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore dhe mesdhetare para malore, si pjesë përbërëse e Pellgut të Lumit të Drinit të Zi. Ka një hidrografi të pasur me burime mbitokesore dhe ujëra nëntokësore, ku arteria kryesore është lumi Drini i Zi. Në të derdhen shumë përrenj malor si ato të Veleshicës, Mallës së Lurës, Setës, Blliçes (Gramës), Murrës, Gjelagjoshtit, Llixhave, Melanit, Maqellarës etj. Dibra dallohet për shumëllojshmërinë e tokave të cilat, për shkak të relievit malor, shprehen qartë. Në të takohet brezi i tokave aluvionale rreth lumit të Drinit të Zi (terracat), ato të kafejta, të murrme pyjore dhe ato livadhore malore. Takohen breza pyjorë si: brezi i dushqeve, i ahishteve, i hormoqit (në Dibër ky brez përfaqësohet nga rrobulli, arrneni e bredhi i bardhë) dhe kullotave alpine.

### A JEMI NË KOHË PËR TË PRITUR "RRUGËN E ARBËRIT"?

Rrugët e reja apo të përmirësuara me standard që do të lidhin njësitë e Bashkisë Dibër me Rrugën e Arbërit, mendohet të tërheqin shumë turistë e investitorë vendas e të huaj. Kur themi kështu mendja na shkon se çfarë do t'ju ofrojmë atyre në këto zona.

Ata kërkojnë të shikojnë monumente e peisazhe natyrore të spikatura, gjeomonumente e biomonumente, rrugë malore mes pyjesh, e anash tyre të shikojnë një bujqësi të zhvilluar etj., pa përmendur këtu pritjen bujare dhe shumëllojshmërinë e ushqimeve tradicionale të zonave të ndryshme.

Rruga duhet ti gjej dibranët të përgatitur, e jo të presin të shkojnë kur ajo të këtë mbaruar. Banorët e zonave nga do kalojnë rrugët lidhëse me Rrugën e Arbërit, duhet të nxitojnë për të punuar e për t'ia ndryshuar asaj pamjen me projekte konkrete të familjeve, të bizneseve apo të qeverisë. Lugina e Drinit të Zi, një "hambar i drithit dhe frutikulturës" jo vetëm për Dibrën por dhe për krahinat rreth saj, ndoshta është braktisur në pritje të një hidrocentrali të madh apo disa hidrocentraleve të vegjel?

Shteti duhet ta qartësojë realitetin e kësaj legjende gati 60 vjeçare që t'i hapet rruga e investimeve, që të trasohen rrugët e çelen perspektivat zhvillimore. Kjo ka shkaktuar e vazhdon të shkaktoj një stres dhe një pengesë të madhe zhvillimore për Dibrën e Poshtme në tërësi, duke e mbajtur atë peng. Pritet të vazhdoj mbjellja e pemëve frutore (mollë dhe dardha vendi, arra dhe lajthi, etj.) që zona e Dibrës i ka traditë. Pa harruar kulturat e tjera që zona i kultivon prej shekujsh e me emër siç është fasulja shoqëruese, misri gushtak, perimet jashtë sezoni etj. Nëse arrihet që vizitori ti vjel vet produktet në pemtore dhe në kopsht, besueshmëria dhe kërkesa do rritet nga viti në vit.

Kjo mund të thuhet dhe për zhvillimin e blegtorisë së zonës. Është koha për të menduar për biznes në bujqësi me mundësitë që do të afrojë "Rruga e Arbërit" dhe magjistralet lidhëse me të.

Jemi në kohë nëse fillojmë të punojmë për të rritur vlerat e pasurive të Dibrës, për të zhvilluat ekonominë, turizmin malor e historik, që përpjekjet të mos ngelen vetëm në letër.

***

Për rrugë ka nevojë çdo skaj i atdheut. Rruga sjell zhvillim. Pa rrugë, zhvillimi nuk duhet pritur. Bashkia e Dibrës është një nga bashkitë me territorin më të madh në rang vendi, por banorët e saj janë të izoluar për shkak të rrjetit të amortizuar rrugor, e në shumë raste, me mungesën e tyre totale, pa folur këtu për lidhjet e fshatrave me qendrat e njësive apo bashkisë.


Dibra ka nevojë për shumë rrugë që duhet të ndërtohen për tu vënë në shërbim të përshpejtimit të vënies në qarkullim ekonomik të pasurive te saj mbitokësore e nëntokësore. Para se të përfundoj ndërtimi i Rrugës së Arbërit, dibranët duhet të mendojnë për hapat e mëtejshëm të ndërtimit të akseve të tjera rrugore për të garantuar një zhvillim të shpejt e të qëndrushëm, për të bërë realitet përspektivat zhvillimore që ofrojnë pasuritë natyrore të saj në të gjithë territorin e bashkisë, të mbitokës dhe të nëntokës. Si aksin më emërgjent, mendojmë Rrugën e Lurës, një aks me ndikim në ekonomi dhe turizëm, një rrugë për të cilën nuk justifikohet mosndërtimi i saj prej më shumë se një shekulli nga drejtuesit e Lures, ato të Dibrës e deri tek autoritetet qendrore që kanë peshën kryesore, duke penguar me ose pa qellim zhvillimin e kësaj krahine aq të dëgjuar në të gjithë Shqipërinë.

### AKSI RRUGOR KASTRIOT - ARRAS - LURË - LIQENET E LURËS

Duam të nënvizojmë në fillim një fakt. Edhe pse ka pak kohë që ka përfunduar rruga Kastriot -Arras, kanë filluar të ndihen avantazhet pozitive dhe të jepen frytet e para gjallëruese zhvillimore në zonë. Në këtë aks mund të vizitohen shumë objekte historike por kjo nuk përjashton dhe mundësitë e shijimit të panoramave të shumta që shpalosen në anët e luginës së Drinit të Zi.

**Lura,** një krahinë e tërë pa rrugë lidhëse me qendrën e saj historike e administrative gati një shekullore Peshkopinë, një krahinë që ndër shekuj ka bërë emër të mirë në gjithë Shqipërinë për bëmat e saj në historinë tonë të vjetër e të re, një krahinë aq e njohur për turizmin malor, për bukuritë natyrore madhështore, ndër më të bukurat e vendit tonë, pa harruar pasuritë minerale etj. që vetëm sa janë gërvishtur nga kërkimet gjeologjike apo turizmin historik.

Lura turistike me emrin e saj të njohur edhe jashtë vendit, duhet të ishte sot një destinacion praktikisht i arritshmëm e me infrastrukturë të ngritur, jo vetëm për 14 liqenet akullnajorë me bukuri të rralla, por edhe për hapsirat e tjera pyjore që po ringjallen bashkë me ato livadhore të pa fundme me gjithfarë lulesh, me morfologji terreni befasuese e mahnitëse, me Lanë Lurën e famshme dhe monumentet e tjera të natyres së saj.




*- Harta e pozicionit gjeografik e Bashkisë së Dibrës në hartën e Shqiperisë dhe pozicioni i Njësive Administrative në studim, në hartën e bashkisë në fjalë-*

*(Vijon në faqen 6)*

Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të Njësive Administrative të Peshkopisë, Kastriotit, Çidhnës, Lurës, Dardhës, Reçit, Sllovës, Kalasë së Dodës, Tominit dhe Melanit – me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, turizmit malor e Historik







Kjo rrugë nuk u ndërtua gjatë 46 viteve të kohës së socializmit enverian dhe 28 viteve të demokracisë laramane, që për shumë arsye të pa arsyeshme, po vonojnë së tepërmi vendin drejtë përparimit e zhvillimit, të paktën të ishim të krahasueshëm me fqinjët.

Në vitet e largëta të socializmit, u ndërtua një rrugë traktori 2. 5 m e gjërë ose një rrugë ushtarake për makinat e ushtrisë, makina të larta e me tek goma, që ishin në gjendje të kalonin në rrugë të tilla për të transportuar artilerinë e luftës për në repartin ushtarak në Qafën e Tajanit.

Rruga është domosdoshmëri për Lurianët edhe sikur ajo të hapet vetëm për të lidhur Lurën me qytetin e Peshkopisë, ku ata kanë qendrën e bashkisë së tyre me të cilën e lidhin hallet dhe problemet. Pas dy viteve pritet të përfundoj ndërtimi i Rrugës së Arbërit, e cila do ta afroj Tiranën me Peshkopinë në rreth 85 km, nga 170 km që është sot dhe Lurën me Tiranën nëpërmjet Peshkopisë në rreth 120 km. Deri në Arras ajo tashmë ka ardhur, duke shkurtuar distancën Peshkopi - Arras rreth 10 km. Kësisoj rruga Peshkopi - Arras - Lurë do të këtë një gjatësi totale rreth 34 - 36 km, nga 45 km që ka qenë sipas variantit nga Rruga e Rinisë nëpërmjet Muhurrit. Mbetët për tu ndërtuar 18 apo 20 km rrugë, qoftë dhe më gjërësi 5 apo 6 m e asfaltuar, për të cilën mendojmë se nuk do të këtë kosto të lartë falë dhe faktit se gjysma e gërmimit është bërë nga ushtria dekada më parë.

Rruga gjarpëron në një terren malor që nga ana gjeologjike ka përparësi, duke kaluar në formacione karbonatike të forta (kryesisht gëlqerorë). Rruga Arras - Lurë duhet të ndërtohet një orë e më parë për perspektivat që do të hap në disa drejtime zhvillimore për krahinën, për të vijuar drejt liqeneve të Lurës. Për të vajtur në Lurë dhe tek liqenet e saj mund të ketë dhe variant tjetër si ai në drejtimin e Gur Lurës me tunele nga Çidhna që kërkon shpenzime më të mëdha. Rruga Arras - Lurë do të zhvilloj jo vetëm atë krahinë të lënë pas dore por, do të jetë në vetvehte dhe një rrugë panoramike e papame dhe jo vetëm kaq.

Kjo rrugë kalon fillimisht në territorin e Vendorigjinës së Kastriotëve. Këtu mund të vizitohen Kastrioti, Kisha e Gjonit, Zabeli i Kukës, Kulla e Gjonit, Ogradja e Gjonit, Guri i Luftës, Zabeli i Gjinit etj. Vijon më tej afër Kodër Laçes ku është lartësuar përmendorja në kujtim të zhvillimit të Betejës së Madhe të Torviollit midis Ushtrisë Osmane dhe Ushtrisë së Lidhjes së Lezhës, që komandohej nga Skenderbeu, si dhe luftrave të tjera për liri e pavarësi, dhe në vazhdim vizitohet vendi i quajtur Ferra e Pashës afër Urës së Lushës. Kalohet në Arras, aty ku filloj Kryengritja e Përgjithëshme e vitit 1912 kundër ushtrisë osmane me 26 - 27 mars dhe aty ku u formua Qeveria e Arrasit e vitit 1920. Në Sinë, vizitohet Muzeu i Kastriotëve, Hambarët e Skënderbeut pranë Arës së Trojës, Troja, Arat e Gjegjës etj.

Pasi kalon Urën e Përroit të Setës, rruga fillon ngjitjen drejt fshatit Çidhën, aty ku, në vitin 1466 u krye nga Sulltan Mehmeti i II masakra më e madhe në historinë tonë kombëtare, në territorin midis dy kalave të kësaj treve, ku i shkoj në thikë sipas Barletit, 8 deri 10 mijë burra, veç grave dhe femijëve.

Pra është një rrugë e mbushur me përmendore e lapidare që dëshmojnë dhe gjëmojnë për historinë, një vlerë tjetër e madhe kjo, në shërbim të turizmit dhe memories tonë kombëtare, shumë pranë Muzeut të Kastriotëve në Sinë.

Në këtë rrugë ka kaluar edhe dërgata e mbretit Maqedon Perseu në vitin 169 para Krishtit për bisedime me Gentin (mbretin ilir) kundër romakeve, pasi kreu masakrën mbi Oenen, kryeqendrën e Penestëve.

Në stacionin e parë të saj në Çidhën do të hap perspektiva turizmi veçanërisht për të vizituar gjeomonumentet e natyrës që ndeshen në Grykën e Setës nga Ura e Setës e Kepi i Xhitetit e deri ne afërsi të Gur - Lurës, me kanione të shumta të thella e magjepse, me shpella karstike interesante e ujëra që rjedhin prej tyre si kristali etj. Në vazhdim ndeshet me Luginën karstike të Pratit e cila në anën perëndimore ka Qafën e Tajanit. Tajani, një pikë dominuese ku shikohet si në pëllëmbë të dorës 70 % e Dibrës e më gjërë, ku në anën lindore vrojtohet Mali i Gjallicës, Malësia e Sorokolit, Malësia e Korabit, Malësia e Gramës, Mali i Velivarit etj., dhe në anën perëndimore Mali Xharxhixhtit, Mali i Pllajut, Mali i Runjës, Mali i Pratit etj. Në vazhdim kjo rrugë do të ndërpresë mes për mes Lanë - Lurën që të mrekullon që në shikimin e parë, një fushë e madhe karstike-tektonike me vlera të jashtëzakonshme nga të katër anët, e njohur në rang kombëtar e rajonal. Vazhdimi i saj drejt jugperëndimit - Luginës karstike-tektonike të Xharxhishtës apo drejt verilindjes, Majës së Madhe, e bënë atë më madhështore dhe piktoreske.

Kjo rrugë do të jetë rruga që do të rilind jo vetëm Lurën por dhe zonën ku kalon në çdo kilometër të saj. Jemi tejet të bindur se ndërtimi i kësaj rruge jetike edhe pse tejet e vonuar, do të tërheq shumë investitorë vendas e të huaj të interesuar për turizmin malor, atë historik, pejsazhet (në zonën e Lurës vizitohet Kisha e Krejës e Dom Nikoll Kaçorrit, Fusha e Krejës, Guri i Kuq, Gryka e Madhe e Përroit të Mallës së Lurës etj.) pse jo dhe për pasuritë nëntokësore të saj, për kerkimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e disa mineraleve që mund të gjenden në Lurë, që për shumë e shumë arsye kërkimet gjeologjike që u realizuan në kohën e monizmit, vetëm sa "e kanë gërvishtur"atë.

Midis shume arsyeve, mungesa e rrugës padyshim ka pjesën e luanit. Mineralet e Kromit, të Bakrit, apo disa minerale të Aluminit e Manganit etj. (objektet Dodaj, Krejë Lurë, Blaç, Përroi i Ftujës, Pregjë Lurë, Arrëmollë etj.), si dhe minerale të tjerë jo metalorë që natyra nuk i ka kursyer (si lëndë e parë për infrastrukturë në gjithë territorin), kanë perspektiva në Njësinë Administrative të Lurës e cila, kurrsesi nuk duhet llogaritur vetëm si një vend ku mund të zhvillohen turizmi malor e historik, blegtoria, ajo pak bujqësi apo ndonjë investim tjetër prodhues me leverdi etj.

Pjesa më panoramike do të jetë pjesa e rrugës nga qendra e Lurës drejt Liqeneve të saj. Aty ku pishat kanë filluar të ripërtrihen dhe liqenet po shtojnë bukuritë. Kjo rrugë nuk i kalon 16 - 17 km, ku që në kilometrin e 7 -të takon liqenin e parë e më tej vazhdon gjarpërimin me ngjitje të butë për afro 10 km, duke qarkuar të gjithë liqenet akullnajorë deri në Fushën e Pelave.

Vazhdimi i saj drejt jugut do të hap perspektiva të reja duke u lidhur në të ardhmen edhe me zonën e Vanave e Selishtës. Lidhja me rrugë të rregullt e zonës së Liqeneve të Lurës dhe vetë fshatrave të Lurës midis tyre, do të jetë një gjë madhështore, do të krijojë kushte për investime serioze në turizëm dhe në disa fusha të tjera të kësaj krahine shumë të largët. Rruga do ta rilind Lurën bashkë me malet e liqenet aq të njohur në gjithë shqipërinë.



Foto e bërë nga "Qafa e Tajanit" drejt Rrafshit të Korabit

Rruga e Arbërit do ti jap frymëmarrje Dibrës në të katër qoshet e saj.

Po ashtu duhet thënë e verteta se ***"Lura ndodhet midis dy rrugëve"*** për faktin se ajo ka edhe një drejtim tjetër për tu lidhur me kryeqytetin nëpërmjet Mirëditës veç variantit të lidhjes së saj me Rrugën e Arbërit që trajtuam më lartë dhe për të cilën gjykojmë se ky aks do ta lidh më shpejt me Tiranën, edhe pse është një rrugë që disa muaj edhe mund të bllokohet nga dëbora.

### *A është Lura e gatshme të presë vizitorë vendas e të huaj pas lidhjes me Rrugën e Arbërit?*

Aktualisht gjendja në Lurë nuk është shumë optimiste në shumë drejtime të zhvillimit ekonomik. Brenda vetë Lurës duhet të ndërtohen e riparohen rrugë të brendëshme midis fshatrave që të mund të krijohen kushtet për investime në funksion të turizmit malor.

Ndihet mungesa e ujit të pijshëm në çdo familje, pasi gjendja është jo e mire për të mos thënë e mjerueshme. Furnizimi me energji elektrike është larg çdo norme dhe lenë shumë për të dëshiruar. E shikuar ndryshe, në Lurë ka mundësi të mëdha për hipodrome garash ndërkombëtare, pista dimërore për gara skish për aktivitete ndërkombëtare etj. si në dimër, pranverë, verë dhe vjeshtë, etj. Krahina e Lurës është e mbushur me dëshmi arkeologjike të lashtë dhe të vonë, me pllaja, lugina, kanione, ujra sipërfaqësore e nëntokësore, me pyje të shumëllojshme që shpejt do të ripërtrihen më të bukura se më pare etj.

Historia e lashtë, e vonë, e mesm edhe e tanishme e Lurës është ndër me të lavdishmet në Dibër dhe gjithë Shqiperinë, kërkohet të prezantohet me profesonializëm ashtu sikurse kultura dhe arti, etnosi gojor dhe i kultivuar, këngët dhe vallet, veshjet e grave dhe burrave të cilat janë perlat e këtij vendi të gërshetuar me histori të lavdishme pa përmendur këtu bujarinë, mikpritjen dhe guzhinën tradicionale mjaftë cilësore.

### *AKSI RRUGOR PESHKOPI - KASTRIOT - KALA E DODËS, ME DEGËZIMET CEREN - RRAFSHI I SOROKOLIT DHE SLLOVË - LIVADHI I GJATË - GRAMË*

Nëpërmjet këtij aksi do të jenë lehtësisht të vizitueshme Korabi, Sorokoli e Grama, tre perlat e pa njohura të Dibrës pothuajse të virgjëra me bukuri e pejsazhe të rralla. Në këto venda të nalta të natyrës dibrane midis të tjerave mund të vizitohen një numër i madh gjeomonumentesh (Shiko listën e gjeomonumenteve).


Është e vertet se ky aks deri në Kala të Dodës mendohet se është i ndërtuar e i asfaltuar por ne, nuk do të mendonim ashtu. Jo vetëm që ky magjistral është ndërtuar pa ndonjë standard të lartë por ajo më shqetësuese është fakti i ndërtimit pa studime gjeologo-inxhinierike.

Mjafton të udhëtosh në këtë rrugë për ta parë me sy realitetin. Sapo kalon fshatin Kastriot ndesh në dukuritë e para rrëshqitësë tek Kodra e Gështenjave, pastaj në vjimësi, në afërsi të rrugës së fshatit Blliçe, ku ajo degëzohet me rrugën kryesore, në shpatin pa vajtur tek Ura e Mullirit të Kapçit, midis Shumbatit e Trojakut,













*Pamja majtas: Guri i Kuq, Krejë Lurë. Në mes foto simbolike e Çekiçit të Gjeologut (mbi shkëmbinj të Masivin Ultrabazikë të Lurës), i cili duhet të vazhdojë të godasë shkëmbinjët e Lurës për të gjetur vendburime të dobishme mineralesh. Besojmë se kjo ka për tu realizuar nga brezat e tjerë, ndaj e shikojmë me shumë optimizëm ndërtimin e rrugës. Në të djathtë të fotos, pamje të Grykës së Madhe të Përroit të Mallës së Lurës.*

# studimi


*Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të Njësive Administrative të Peshkopisë, Kastriotit, Çidhnës, Lurës, Dardhës, Reçit, Sllovës, Kalasë së Dodës, Tominit dhe Melanit – me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, turizmit malor e Historik*



Disa foto të kampioneve të ndryshme mineralesh metalorë e jo metalorë, ku dominojnë ato të kromit të masivëve ultrabazikë të Bulqizës dhe të Lurës. Në foton e sipërme djathtas, mund të dallohen disa minerale të Hekur Nikelit dhe ato të Boksideve etj. Një pjesë e kampioneve janë mbledhur në rajon me ndihmën e Prof. N. Mekshiqit dhe inxhinierit të apasionuar e të talentuar të minierave z. B. Hoxha.



*Pamje të ndryshme nga Liqeni i Zi (ne veri të fshatit Tejs).*



*Pamje nga Parku Natyror Korab - Koritnik të realizuara kryesisht ne zonën ku përhapen evaporitet, ku bien në sy format interesante qe ka skalitur erozioni në shpatet evaporitike në jug të Majës së Pelpanikut, Majës së Malit të Bardhë.*




*Pamje nga Parku Natyror Korab - Koritnik të realizuara kryesisht ne zonën ku përhapen evaporitet, ku bien në sy format interesante qe ka skalitur erozioni në shpatet evaporitike në jug të Majës së Pelpanikut, Majës së Malit të Bardhë.*




*Majtas: Gjipsi i Kellës (Pulla e bardhë në fotonë VP të Staneve të Preshit–Korab) dhe Burimi i Preshit ku marrin ujë Peshkopia dhe disa fshatra. Djathtas: Liqeni i Gramës.*







pa hyrë në Sllovë, midis Sllovës e Vleshës në zonën e Përroit të Botës, midis Vleshës dhe Urës së Veleshicës etj.

Po ashtu urat në këtë rrugë janë ato të ndërtuara vite e vite më parë. Kësisoj disa prej tyre e kanë domosdoshmëri ndërhyrjen duke filluar nga Ura e Përroit në Miravec, afër Kastriotit, e me rradhë. Si rrugë të reja veç asaj Ceren-Rrafshi i Sorokolit (4 - 5 km), në këtë aks rekomandojme rrugën Sllovë-Livadhi i Gjatë-Varri i Sejmenit - Gramë (12 km, ose 10 km nga fshati Sllatinë).

Edhe degëzimi Ceren -Tejs ka nevojjë për një përmirësim total, si ***Porta Pritëse e Korabit***.

Në tërësi aksi Peshkopi - Kastriot - Kala e Dodës kalon në një zonë me pasuri të shumta minerale metalore e jo metalore, që mund të vihen në shfrytëzim. Rrugët e reja dhe përmirësimet që kërkohen të bëhen, mund të ndikojnë në gjallërimin e kërkimeve të mëtejshme. Këtu mund të përmendin një numër vendburimesh Gjipsi, Anhidriti e Seleniti, të cilat hëpërhë janë të penguara nga Parku Natyror Korab Koritnik, po ashtu dhe disa minerale të tjera metalore e jo metalore si mermeret e Korabit, disa shkëmbinj magmatikë acid në Presh e bazik në Sorokol që mund të priten e latohen si gurë veshës dekorativ të cilësisë së lartë; mermere të varrosura në rrjedhjen e sipërme të Veleshicës me ngjyra nga më të bukurat, mineralizimet e Hekurit në Sorokol etj., Manganit në Gramë e Rr. Korabit etj., Polimetaleve në Veleshicë etj., Arsenikut në Trojak, Dipjakë, Varri i Sejmenit, Stanet e Preshit-Gjipsi i Kellës, Qafa e Rritheve, Izvir, Rrafshi i Korabit, Kepi i Stogjit, fillim Rrafshi i Korabit e deri në Qafën e Rosnikut; atyre të çmuarve etj. Në këtë zonë mund të vizitohen 10 liqene malor akullnajorë, nga Grama, Bjeshka e Shehut, ajo e Preshit e deri tek Liqeni i Zi mbi Tejzë (shiko fotot ilustruese në vijim).

Turizmi malor dhe ai historik do ti sjellin gjallërim ekonomisë së zonës në tërësi. Për mineralet do të krijohen lehtësira e mundësi për intensifikimin e kërkimeve nga firmat vendase e të huaja. Në njësitë në fjalë janë zbuluar një numër i konsiderueshëm venburimesh mineralesh jo metalore. Mund të cilësojmë ato të Argjilave: Shkolla e Kastriotit, Zbinec etj; të Pirofilitit në Sohodoll, të Kuarciteve në Përruan e Kaut Sohodoll, Sorokol, Ceren etj, të Travertinave në Vleshë, Dipjakë, Sopanikë - Çidhën etj.; Bojrave të Dheut në Blliçe, Rrenz, Përruan e Miravecit, Përruan e Kaut Sohodoll, Varri i Kaurrit (Topuze) etj.

**Disa përshkrime të shkurtëra me foto ilustruese të disa gjeomonumenteve të njësive në fjalë**

**Burimi i Ujit të Ftohtë në fshatin Vleshë**

Ky burim gjendet pranë fshatit Vleshë, 810 - 830 m mbi nivelin e detit dhe 800 m në jug të tij. Kur udhëton nga Peshkopia për Kala të Dodës, 500 m pa vajtur në Vleshë, tek Përroi i Mullirit, në krahun e djathtë rreth 300 m larg ndodhet burimi në fjalë.

Ai del prej formacionit gjipsor, kryesisht i lloit gjips - anhidrit me ndërmjetësime lentore dolomitesh dhe materiali organik të përzier me atë argjilor me ngjyrë të murrme në të zezë. Sipas studimit (Hoxha, 2001) ky është një burim tipik i lloit karstik në formacionin evaporitik të gjipseve në Njësinë e Dibrës, që mendohen si pjesë e Zonës tektonike të Krujës. Me prurjet e tij të mëdha, ujin pastër dhe shumë të ftohtë, burimi krijon mjedis tërheqës, me vlera gjeoturistike dhe mjeksore.

***Fusha e Panairit (Punajrit)***


Ndodhet në Malësinë e Korabit, 1.5 km në VL të majës më të lartë të Korabit ose







*Pamje nga Burimi i Ujit të Ftohtë në Vleshë. Në foto mund të dallohen gjipset dhe anhidritet*






*Fusha e Panairit, 1.5 km në VL të Malit të Korabit (Shiko hartën topografike në shkallë 1 : 25 000 ku tregohet Maja e Korabit, Gjeomonumenti Fusha e Panairit me foton shoqëruese në krahun e djathtë).*

Piramidës nr. 4, me lartësi mesatare rreth 2100 m mbi nivelin e detit.

Ngjan me një amfiteatër gjigand, me shpate të pjerrëta dhe fund të sheshtë me gjatësi rreth 700 m e gjërësi 230 m. Ka formën e një grope të madhe ndërmalore. Ajo përbën një cirk të madh kompleks glacialial të vendosur mbi gëlqerorët e Devonianit, rreshpet e Silurian - Devonianit dhe, të disa daljeve të serpentiniteve.

Në të takohen dukuri të erozionit karstik duke krijuar një peisazh të rrallë malor. Ujërat që dalin në pjesën e sipërme të saj nga burime karstike me debite të bollshme si dhe ato që burojnë nga gropat akullnajore, humbasin në hapsirat karstike në fundin verior të fushës dhe në planet tektonike për tu rishfaqur pas 5 - 6 km si një burim i madh uji në zonën e Izvirit.

Nga burimet e Izvirit merret më shumë se 50 % e ujit që furnizon aktualisht qytetin e Peshkopisë dhe shumë fshatra përgjatë aksit ku kalon ujësjellësi. Si rregull këto ujëra duhen shfrytëzuar **vetëm në peiudhën e dimrit**. →

Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të Njësive Administrative të Peshkopisë, Kastriotit, Çidhnës, Lurës, Dardhës, Reçit, Sllovës, Kalasë së Dodës, Tominit dhe Melanit – me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, turizmit malor e Historik

➔ Në anën veriperëndimore gjeomonumenti rrethohet nga kreshta me lartësi 2524 m, në anën lindore-verilindore rrethohet nga Maja e Rosnikut me lartësi 2569 m (Piramida nr. 3) dhe anën perëndimore - jugperëndimore rrethohet me majën më të lartë të vendit tonë, 2754 m (Piramida kufitare kryesore nr. 4). Është një gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik e tektonik me vlera shkencore gjeologjike, gjeomorfologjike, kulturore, ekologjike dhe gjeoturistike.

**Bjeshka e Zonjave në Bjeshkën e Gramës**

Cirqet dhe liqeni i saj janë të lloit gjeomorfologjik kompleks, akullnajor etj. Cirqet e Bjeshkës së Zonjave me liqenet akullnajore**,** gjënden në Bjeshkë të Gramës, 1700 - 2000 m mbi nivelin e detit. Këtu.janë formuar cirqe, morena dhe liqene akullanojre. Liqenit në foto rreth viteve 1959 – 1960 i është vendosur digë dhe i është rritur niveli për tu përdorur për vaditje. Cirqet më të bukura e të spikatura janë formuar në shpatin e Bjeshkëve të Zonjave.

Disa janë kthyer në liqene akullnajore në pjesët e tyre të poshtme. Ky cirk përbën një shpatullim akullnajor në rreshpe, 1000 metra i gjatë, 100-180 m i gjërë dhe me pjerrësi të madhe drejt Malit të Gramës dhe Malit të Bardhë. Në formën e një katërkëndëshi të çrregullt dhe të një ballkoni të madh natyror me kullota alpine. Ai ka vlera shkencore gjeomorfologjike, ekologjike, didaktike, gjeoturistike.




*Pamje e përgjithshme e Bjeshkës së Gramës dhe e Evaporiteve (Kryesisht gjipse dhe anhidrite), respektivisht në krahun e djathtë e të majtë të Përroit të Gramës. Në të djathtë ne foto një pjesë e Gramës dhe Llapshniku.*

## *AKSI RRUGOR ARRAS - MUSTAFE - DARDHË - KRAJ REÇ*

Ashtu sikurse kemi theksuar në fillim të këtij referati ky aks ka dy alternativa për arsyet e cilësuara më sipër. Nëse në lumin Drini i Zi nuk do të ndërtohen hidrocentrale, duhet riparuar aksi i vjetër me standardet e kohës. Në të kundërt, është domosdoshmëri për të ndërtuar një rrugë të re, nga Ura e Setës në Arras, drejt fshatit Mustafe, duke vijuar mbi Zall Dardhë, drejt Kraj Reçit, me një gjatësi të përafërt prej 15 km, e projektuar mbi të gjitha kuotat e mundëshme të hidrocentraleve.

Kjo rrugë do të jetë vazhdimisht e kërkuar nga turistët si një nga akset nga ku shikohet e shijohet panorama më impresionuese e Luginës së Drinit të Zi, e Maleve të Korabit e të Gramës, Veleshica, kanionet e Drinit të Zi në zonën Shënllesh-Ura e Dodës dhe Gryka e Përroit të Mallës së Lurës (shiko listën e gjeomonumenteve), me një larmi morfologjike e shkëmbore befasuese . Rruga nga Arrasi në Kraj Reç e Zall Reç, do të vijoj më tej ose nga Kraj Reçi ose nga Zall Reçi, (varësisht projekteve inxhinierike dhe hidrocentralit) drejt Bardhaj Reçit, Hurdhë Reçit, Gjurrë Reçit, Arrëmollës, Pregjë Lurës e deri në Krej Lurë.

Midis të tjerave në këtë aks takohen shenja të mineralaleve të çmuar, dalje të gëlqerorëve të mermerizuar në zonën e Kraj Reçit në hyrje dhe në dalje të tij, me ngjyrë të kuqeremtë dhe me ngjyre të bardhë në gri, po ashtu ka perspektiva kërkimi të gurit të çmuar etj.

Me zgjatjen e këtij aksi në drejtim të Arrëmollës dhe Krejë Lurës do të kalohet afër shfaqjeve të gëlqerorëve të mermerizuar të Bardhaj Reçit dhe të Tharkës, me një ngjashmëri midis tyre, pa folur këtu në vijimësi drejt Lurës për objektet e Bakrit në Arrëmollë e Pregjë Lurë, me perspektivë në shrirje drejt Qafë Lurës, Borie Lurës e deri në Gur Lurë apo Mbasdejë, daljet e kromiteve në Kësulë, Kurjak, Krejë e Batalle apo të disa mineralizimeve jo metalore si Dunitet, shfaqjet e Asbestit etj., si dhe, për mundësitë e turizmit malorë që nga Zall Reçi e deri në Arrëmollë, Fushë Lurë etj. Turistët në këtë aks do të kenë mirësinë të njihen me një nga krahinat më bujare të Dibrës, me një kulinari cilësore të pasur e tradicionle, me monumente kulturore e arkeologjike etj. Zona e Dardhë Reçit shquhet për folklorin e pasur e prioritar në Dibër, për historinë e lashtë e të lavdishme në luftrat për liri e pavarësi ndër shekuj.

## *AKSI RRUGOR PESHKOPI - ZIMUR - MALI I GRAMËS, PESHKOPI – ZONA E BELLOVËS, PESHKOPI - MELAN - ILNICË DHE PESHKOPI - SELANE*

Rajoni i qytetit të Peshkopisë dhe periferitë e tij, njësitë e Tominit dhe Melanit, me përfundimin e Rrugës së Arbërit dhe zgjatjen e kësaj superstrade nga Herbeli drejtë Peshkopisë në rrugën më të shkurtër e të sigurt, do të jenë përftuesit e parë. E megjithatë, edhe pse janë më afër se njësitë e tjera, disa prej tyre kanë nevojë jo vetëm që të riparohen rrugët lidhëse ekzistuese më aksin në fjalë por në disa zona kërkohet të hapen rrugë të reja për ti paraprirë zhvillimeve ekonomike dhe përspektivave të turizmit të të gjitha formave që dikton ai.

Ndërtimi apo riparimi i aksit rrugor Peshkopi - Staravec - Shimçan - Bahute – Zimur (9 km), si dhe në vijim ndërtimi i rrugës së re deri në ish postën verore të Cerjanit (~ 4-5 km), në afërsi të Llapshnikut, jo vetëm do të nxiste zhvillimin në këto zona dhe lehtësonte jetesën e tyre por, do të shtonte në numër të konsiderueshën turistët e huaj dhe vendas për të shijuar jo vetëm bukuritë e Malit të Gramës dhe kënqësitë që të jep ngjitja në ato vise të nalta, por dhe mundësinë që të krijojnë për të vizituar një sërë gjeomonumentesh me vlera kombëtare e ndërkombëtare (shiko listat e gjeomonumenteve). Prej këtu mund të shikohen e shijohen pamjeve madhështore të Korabit me kreshtat, Malit të Bardhë me Pelpanikun, Grykës madhështore të Përroit të Gramës më shpatet anësore gjigande, Gradishtin dhe gjithë luginën e lumit Drini i Zi. Në njësinë e Melanit fshati Rabdisht (6. 5 km nga Peshkopia) ka hyrë në 100 fshatrat turistikë të Shqipërisë. Bujtina e Sabri Shahinit në këtë fshat është promovuar e vizitohet nga turistë të huaj. Zona e Ilnicës (Melan - Ilnicë 6 km) tashmë është bërë një atraksion turistik i njohur, me bjeshkët e saj të vizituara prej disa vitesh.

Në njësinë e Tominit, fshati Selane është bërë vërtetë një destinacion turistik me vlera i cili ndodhet katër kilometra larg nga qyteti i Peshkopisë me rrugë të pa asfaltuar (Peshkopi-Dohoshisht-Selane), pa folur këtu për lidhjet me Cetushin apo Ushtelenxën e Brezhdanin.

Në këto njësi nuk duhen lejuar që të ndërtohen hidrocentrale jashtë studimeve mjedisore siç po flitet për Përruan e Banjove apo gjetkë, sidomos nuk duhet lejuar ndërtimi i atyre që janë shkatërrues ndaj turizmit, duke degraduar vlerat natyrore të zonave përkatëse e duke lënë fermerët pa ujë vaditës. Rrugës së Arbërit dhe zgjatimit të saj në Peshkopi i duhet paraprirë me promovimin akoma më shumë të mollave, qershiave dhe kumbullave të Dibrës, si fruta me shije dhe vlera tejet të veçanta.

Në njësinë e Tominit e Melanit ka premisa gjeologjike për kërkimin e zbulimin e mineraleve të bakrit dhe mineralizimeve të manganit (Pilafe, Mali i Zimurit, Llapshnik, Guri i Kuq, Hirisim Cerjan, Hirisim Gurra etj.) Po ashtu në zonën e Pilafe Tominit ka disa vendburime Bojrash Dheu të ngjyrave e cilësive të mira. Jo pa interes duhen pare argjilat e zbuluara në objektet Vakuf, Dardha e Kubenit, Dohoshisht, Pilafe, Kodra e Xhize, etj.



*Pamje nga Burimi i Ftohtë sulfihidrik i Llixhave të Peshkopisë. Burimet e Termale janë të kaptazhuara. Ato ndodhen midis Qendrës Balneare dhe burimeve të ftohta në foto.*

Ka perspektivë për argjila cilësore e sasiore edhe zona e Pejkë - Pjeçës. Po ashtu Gryka e Përroit të Llixhave është një objekt i madh evaporitesh ku mund të gjenden e lokalizohen disa vendburime për shfrytëzimin e gjipseve dhe anhidriteve.

Vendburimi i gjipseve në lindje të Grevës në shpatin verior të Përroit të fshatit është tashmë një objekt i zbuluar e me perspektivë shfrytëzimi.

Në Njësinë e Peshkopisë ndodhet Burimi i ujrave termale sulfihidrike të njohura në të gjithë vendin, i cili veç vlerave kurative e tregtare, përben edhe një gjeomonument me vlera kombëtare që duhet mirë administruar si i tillë. Po ashtu në qytetin e Peshkopisë janë kryer një numër i konsiderueshëm edhe shpimesh hidrogjeologjike për uji të pijshëm me një debit të kënaqshëm për destinacionet për të cilat janë hapur. Shpimi i hapur pranë Pularise poshtë Dardhës së Kubenit është një model i tyre.

**<u>Si ilustrime, disa nga gjeomonumentet që takohen në njësitë administrative përkatëse</u>**

**Burimet termominerale sulfihidrike të Llixhave te Peshkopise**

Ndodhen rreth 1.6 km ne lindje te qytetit te Peshkopise, në Luginën e Përroit të Banjave ose Llixhave, ne afersi te kontaktit te formimeve flishore te Paleogjenit (rreshpe argjilo-ranorike etj. te Eocenit) me Evaporitet e Triasikut apo Permian Triasikut (gjipse, anhidrite, selenite, krypera etj.). Takohen ne trajten e dy burimeve me nje debit te kenaqshem (8 l/sek dhe 14 l/sek) dhe temperature $35^0$ - $42^0$ C, aktualisht të kaptazhuara. Burimi lidhet me kontaktin tektonik të flisheve te Eocenit me formacionet e gjipseve të Njësisë Dibra (Zona tektonike Kruja) dhe me kontakte të tjera brenda për brenda evaporiteve.

Eshtë ndër burimet termale me veti të mira kuruese e njohur edhe në rajonin e Ballkanit. Ujërat termo - minerale sulfihidrike (49 mg/l – $H_2S$), perveç vlerave te larta kurative per disa lloje semundjesh, si dhe kane rendesi shkencore ne fushen e gjeologjise, hidrogjeologjise, tektonikës dhe me vlera turistike.

**Shpella e Qytezës** përfaqëson një dukuri karstike të formuar në depozitimet evaporitike të Permian-Triasikut. Ndodhet në lindje të fshatit Bellovë në lartesinë rreth 1100 m mbi nivelin e detit. Shkëmbi gjipsorë ku ndodhen shpellat njihet edhe me emrat Kepi i Xhitetit dhe Kodra e Kullave. Paraqitet me dy hyrje me një shtrirje gati vertikale në 3 - 4 metrat e para me dimensione 1.5 x 2 m dhe hapet në thellësi deri në 80 m në drejtime të ndryshme dhe me mjaftë vështirësi lëvizjeje. Në të ka mbetje të veprimtarisë së njeriut të lashtë dhe ka vlera shkencore gjeologjke, kulturore etj.

***

**Në vend të mbylljes**

Autoritetet shtetërore duhet **të inicojnë ndërtimin e një albumi praktik unik ose libër me ilustrime në foto e shënime sqaruese të shkurtëra** për objektet turistike të zonës, të të gjitha kategorive të tyre, me cilësimin e rrugëve për të vajtur në destinacionet e tyre etj., duke rritur kësisoj interesin e turistëve vendas e të huaj.

Ky albun duhet **të përpilohet nga specialistë të fushave dhe redaktohet me korrektësi të madhe,** jo të ndërtohet nga specialistë të pa përgatitur siç edhe është vepruar deri më sot.



*Pamje e përgjithshme e pjesës perëndimore të objektit të Gjipseve në Përruan e Grevës*

# studimi

*Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të Njësive Administrative të Peshkopisë, Kastriotit, Çidhnës, Lurës, Dardhës, Reçit, Sllovës, Kalasë së Dodës, Tominit dhe Melanit – me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, turizmit malor e Historik*





Shpella e Sopanikës, monument natyre.

Në internet dhe rrjetet sociale, në mënyrë të organizuar, duhet të hidhen vazhdimisht foto cilësore të këtyre objekteve turistike, me sqarimet e nevojshme të specializuara jo amatoreske.

Artikujt e autorëve të renditur në burimet e literaturës dhe shumë të tjerëve në pamundësi citimi, mendojmë se duhet të jenë nga udhërrëfyesit kryesorë të hartimit të albumit.

Njerëzit po ndërgjëgjësohen çdo ditë e më shumë të ruajnë trashëgiminë e natyrës, ambientin, pasi me të drejt **historia e tokës nuk është më pak e rëndësishme se historia njerëzore**.

Trashëgimia është vlerë që përcillet brez pas brezi, ku natyra zë vend të veçantë. Shumë kanë shkruar për gjeomonumentet e Dibrës, autorët e të cilëve duke mos qenë specialist të fushës lenë shumë për të dëshiruar në përshkrimet e bëra duke dhënë mesazhe të gabuara në shumë drejtime për turisat.

Koncepti i zones së mbrojtur ka evoluar shumë, ajo tashmë rrok shumë vlera të veçanta mjedisore: "biodiversiteti, bukuria e peisazhit, formacione të rralla gjeologjike, forma të veçanta të relievit, vlera hidrografike, tradita të pasura kulturore, arkitekturore, pasuri arkeologjike, etj." (Neziraj etj. 2015).

**Gjeomonumentet** janë objekte të natyrës jo të gjallë, të cilat kanë vlera të mëdha shkencore, gjeologjike, kulturore, didaktike etj. si dhe vlera ekonomike. **"Zona të mbrojtura"** shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore. Mbështetur në eksperiencën ndërkombëtare, përvojën tonë, gjeomonumentet i kemi ndarë në tre grupe:

**a) Gjeomonumentet lokale**, ku janë klasifikuar ato gjeomonumente që, për nga fenomeni përfaqësues, takohen/shtrihen në rrethinat, territorin e një bashkie apo qarku. Këto fenomene gjeologjike kanë rëndësi lokale dhe i shërbejnë zhvillimit të komuniteteve në zonat ku lokalizohen.

**b) Gjeomonumentet kombëtare**, ku futen ato gjeomonumente të cilat janë unike ose janë më të mirat e llojit të tyre në nivel vendi.

**c) Gjeomonumentet ndërkombëtare (regjionale)**, janë ato gjeomonumente të cilat përfaqësojnë fenomene gjeologjike unike në nivel ndërkombëtar ose më të mirat e llojit të tyre në se i takojmë në një rajon tjetër.

I. **Gjeoparqet:**

I. 1. Parku Natyror Korab – Koritnik; I. 2. Parku Kombëtar i Lurës; I. 3. Monumenti Natyror Vlashaj

**II. Gjeomonumentet:**

**II. a. Disa gjeomonumente me vlera regjionale:**

II. a. 1. Alloktoni i Gramës; II. a. 2. Dyshemeja metamorfike në Gur Lurë; II. a. 3. Kupola evaporitike e Malit të Bardhë; II. a. 4. Burimi termomineral sulfihidrik i Llixhave të Peshkopisë; II. a. 5. Liqeni i Luleve (Lurë); II. a. 6. Liqeni i Zi (Lurë); II. a. 7. Liqeni i Madh (Lurë); II.a. 8. Rrafshi i Korabit në M. e Korabit;

**II. b. Disa gjeomonumente me vlera kombëtare**:

II. b. 1. Bjeshka e Zonjave (ne Bjeshken e Grames); II. b. 2. Kanioni Shënllesh - Zall Reç dhe Ura e Dodës – Tejdrine; II. b. 3. Keproku konik mbi evaporite në Përroin e Banjave; II. b. 4. Liqeni i Zi (mbi fshatin Tejzë (Tejs); II. b. 5. Burimi dhe shpella e Sopanikës; II. b. 6. Kroi i Mbretit – Sorokol; II. b. 7. Kanionet e Grykës së Setës, Kepi i Xhitetit - Çidhën - Gur – Lurë;

**II. c. Disa gjeomonumente lokale:**

II. c. 1. Cirqet akullnajore të Bjeshkës së Shehit; II. c. 2. Shpella e Rusit (Grykë Nokë); II. c. 3. Shpella e Qytezës; II. c. 4. Pasqyrat e Pelpanikut (Gjipsit të lloit Selenit), në lindje të Malit të Bardhë dhe perëndim të Varrit të Sejmenit; II. c. 5. Burimi i Ujit të Ftohtë, Vleshë; II. c. 6. Fusha e Panairit; II. c. 7. Gryka e Madhe e përroit të Mallës së Lurës; II. c. 8. Shëllinasi i Lapshnikut; II. c. 9. Burimet e Bellovës; II. c. 10. Morenat e Fushë Lurës; II. c. 11. Cirku i Kurorës së Lurës; II. c. 12. Lugina Karstike e Krej-Lurës; II. c. 13. Fusha e Pelave, Lurë; II. c. 14. Kodra e Gjatë, Blliçe; II. c. 15. Lugina Karstike e Mërkurthit; II. c. 16. Liqenet akullanjore të Staneve të Preshit; II. c. 17. Fusha e Lanë Lurës; II. c. 18. Lugina e Xharxhishtës; II. c. 19. Lugina e Pratit mbi Grykë Nokë.

**Më poshtë japin listën e monumenteve të natyrës të miratuara me VKM Nr. 676, datë 20. 12. 2002. (1-9 janë biomonumente; 10-33, janë gjeomonument) Bashkia Dibër.**

1. Hartinat e Lurës (Njësia Administrative Lurë); 2. Rrobulli i Lurës (Njësia Administrative Lurë); 3. Pisha e Blliçes (Njësia Administrative Fushë Çidhën); 4. Rrapi i Çidhnës (Plepi i Çidhnës, Njësia Administrative Arras); 5. Ahu i Blliçes (Njësia Administrative Fushë Çidhën); 6. Lisi i Kabe (Njësia Administrative Tomin); 7. Vakufi i Çengës (Njësia Administrative Tomin); 8. Vakufi i Sinës së Sipërme (Njësia Administrative Arras); 9. Boroviku i Begjunecit (Njësia Administrative Melan); 10. Karsti i Malit të Bardhë; 11. Gropa e Panairit (Fusha e Punajrit thirret nga banorët e zones); 12. Bjeshka e Zonjave, Gramë; 13. Shpella e Rusit (Grykë Nokë); 14. Shpella e Akullit (Bulaç); 15. Shllinasi (afër rrjedhjes së sipërme të Përroit të Gramës, Llapshnik); 16. Gryka e Madhe - Lurë (Nga ana jonë përmasat e grykës jepen më të mëdha); 17. Rrafshi i Korabit; 18. Cirku i Kunorës së Lurës; 19. Kodra e Gjatë - Blliçe; 20. Fusha e Pelave - Lurë; 21. Liqeni i Luleve - Lurë; 22. Liqeni i Zi - Lurë; 23. Liqeni i Madh - Lurë; 24. Liqeni i Zi (mbi Tejs); 25. Burimi termomineral sulfihidrik i Llixhave të Peshkopisë; 26. Burimi dhe shpella e Sopanikës (Çidhën e Poshtme); 27. Burimet e Bellovës; 28. Burimi i Ujit të Ftohtë - Vleshë; 29. Kroi i Mbretit - Sorokol; 30. Pasqyrat e Pelpanikut; 31. Shpella e Qytezës (afër Bellovës); 32. Gryka e Setës (Pjesa nga Kepi i Xhitetit - Gur Lurë); 33. Morenat e Fushë - Lurës;

***Burimet*** *(Literatura)*

*Ashiku A. (2017). "Natyra dibrane, <guaska> që mban perlën e bukurisë shqiptare", Gazeta "Rruga e Arbërit".*

*Baleta A. (2007). "Sali, hapi dy arteret koronare të Shqipërisë", Gazeta "Rruga e Arbërit".*

*Bunguri A. (2010). "Prehistoria e Dibrës", libër.*

*Bitri Rr. (2016). "Prapë na çeli Grama", gazeta Rruga e Arbërit.*

*Hoxha A. (2014). "Kjo përmendore na kujton se të parët tanë këtë truall e kanë mbrojtur me gjakun dhe jetën e tyre." Gazeta Rruga e Arbërit.*

*Hoxha V, etj. (2000). "Studim prognoze mbi sasinë e cilësine e gjipsit, anhidritit dhe selenitit ne objektet e Evaporiteve të Dibrës". Arkivi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar,Tiranë.*

*Hoxha V. (2001). "Tiparet themelore të gjeologjisë dhe perspektiva e kërkimeve në rajonin Kërçisht-Sorokol".*

*Disertacion, Universiteti i Tiranës. Biblioteka Kombëtare, e UPT-së dhe FGJM-së, Tiranë.*

*Hoxha. V, etj. (2005). "Përpilimi i Hartës së Rrezikut Gjeologjik në Shkallë 1:50 000 për Rrethin e Dibrës, për vitet 2004 - 2005". Arkivi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar,Tiranë.*

*Hoxha V, etj. (2003). Studim me temë: "Administrimi i Territorit dhe i Resurseve Natyrore per Rrethin e Dibres, Qarku Dibër, per vitet 2001-2003". Arkivi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar,Tiranë.*

*Hoxha V., etj. (2011). "Geological sites and landscapes in Dibra region". Mineral Resources and their perspective, International Geo-Science Conference "GeoAlb 2011" -27 - 30, September 2011. Mitrovicë Republic of Kosovo.*

*Hoxha V. (2000). Raport shkencor me teme: "Harta gjeologjike edhe e pasurive minerale te rrethit Diber, me shkallë 1 : 50 000 me tekstin shpjegues perkates». Arkivi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar,Tiranë.*

*Hoxha V. (2019). Dorëshkrim i librit "Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës".*

*Hoxha V. (2019). Dorëshkrim i librit "Shënime në Çadër".*

*Hoxha V. (2007). "Rruga e Arbërit, rruga e zhvillimit të Shqipërisë lindore". Botuar në gazetën "Rruga e Arbërit".*

*Hoxha V., B. Lleshi etj. (2007). "Pasuritë minerale të rajonit të Dibrës që mund të vuhen në qarkullim ekonomik me ndërtimin e Rrugës së Arbërit". Kuvendi tekniko - shkencor për Rrugën e Arbërit, maj 2007.*

*Hoxha V. (2018). "Ndërtimi i Rrugës Arras - Lurë, domosdoshmëri për zhvillimin e turizmit dhe kërkimin e mineraleve". Botuar në gazetat "Telegraf" dhe "Rruga e Ar bërit".*

*Kaca I. (2003). "Rrugët e vjetra të Dibrës", libër.*

*Kodra A., Hoxha V. (2015). Tectonic Features Of The Reservoir And The Dam Area Of Skavica Hydropower Plant Report (Explanatory text of formational - tectonic Map at 1:25 000 scale of reservoir and dam area of Skavica HPP). Tirana, Aprill, 2015.*

*Karoshi B. (2017). "Me Rrugën e Arbërit Dibra kthehet në kopshtin e Tiranës". Gazeta Rruga e Arbërit.*

*Kaba F., etj. (2007). "Studim për mundësinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit". (Përmbledhje e studimit të fizibilitetit). Kuvendi tekniko-shkencor për Rrugën e Arbërit".*

*Lleshi B. (2010). "Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë (jo metalorë) të Shqipërisë" (Libër për studentët e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave etj.)*

*Lleshi B. (2006). "Rruga e Arbërit i shërben edhe zhvillimit të shpejt të turizmit malor dhe njohjes së mëtejshme të historisë". Gazeta Rruga e Arbërit nr. 6, tetor 2006.*

*Lleshi B., Dibra A. (2007). "Rruga e Arbërit premisë për zhvillimin e turizmit". Kuvendi tekniko - shkencor për Rrugën e Arbërit, maj 2007.*

*Lleshi B. (2017). "Rruga e Arbërit i shërben edhe zhvillimit të mëtejshëm të turizmit malor" Gazeta Rruga e Arbërit, mars 2017.*

*Lleshi B. (2017). "Rruga e Arbërit i shërben edhe njohjes së mëtejshme të historisë Gazeta "Rruga e Arbërit", prill 2017.*

*Lleshi B. (1983). "Ndëtimi gjeologjik dhe perspektiva mineralmbajtëse e masivit ultrabazik të Lurës." Disertacion. Arkivi i ISPGJM, Tiranë.*

*Lleshi B. (2008). "Gjeologjia e Rrugës së Arbërit", libër.*

*Lleshi B. (2008). "Pse lejohet të bëhen ndryshime të aksit të rrugës së miratuar në studimin e fizibilitetit në dëm të cilësisë së saj". Gazeta Rruga e Arbërit dhe Gazeta Ekonomia.*

*Martini Xh. (2014). Hilmi Kolgjegja – Një vend në panteon (studim monografik).*

*Neziraj A., Moisiu L., Avxhi A., Ahmetaj A., Misha Zh. (2015). Nënprojekti: "Gjeomonumentet sipas Bashkive në shkallën 1:50 000)". -Bashkia Dibër. Arkivi SHGJSH-së, Tiranë.*

*Qiriazi. P., Sala S. (2006). "Monumentet e Natyrës së Shqipërisë", libër.*

*Repa H. (2014). "470 vjetori i Betejës së Torviollit". Gazeta Rruga e Arbërit.*

*Skeja M. (2016). "Pesë kuriozitete rreth Kalasë së Dodës", gazeta Rruga e Arbërit.*

*Seiti Xh. (2006). "Rruga e Arbërit integron jo vetëm Dibrën", Gazeta "Rruga e Arbërit".*

***SHËNIM:***

Ndalohet kopjimi i këtij materiali apo përdorimi i tyre, me çdo lloj apo mjeti, përveç rasteve kur shërben si burim referimi. Materiali i mësipërm është punë origjinale e autorëve ndaj çdo keqpërdorim i tij, pa miratimin e autorëve është i ndaluar. Çdo shpërndarje përmes internetit duhet të ruajë linkun e botimit origjinal.

reportazh

**Në qershor 2019, Zall Dardha feston 70-vjetorin e ansamblit "Kuvendi", që për shumë vite ka qenë bërthama e çdo grupi artistik që përfaqësonte Dibrën.**

# Një udhëtim në **Zall-Dardhë,** *bahçen e artistëve*



*Nga* **ILMI DERVISHI**

Fugoni me të cilin po udhëtonim nga Peshkopia për Zall Dardhë tani më nuk e ka stacionin te Ura e Lushës, buzë Drinit të Zi, një urë e ndërtuar në kohën e Ali Pashë Tepelenës, por rruga e asfaltuar kalon nga Laçesa deri te përroi i Blliçes, më pas, nëpër Fushë Alie vazhdon e parregulluar. Makina kalon në mes shtëpive të banimit në rrugën pa asfalt, duke ndjekur rrjedhjen e Drinit, paralel me rrugën Peshkopi-Kukës, siç quhet ndryshe "Rruga e Rinisë".

Duke ndjekur gjarpërimin e lumit mes gjelbërimit në të dy brigjet, bukurinë dhe freskinë e këtyre ditëve fundmuaji maj, krejt rastësisht m'u kujtuan vargjet e Mjeshtrit të Madh, Haziz Ndreu te poema "Valët e Drinit të Zi", botuar në vitin 1966: Drini i Zi ecën me shkulma valë-valë, / Tue u përplasun nëpër kepa ballë e ballë, / Herë në shtrat e herë prej shtratit tue dalë, /Len në të majtë të dy Malet Reç e Dardhë...

Ashtu, duke rikujtuar këto vargje arritëm te ura e re e ndërtuar vitet e fundit, që lidh dy brigjet mbi Lumin Drin, pak pa dalë në Lagjen Topuze të fshatit Lugjej. Nga Ura e Muhurrit e deri te Ura e Dodës në të dalë të Reçit, kjo urë është e vetmja në këtë segment që lidh dy brigjet me rrugë makine e që i dha një impuls lëvizjes, por dhe shkurtim i distancës Peshkopi-Zall Dardhë me 12 km.

Tanimë rruga automobilistike vazhdon duke lënë në të djathtë lagjen Topuze, Shatorret, një toponim që në kohën e Skënderbeut. Sapo kalon Lakun e Canit, duket Zall Dardha, Devishet e Lugjejt. Makina mori kthesën te përroi i Shehit dhe për pak minuta në qendrën e Zall Dardhës. Një shesh i madh, me ata ndërtesa gati në formë rrethi, spitali, shkolla, dyqane, bar bufeja e fshatit e gati në mes tyre një ndërtesë dy katëshe e mbajtur mirë dhe e lyer bukur, ku janë zyrat e administratës. Kjo ndërtesë, ku të dy katet janë ndërtuar me mur guri, kanë qenë zyrat e para të lokalitetit në vitin 1952.

### INVESTIMET E MUNGUARA

Pas një përshëndetje në zyrën e gjendjes civile me z. Xhemali Cani ngjitemi në katin e dytë te administratori i Njësisë Administrative z. Abas Kaca. Folëm për gjendjen ekonomike, shërbimin shëndetësor, investimet, arsimin, lëvizjen e popullsisë, migracionin e brendshëm e për shumë shqetësime të popullit të kësaj zone.

"Numri i popullsisë ka ardhur në rënie si shkak i lëvizjes së lirë të njerëzve drejt Tiranës, Durrësit e gjetkë, thotë Abas Kaca, me profesion mësues, por tashmë administratori i njësisë bashkiake të Zall Dardhës.

Ai thotë se një jetesë më të mirë, një shkollim më të mirë për fëmijët janë arsyet kryesore të migracionit. Sipas tij, sot popullsia është 1286 banorë, nga 3592 që ishin në vitin 1992.

Largimi i shumë familjeve në Tiranë, Durrës e gjetkë, ka lënë gjurmët e saja në shembjen e disa shtëpive nga koha dhe nga moskujdesja. Fusha e Dardhës është tokë pjellore, por nuk plotëson të gjitha nevojat, ndaj shumica jetojnë me ndihmën ekonomike, me të ardhurat nga emigracioni.

Një copë rrugë në këmbë nga qendra drejt urës së telit që lidh Zallin me Lugjejt e bëra në këmbë, duke shijuar bukurinë dhe kujtimet e mia. Ura e telit, legjenda e viteve që shpesh mungonte investimi për ta mirëmbajtur, u bë një investim i madh nga ish Komuna, por tani kanë filluar shenjat e kalbjes së dërrasës dhe duhet mirëmbajtur.

**Një vlerë artistike e shpirtit artistik të dernjanëve shikohet edhe në botime librash. Janë 19 autorë dernjanë që kanë botuar 31 libra, duke filluar nga Haziz Ndreu me 10 libra letërsi e studime historike. Kështu, në vitin 1961 boton librin me poezi "Ushtima e maleve", poemën epope "Dibra ime" apo librin poetik "Valët e Drinit të Zi...**

Është jetike për popullsinë e dy anëve, por dhe zonave fqinje. Nebetat, kështu quhet toka e sheshtë nga shtëpitë e Dervishe deri në breg të Drinit. Janë toka të mira e shumë prodhuese. Ndonëse shpesh e përmbyste lumi, por këto vitet e fundit çdo vit më pak, falë investimit me argjinaturë mbrojtëse, si dhe rritja e shelgjeve, por mungon uji vaditës. Kanali që vinte nga Veleshica u mbyll nga erozioni dhe ato pak familje që kanë mbetur nuk e përballojnë dot, duhet investim për ta rihapur atë kanal. Po kështu, tokat e Cale, Rrafshet e Xhoxhe, ku në të dy anët e varrezave rrafshet janë djerrë, vetëm për kullotë e diku-diku mbuluar me ferra, duke u sjellë një dëm të madh ekonomik familjeve.

"Investimet publike kanë qenë me ritme të ngadalta, - tregon Abas Kaca. Por dhe ato pak investime janë kryer disa vite më parë, kur ishin komuna, janë jo cilësore dhe gati gjysmake deri dhe në keqpërdorim të fondeve publike". Sipas tij, investimi më i rëndësishëm i kësaj zonë, që i ka shërbyer shumë komunitetit ka qenë ndërtimi i urës mbi lumin Drini i Zi pranë lagjes Topuze, në vitin 2011-2012, e cila e ka shkurtaur distancën me Peshkopinë me 12 km.

Sipas administratorit të kësaj njësie, sot 65 për qind e popullsisë së Dardhës jetojnë me ndihmë ekonomike. Bujqësia dhe blegtoria nuk janë shumë të zhvilluar, por sadopak ndikon në përmirësimin e të ardhurave financiare. Një rol të madh në përmirësimin e jetës social-ekonomike janë dhe të ardhurat nga emigracioni.

Vazhdimi i punimeve në Rrugën e Arbërit ka ngjallur një shpresë për gjallërimin e ekonomisë së zonës.

Sipas Kacës, njerëzit kanë filluar të rikthehen dhe kjo është e rëndësishme. Vijnë dhe banojnë, rikonstruktojnë shtëpitë e tyre, mbjellin blloqe me pemë frutore si qershi, mollësh, lajthi dhe arra dhe gjithë kjo ka ngjallur shpresën se ekonomia lokale mund të ketë një përmirësim në të ardhmen e afërt.

Në të dyja anët e Drinit, Dardha ka toka të mbjella dhe livadhe, por dhe ato pak shtëpi janë veshur me pemë nga të gjitha llojet që rriten në zonë. Të ngjitesh për Lashkizë, drejt Majës së Madhe për në Lurë, ka vërtet bukuri natyrore mahnitëse. Qani është një fshat rrethuar mes malesh, si një amfiteatër me ujëra të rrjedhshëm.

Këtu është vendlindja e këngëtares, Artistes së Merituar Lirie Rasha. Ashpërsia dhe bukuria e maleve janë në harmoni, siç janë trimëria dhe mirësia e njerëzve të kësaj treve nëpër shekuj. Ja dhe shtëpitë e Hyse, ing. i pyjeve Ismail Hysa, një dashamirës i vendlindjes, një studiues i gjithë bimësisë dhe drurëve, së bashku me shkrimtarin Shaqir Skarra kanë shkruar dhe një libër monografi "Hakik Hysa i Dardhës" e mua m'u kujtuan disa vargje të këngës së kënduar nga Sherif Dervishi: Ka ra dielli në ballë të Lashkizës,/ Dritë po bën Kulla e Hysës.

Duke ndjekur rrjedhjen e Drinit të Zi në segmentin ku lag tokat e Dardhës nga Rrasa e Bollës te Rrasa e Keqe, atje ku lumi përplaset me shkëmbin sikur do të mbrojë fushën e Dardhës, që në kohën ku aty ka qenë qytet, pasi aty janë rrënojat e Mejës së Xhitetit, QYTETIT, duke devijuar pak majtas duke formuar Bunarin e Xhaferr Lucës përballë Mejes së Qytetit, merr drejtimin drejt Bunarit të Metës, duke e ndarë në mes Fushën e Dardhës dhe Nebetat e Dervishe.

Është interesant dhe i bukur vendi ku Veleshica bie pingul, duke u derdhur bashkë me inerte në lumin Drin dhe pamjet e bukura panoramike vazhdojnë deri në Kukës, por kanioni i Shënlleshënit ka një pamje piktoreske dhe të veçantë. Në një sesion shkencor për rrugët lidhëse me Rrugën e Arbërit dhe resurset turistike, ing. gjeolog prof. Vesel Hoxha foli dhe për Kaonin e Shënlleshënit si resurs turistik.

### DARDHA, DJEPI I ARTISTËVE

Shpesh në biseda mes miqsh, por dhe ne njohës, studiues apo mbledhës të folklorit thuhet Zall Dardha është djep kulture. Vend i artistëve apo dhe bahçe folklori. Kjo ka arsyet e veta dhe vërtetësinë e kësaj të vërtete. Zall Dardha këtë qershor 2019 feston 70 vjetorin e Ansamblit artistik "Kuvendi", që në vite të tërë ka qenë bërthama e çdo grupi artistik që përfaqësonte Dibrën. Në vitin 1957 vallja e të rinjve të Dardhës morën vlerësime në sallat e Moskës në ish Bashkimin Sovjetik. Zall Dardha ka muzikantë të mirëfilltë, ka këngëtarë me potencial e me vlerësime në shkallë republike, ka Mjeshtër të Madh, Artist të Merituar si Muharrem Xhediku, Haziz Ndreu, Lirie Rasha, Qerim Sula Sajhe Poleshi, Sherif Dervishi apo Bledar Kaca e tjerë. Por nëse shikon tregun muzikor apo kanalin muzikor You Tube, gjejmë shumë këngëtarë dernjanë që kanë disa këngë e videoklipe, si Rrushdi Dervishi, Metush Luca, Sadin Poleshi, Avni Dervishi, Xhelal Çerpja apo Gentjan Dervishi e të tjerë. Po kështu, muzikanti Qemal Toluli, mësuesi i muzikës, instrumentisti Ramadan Dervishi e tjerë.

Një vlerë artistike e shpirtit artistik të dernjanëve shikohet edhe në botime librash. Janë 19 autorë dernjanë që kanë botuar 31 libra, duke filluar nga Haziz Ndreu me 10 libra letërsi e studime historike. Kështu, në vitin 1961 boton librin me poezi "Ushtima e maleve", poemën epope "Dibra ime" apo librin poetik "Valët e Drinit të Zi", për të cilët u prit mirë nga lexuesi dhe kritika letrare dhe sot vetëm ata që dinë përmendësh disa vargje, sepse libri nuk është më për lexuesit e kjo do të thotë se ka ardhur koha të ribotohen. Po kështu, disa libra poetikë si "Pengu i dritës" nga Ramadan Topuzi apo romanet "Zhgënjimi", "Shpresë e thyer" etj. Krahas këtyre botimeve, janë autorë të tjerë që nuk janë dernjanë, por kanë shkruar libra për personalitete e figura historike të Dardhës, emra të njohur si profesor Bujar Kapexhiu, Mjeshtër i Madh, shkrimtari Xhafer Martini, Xhezair Abazi, historiani Mois Murra e të tjerë.

*Zall Dardhë, maj 2019*

portret

**Dardha, qershia, lajthia, patatja, misri e gruri, varietete që kultivohen duke gërshetuar tradicionalen me bashkëkohoren**

# **Shefik Fisniku,** *një jetë mes eksperimenteve*

*Nga* **OSMAN XHILI**

Në kapërcyell të mijëvjeçarit te dytë, Shefik Fisniku nga Trena e Dibrës u drejtua tek blektoria, si stacion nga ku mund të nisej drejt suksesit. Fillimisht mori një mëshqerë të racës "Taranteze", e cila pati rezultate mbresëlënëse. Që në vitin e parë jepte 28 litra qumësht, të një cilësie mjaft të lartë. Shtoi dhe dy lopë të tjera, po me këto parametra, duke e bërë këtë lloj biznesi për shtatë vjet me radhë. Thithja e paktë nga tregu, çmimi më i ulët se pijet e ngjyrosura me pigmente, mungesa e subvencioneve shtetërore e plot faktorë të tjerë, e lodhën Shefikun dhe e detyruan të ankorohet diku tjetër, në detin e trazuar të jetës.

Shkoi në Itali, si shumë emigrantë të tjerë për gjashtë vjet. Me gjithë vështirësitë e shumta, fitoi jo pak. Fitoi një gjuhë të huaj, fitoi një sasi të konsiderueshme parash, por fitoi dhe një përvojë, që do ti vlente shumë në të ardhmen. Shefiku kishte mbaruar shkollimin e mesëm për agronomi, por këtu ai mësoi si të krasiste me teknikat e reja, si tu jepte pemëve formën e palmetit , të njihte sëmundjet e dëmtuesit dhe mënyrat e luftimit të tyre. "Vetëm ullirit nuk kam ç'farë ti bëj, - thoshte italiani Viçenso, - se pemët e tjera i fus të gjitha në palmet".

Rikthehet në Shqipëri me plane të reja, për të investuar tashmë në frutikulturë. Kultura e dardhës e tërhiqte mjaft. Aroma, shija, pesha e kokrrave, uria e tregut dhe kërkesa për të, ishin arësye të mjafta për të mbjellur katër dynymët e parë me dardhë të varietetit "Kristal". Por, ashtu siç kishte dhe emrin, aq delikat kishte qenë. Zjarri bakterial e kroma përpinin gjethet, frutat dhe gjithë trungun, duke e bërë të pamundur betejën. Duhej një lloj tjetër më rezistent dhe ai zgjodhi "Santa marinë". Vitin e kaluar prodhoi rreth 60 kunjtalë, me një vlerë përfituese prej katër miljonë lekësh. Vitin e ardhshëm dëshiron të shtojë dhe gjashtë dynymë të tjerë me këtë kulturë, duke plotësuar një hektar në total.

Katër vite më parë Shefiku vendosi të futet me kulturën e qershisë. Llogaritë duheshin bërë mirë, pasi bëhej fjalë për një sipërfaqe prej dhjetë dynymësh. Ishte vërtet një vend i mrekullueshëm, një kodrinë e bukur që ngrihet mbi fshat, përballë kodrës së vakufit, që mban antenën. Shefiku donte që ngjyrën në të kuqe të tokës ta mbulonte me gjelbërimin e pemëve të reja, donte që tokën e vdekur ta kthejë në një dyqan , që do ti sillte fitime të shumta, donte që shokët e miqtë ta vizitonin bllokun e të mrekulloheshin prej tij.

Dy ishin problemet që mund ta rrezikonin në sipërmarrjen e re, nënshartesa rezistente dhe variteti po i tillë. Ai shihte përqark ankesa që vinin nga nënshartesa vegjetative,



**Në kapërcyell të mijëvjeçarit te dytë, Shefik Fisniku nga Trena e Dibrës u drejtua tek blektoria, si stacion nga ku mund të nisej drejt suksesit. Fillimisht mori një mëshqerë të racës "Taranteze", e cila pati rezultate mbresëlënëse. Që në vitin e parë jepte 28 litra qumësht, të një cilësie mjaft të lartë. Shtoi dhe dy lopë të tjera, po me këto parametra, duke e bërë këtë lloj biznesi për shtatë vjet me radhë. Thithja e paktë nga tregu, çmimi më i ulët se pijet e ngjyrosura me pigmente, mungesa e subvencioneve shtetërore e plot faktorë të tjerë, e lodhën Shefikun dhe e detyruan të ankorohet diku tjetër, në detin e trazuar të jetës.**

problemet në zënje, tharja e fidanëve në vitet në vazhdim dhe imuniteti i dobët. Do ti rregullonte vetë punët nga fillimi. Kishte dëgjuar se Bilbil Sopoti nga Brezhdani kishte trajtuar në fidanishten e tij fidana njëvjeçare qershie të pa shartuar. Farat i kishte marrë nga qershi të egra të fshatit të Zagradit, në lartësi 1500 metra. I bleu ashtu në gjendje të egër, pasi shartimin do ta bënte vetë. Përzgjodhi tre lloje, "Burlatin" e hershëm, " Lë penin" francez dhe "Ferrovian", ku kjo e fundit dominon tre pjesë të territorit të mbjellë. Këtë rradhë nuk u gabua. Fidanat e shëndetshëm u aklimatizuan shumë shpejt, duke dhënë një masë të gjelbërt, por dhe kokrrat e para. Vetëm vitin e parë patën nevojë për vaditje e më pas zgjatën rrënjët e fuqishme për ta kërkuar ujin në thellësi.

Para dy vitesh bllokun e ri të qershive e viziton një mik i madh i shqiptarëve, profesori francez i pemtarisë, Patriku. Jo, ai nuk mund ta besonte që fidanat që kishte para sysh të ishin në vitin e dytë. Të paktën janë katër vjeçarë, këmbëngulte profesori. Kur Shefiku i shpjegoi se ku e kishte marrë nënshartesën, profesori u bind dhe e përgëzoi fermerin.

Kanë kaluar vetëm katër vjet dhe Shefiku është i kënaqur me investimin. Janë 270 rrënjë në total dhe ka prej tyre, që kanë rreth 20 kilogramë që këtë vit. Ai e frezon sipërfaqen e tokës katër pesë herë çdo vit, pasi në të kundërt fieri dhe ferrat e pushtojnë sipërfaqen, duke sjellë probleme të shumta. Për ta rrethuar sipërfaqen fermeri ka zgjedhur një mënyrë origjinale, duke mbjellur lajthi. Rreth 200 fidana lajthi italiane kanë filluar të hedhin shtat e bëhen gati për të hyrë në prodhim.

Ngjitur me bllokun në fjalë, vjen një sipërfaqe e tarracuar, që zbret deri poshtë në luginë. Dhe ajo është mbi dhjetë dynymë e në të gjenden të mbjellë rreth 200 rrënjë lajthi. Vitin tjetër fermeri mendon të shtojë dhe treqind rrënjë të tjera, duke e çuar në 700 rrënjë numrin në total, kurse sipërfaqen e pemtores në tre hektarë.

Shefiku ka tre fëmijë. Dy djemtë, Enriku dhe Fatbardhi, janë në emigrim, në Gjermani dhe Itali. Dhe pse janë mjaft punëtorë, i ati i tyre ka një pakënaqësi , sidomos ndaj Enrikut, që iku para disa ditësh. Po si më la?- pyeste i jati, pa marrë përgjigje. Po, a pak punë kishte këtu? Po a mund ti përballoj vetë të gjitha? Flet kështu e një nerv i lëviz nga mollëza, poshtë në faqe. Shpejt qetësohet, pasi e ka një aleat, një ndihmës që punon për të vetëm për bukën e gojës. Ai është një traktor i ri, i fuqishëm me 55 kuaj fuqi, me agregate të tjera si pompë spërkatëse, frezë, korrëse jonxhe, plug, karrocë.Atë e ka fituar para katër vitesh, falë një aplikimi te programi " Sared". Falenderimet e tij shkojnë për drejtuesit e programit në qendër, por dhe për kordinatorin e projektit, Dali Horeshkën, mikun tonë të palodhur, që aplikimet e fermerëve i materializoi në mjete dhe vlera reale për përfituesit.

Shefiku ka dhe shumë përvoja të tjera në jetën e tij. Para pesë vitesh mbolli tre dynymë me sherebelë, në kuadrin e skemave të subvencionit. E trumbetuar si shpëtim për fermerët e Dibrës, shumë prej tyre vunë në dispozicion të kësaj kulture tokën, fuqinë fizike, mjetet mekanike dhe disa kursime familjare. Në vitin e dytë e gjithë skema u trondit e u thërmua, për tu harruar njëherë e mirë, duke ripluguar plantacionet e mbjella me aq mund, pasi çmimi i grumbullimit ra në mënyrë të befasishme. Një eksperiencë tjetër disi të hidhur e pati Shefiku me mëllagën e bardhë. Në fakt, dështimi nuk ishte tek fermerët, pasi ata i bënë më së miri detyrat që u takonin. Dështimi ishte tek ata që u sugjeruan të mbillnin bimë të tilla mjekësore, pa pasur asnjë lloj garancie për tregjet brenda dhe jashtë vendit. Nuk di pse, me historitë e pëvojat e shumta, Shefiku më ngjante me një gladiator, që dhe pse merr shumë plagë, i suporton, nuk bie, por qëndron i paepur në përmbushje të misionit të tij.

Lidhjet me eksperimentimin dhe kërkimin shkencor, Shefik Fisniku i ka akoma më të hershme. Prej më se 12 vjetësh ai bashkpunon me Entin shtetror të farnave dhe fidaneve, duke qenë vërtet një model në punën e bërë dhe duke pasur vlerësimet e tyre maksimale. Gjatë gjithë kësaj kohe ai provon në tokën e tij kultivarët më cilësorë të vendit dhe të huaj për misrin, grurin dhe pataten. Për tu bindur akoma më shumë, zbritëm poshtë tek eksperimenti i patates. Vërtet nuk kishte koment për pamjen që na u shpalos para syve tanë. Nëntë eksperimente ishin ngritur, 40 metër katror secili, nga një për çdo kultivar patatje. E gjitha kjo funksiononte mbi bazën e kodeve, pa e bërë prezente emrin e llojit që përfaqësonte. Asnjë fije bari, asnjë bubrec, apo dëmtues tjetër nuk mund të gjendej aty. Kërcejtë e shumtë të patates ishin veshur e mbushur me dheun pjellor. Është pak të thuash që Shefiku vinte çdo ditë aty, kishte raste dhe dy tre herë. Në një libër të veçantë, ai mban të gjitha shënimet e duhura, të cilat i paraqet në fund tek eprorët. Kur ka qenë data e mbjelljes, fillimi dhe mbarimi i mbirjes, fillimi dhe mbarimi i lulëzimit, ngjyra e lules, gjatësia e kërcejve dhe numri i tyre? Në fund shënohet koha e pjekjes për secilin kultivar, numri i ditëve, sasia e prodhimit dhe cilësia e tij. Prodhimi ndahet në tre kategori, për konsum, për farë dhe më të voglat fare, për blektori. Rendimenti ka qenë shpesh mbi 60 kunjtalë për dynymë. Të gjithë kultivarët kanë qenë shumë të mirë, por Shefiku do të veçonte llojin "Fabula", "Konsull" dhe "Madalena".

Aty ngjitur me eksperimentin e patates dukej një pemë e madhe mollë, që fermeri na thotë se është mbi 200 vjeçare. Është kultivar autokton tipik " Trena", që mban dhe emrin e fshatitë. Falë cilësive organo leptike të mrekullueshme dhe rezistencës ndaj sëmundjeve, është bërë e mundur që ky lloj molle të kalojë në filtrin e shekujve dhe të mbijetojë.

Ora po i afrohet njëshit. Shefiku, agjërues i muajit të Ramazanit, merr abdes dhe thirr ezanin në xhaminë e fshatit, që ngrihet bukur mbi kodër. Zëri i tij që fton njerëzit në namaz, thyhet nëpër lugina e kodrinat e luginat e shumta. Sa më shumë që afrohet me Zotin e Gjithësisë, aq më shumë e ndjen veten të fortë e të freskët, për të kryer punët e shumta që ka çdo ditë.

**Katër vite më parë Shefiku vendosi të futet me kulturën e qershisë. Llogaritë duheshin bërë mirë, pasi bëhej fjalë për një sipërfaqe prej dhjetë dynymësh. Ishte vërtet një vend i mrekullueshëm, një kodrinë e bukur që ngrihet mbi fshat, përballë kodrës së vakufit, që mban antenën. Shefiku donte që ngjyrën në të kuqe të tokës ta mbulonte me gjelbërimin e pemëve të reja, donte që tokën e vdekur ta kthejë në një dyqan , që do ti sillte fitime të shumta...**



Visit Dibër

Rruga e Arbërit nr. 157

turizëm

**Nëse nuk e ke vizituar ende Dibrën, nuk e ke parë ende Shqipërinë!**

# Turi i Korabit, mali më i lartë në Shqipëri

***Nëse nuk e ke vizituar ende Dibrën, nuk e ke parë ende Shqipërinë!***

**PËRSHKRIMI I VARGMALIT TË KORABIT**

Shijo ngjitjen në malin më të lartë të Shqipërisë, Korabin. Një udhëtim që do ju magjepsë nga çatia e Shqipërisë, ku do të njiheni me bukuritë natyrore të parkut Korab-Koritnik, kushtet e jetesës baritore në stane, kulturën dhe traditën e pasur të Maqëllarës, fshatrave turistikë të Radomirës dhe Rabdishtit, si dhe mikpritjen e gatimet tradicionale të dibranëve në familjet e tyre. Udhëtimi zgjat 6 ditë. Guida duhet sigurojë që vizitorët të jenë me veshjet, pajisjet dhe sendet e duhura për ecje malore.

**SHIJO MALIN MË TË LARTË NË SHQIPËRI SOT DHE NESËR DO TË MAGJEPSENI DHE DO TË NA FALËNDERONI!**

| | |
|---|---|
| **KOHËZGJATJA:** | **6 DITORE (mund të jetë edhe 1 ditore)** |
| **GJATËSIA E SHTEGUT:** | **36 KM** |
| **VËSHTIRËSIA:** | **NIVELI MESATAR** |





Çdo rrugicë ka të bukurën e saj dhe vizitorët shikojnë dhe prekin me sytë dhe duart e tyre jetën tipike të fshatit.

## Dita 1

**8:30 Nisja nga Peshkopia.Shijo bukurinë e fshatrave të Maqellarës.**

Nisja nga fshati Popinarë. Gjatë rrugës mund të njiheni me Kalanë e Grezhdanit, kishat e Herbelit dhe Kërçishtit, xhamia e Allajbegisë dhe burimet natyrore si Guri i Kërçinit, ujëvarat e Pocestit, Karsta e Pocestit, Rrapi i Kërçinit, burimet e Kërçinit dhe shumë peizazhe të tjera natyrore. Udhëtimi për në Popinarë do të jetë me minibus.

**9:30 Ngjitja në bjeshkën e Pocestit**

Bjeshka e Pocestit të jep një adrenalinë të paparë, kur shikon luginën e Drinit të Zi. Ngjitja vjen natyrshëm përgjatë burimit të Kërçinit drejt bjeshkës me monumente të shumta të natyrës, florën dhe faunën e zonës. Frutat e pyllit dhe uji i ftohtë janë shoqëruesit më të mirë të drekës nga bjeshka e Pocestit.

**12:30 Dreka është e paketuar dhe marrë me vete.**

**13:30 Vrojtim nga Maja e Velivarit luginës dhe maleve të Dibrës.**

Ngjitja për në malin e Valivarit, i cili ka një reliev më të butë se malet e thepisura. Udhëtimi zgjat 2 orë. Ke mundësinë e vështrimit të të gjithë Luginës së Drinit të Zi dhe një pjese të Radikës.

Udha vazhdon përgjatë brezit të butë dhe zbret te Kulla e Turkut, ku bjeshka e Hinoskës duket si në pëllëmbë të dorës. Bjeshka, liqeni, stanet dhe fshatrat e Trepçës dhe Ilnicës janë destinacionet më të afërta. Zbritja deri te stanet e Hinoskës zgjat rreth 1 deri 1.5 orë.

**16:30 Akomodimi në stanet e Hinoskës, shtëpitë pritëse të Fidallarëve.**

**Rekomandohen për shtëpi pritëse dhe kamping:**

**HATEM FIDA** **0672087194**
**TUSH FIDA** **0684715843**

**19:00 Darka tradicionale familjare në shtëpinë pritëse.**

## Dita 2

**8:00 Mëngjesi i bollshëm me ushqime të vendit te shtëpia pritëse**

**9:00 Ecje dhe eksploro Bjeshkën e Hinoskës.**

Nisja për në bjeshkë. Ecje malore, e moderuar në këmbë dhe për çantat përdoren kuaj ose mushka. Peizazhi është shumë i bukur dhe panoramik. Gjatë rrugës mund të ndalesh në pika vrojtimi për soditjen e natyrës dhe për foto. Mbërritja në bjeshkë pas 1.5 orë ecje. Florë e pasur dhe bimësi e shumëllojshme. Karakteristike janë bimët mjekësore të rralla si gentiana lutea, lulja e salepit, boronica dhe çajra të ndryshme. Bjeshka të ofron shumë burime ujore. Në bjeshkën e Rabdishtit, rrëzë Gurit të Zi, shijon gjithë Luginën e Shërimit dhe Borovikun e Begjunecit, Mbas një ecje me vështirësi të lehtë, pas 4 orësh nga stanet e Hinoskës, arrin te Kroi i Gjyshes.

**13:00 Dreka të Kroi i Gjyshes është e paketuar dhe marrë me vete.**

**15:30 Shëtitje dhe ecje në bjeshkën e Rabdishtit**

Peizazhi është shumë i bukur dhe panoramik. Pylli i Ferës është shumë i bukur, me pisha dhe lloje të ndryshme drurësh pyjorë. Bjeshka ka një florë shumë të pasur me bimësi të shumëllojshme. Bjeshka të ofron shumë burime ujore. Mbërritja në fshat pas 2 orë ecje.

**16:00 Vizitë në fshatin e gurtë turistik të Rabdishtit**

Fshati është një nga 100 fshatrat turistikë në Shqipëri. Pozicioni është malor dhe stili i ndërtimit i gjithi me gurë.

## Dita 3

**NGJITJA DHE ECJE NË MALIN E SKËRTECIT**

**8:00 Mëngjesi i bollshëm me ushqime të vendit te shtëpia pritëse.**

**9:00 Ngjitje dhe ecje në malin e Skërtecit**

Nisja nga fshati Rabdisht për në bjeshkë është itinerari i parë. Ecje malore e moderuar. Mbërritja në bjeshkë pas 3.5 orë ecje. Bjeshka të ofron shumë burime ujore dhe kanione të ndryshme, që dhe në periudhën e verës mund të kenë borë ose masive akulli. Fauna është shumë e pasur dhe mund të shikosh kaproj, lepuj dhe shpendë të ndryshëm.

**12:30 Dreka është e paketuar dhe marrë me vete, shijohet buzë uji të ftohtë.**

**14:00 Ecje malore në leqet e Cerjanit**

Ecje malore, më shumë në pjesë shkëmbore përgjatë Malit të Skërtecit. Pamja është e bukur dhe mali është i thepisur. Ke ndjesinë e një aventure, por shkalla e vështirësisë është e moderuar dhe nën shoqërinë e guidës, rruga është e njohur dhe shumë e përdorur nga popullsia vendase dhe vizitorë të shumtë.

**16:00 Ngritja e kampingut në Gurin e Kuq**

Kampingu ngrihet me tenda, rrëzë Gurit të Kuq në fshatin Zimur. Ambienti është i përshtatshëm për kamping dhe pamja është shumë e bukur. Vizitorët mund të eksplorojnë florën dhe faunën e pasur dhe në shoqërinë e guidës mund të njihen me karakteristikat e zonës së mbrojtur Korab-Koritnik.

**16:30 Darka dhe mëngjesi është e paketuar dhe marrë me vete.**

**16:30 Akomodimi te shtëpitë pritëse. Rekomandohen për shtëpi pritëse**

**SABRI SHAHINI** **0695114003/0683240675**
guesthousesabriu@gmail.com
**FITIM GOLECI** **0696429888**
guesthousefitimgoleci@gmail.com

**Darka në shtëpinë pritëse, tradicionale familjare**

## Dita 4

**NGJITJA DHE ECJE NË BJESHKËN E GRAMËS**

**9:00 Nisja nga Guri i Kuq**

Ecje malore ne malin e Derzës. Fshati Zimur në lartësinë më të lartë në Shqipëri, njihet si çatia e qytetit të Peshkopisë. Udhëtimi vazhdon nëpër malin e Derzës ose në gjuhën vendase njihet si "Dera ose porta", kjo për shkak të pozicionit të saj gjeografik. Njihet vendi i erës ose dera e erës. Pas 4 orë udhëtimi arrin në Bjeshkën e Gramës. Vendi malor shumë i bukur, mbase më i bukuri në Shqipëri.

**12:30 Dreka është e përgatitur nga i zoti i stanit të Gramës.**

**14:30 Shëtitje në Bjeshkën e Gramës dhe Bjeshkën e Zonjave**

Peizazh i mrekullueshëm, mes një flore shumë të pasur dhe relievi mahnitës.Eksplorim në kanionin e Gramës, Pasqyrat apo Shllinasi i Vrenjtit, që janë monumente të rralla natyre. Peshkim në liqenin e Gramës. Shëtitje me kuaj nëpër fushat e Bjeshkës së Gramës dhe Bjeshkës së Zonjave.

**17:00 Akomodimi në kamping "Korabi" ose me tenda që ofrohen nga guida ose nga kampingu.** **0683322157**

**19:00 Darka është në kamping.**

## Dita 5

**VIZITË NË FSHATIN TURISTIK TË RADOMIRËS.**

**7:30 Nisja nga kampingu i Gramës.**

Mëngjesi me vete konsumohet pas 2 orë udhëtimi. Mund të konsumohet mëngjesi në stan dhe pastaj dita është vetëm për ecje. Eksploro bukuritë e Bjeshkës së Shehit. Nisja nga Grama kalon nëpër një itinerar i gjithi malor, me bjeshkë, pyje të larta, burime ujore, florë dhe faunë të pasur deri te Bjeshka e Shehit. Deri te burimet e Bjeshkës së Shehit arrihet për rreth 6 orë. Shkalla e vështirësisë është e lehtë dhe në disa vende mesatare.

**13:30 Dreka është e paketuar dhe marrë me vete.**

**17:00 Shijo pamjen e fshatit turistik Radomirë.**

Radomira është një nga 100 fshatrat turistike të Shqipërisë. Radomira ka burime të shumta që derdhen në lumin e Veleshicës. E përbërë nga 5 lagje, grupi qëndron në lagjen Tezë. Janë dy baxho që prodhojnë djathë, pasi zona e Radomirës shquhet për mbajtjen e deleve. Natyra është shumë e bukur dhe pyjet janë të mbrojtura, pasi ky fshat është i vetmi në Shqipëri që ka ligjet e veta dhe nuk lejojnë asnjë që të presë pyjet apo të bëjnë gjueti në territorin e tij.

**17:30 Akomodimi te shtëpitë pritëse**

**Rekomandohen për shtëpi pritëse:**

**SETKI AHMATA** **0692777129**
**HAXHI HIMA** **0692538172**

**19:00 Darka në shtëpinë pritëse, tradicionale familjare.**

## Dita 6

**NGJITJE NË MALIN E KORABIT**

**7:00 Mëngjesi i bollshëm me ushqime të vendit te shtëpia pritëse.**

**7:30 Nisja për malin e Korabit**

Ngjitje dhe ecje në Fushën e Korabit, destinacioni i parë atraktiv që arrihet pas 3 orë udhëtimi nga Radomira. Ngjitja është mesatare dhe pamja është e mrekullueshme, malore dhe baritore. Fusha e Korabit është një nga burimet natyrore dhe ka një larmi lulesh dhe bimësie. Ajo është shumë e njohur për popullsinë vendase dhe më gjerë, pasi janë kënduar edhe këngë.

**11:30 Dreka në Fushën e Korabit është e paketuar dhe marrë me vete.**

**14:00 Ngjitja në Fushën e Ponairit.**

Quhet Fusha ose Gropa e Ponairit, ose si fusha e panaireve, që përdorej nga popullsia vendase për të reklamuar delet, leshin apo gjëra të tjera. Mendohet sipas gojëdhënave se këtu bëhej edhe shkëmbimi i bagëtive dhe leshit. Edhe Fusha e Ponairit është monument natyre.

**15:30 Ngjitja në majën e Korabit**

Maja e Korabit është e një shkallë vështirësie mesatare dhe pamja është e mrekullueshme, të duket vetja sikur je në çatinë e Shqipërisë dhe të gjitha malet dhe lartësitë janë nën shikimin tënd. Ngjitja zgjat 1.5 orë. Guida duhet të ketë kujdes për grupin, pasi një pjesë janë të lodhur dhe duan pak motivim për t'u ngjitur.

**19:00 Kthimi në fshatin Radomirë**

Kthimi bëhet nga ana tjetër e malit të Korabit, nga pjesa e fshatit Ceren. Zbritja zgjat rreth 3 orë, por në varësi të grupit mund të shkojë edhe 3.5 orë, nëse është grupi i lodhur.

**19:00 Akomodimi dhe darka te shtëpitë pritëse.**

*Ky projet u mbështet nga D2T "Dibra: Turizëm dhe traditë"*

cyan magenta yelloë black

# FJALË E FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

**Marrë nga libri "Toponimia e Çidhnës" i autorëve Haki Përnezha dhe Rruzhdi Bitri, Botimet M&B, Tiranë, 2016.**




### FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA


- ***E ka kullot':*** *E ka kullotur. E ka bërë jetën e vet*. Përdoret dhe për të treguar dikënd që e ka shfrytëzuar mirë detyrën. *Kullote, kullote* thuhet për dikënd që shfrytëzon një detyrë që i është dhënë.
- ***I delë shqemash:*** Thuhet për dikë që nuk ruan asnjë normë, rrugaç.
- ***E brenëj:*** *E branoi / e brenoi*, i kaloi brenë / branë sipër. *I brenue* në muhabet quhet personi që humb në një dialog a replikë në dhomën e burrave. I brenue quhet ai person që është i detyruar dhe pranon kushtet e tjetrit.
- ***Ra squk:*** Kur dikush që tregohej i fortë dorëzohet. *Ra squç*, u dorëzua. *Squç* bien çerepi dhe saçi, kur u digjen drutë dhe buzët e tij zënë në tokë dhe fiket edhe zjarri.
- ***M'njën e vet'ton:*** *Mëgjon e veton, gjëmon e vetëtin*. *Mëgjon*, metatezë e *gjëmon*. Thuhet për dikënd që bërtet pa vend.
- ***Deth e desh:*** *Dathë e deshë*, zbathur e zhveshur: *I kam rrit fëmijët dath e desh*, me vuajtje të mëdha.
- ***Ataj o bir:*** *Aty o bir*. Përdoret në ligjërimin gojor kur duam të tregojmë lëvizjen nga një vend në një tjetër. *Pasi mora vesh, ia futa ataj o bir e në bjeshkë. Prej aty e ...*
- ***Sa k'tu e n':*** *Sa këtu e deri në ...* Përdoret për të treguar ndonjë largësi a gjatësi.
- ***Hap karrajk:*** *Kemi mbetur keq*, as këndej as andej. *Hap karrajk*, kur puna në avlëmend ngec.
- ***Eh, krahanjëmi i shok'e:*** *Eh, karahnjomi i shokëve*. I thuhet dikujt që njihet si njeri i gatshëm për të ndihmuar të tjerët. E kundërta e *krahëthatë*, që përdoret për dikënd që nuk i vlen puna. Një gjinore shumë interesante, njësoj si i emrave të fiseve: *i shoke* në vend të *shokëve*.
- ***Tek a tek:*** *Një për një*.
- ***Tiç e përtim:*** *Tërhiq e përtërhiq*. Një zënkë e gjatë. *Nuk rrihet ma tiç e përtiç*.
- ***Ven e le:*** *Vendos dhe lër*. Përdoret kur duam të tregojmë se dikush i ngjan dikujt tjetër. *Ai ishte, ven e le , si i ati. Del dhe në* formën: *marrsh e vufsh*.

### FJALË TË RRALLA

- ***c'nok:*** Prek pakëz dikë, diçka. *Makina nuk* është dëmtuar, vetëm është *cnok pak*. Çabej jep dy forma për kuptimin *prek lehtë*[241]: *cok* dhe *cek*. Këtu me siguri nga *cok - cnok*.
- ***cokat:*** Përdoret për të shenjuar veprimin që bëhet në rastet kur ngordhin qingjat ose kecat: para se ti hidhen, i *cokatim pak në fyt*. Fjala *cokat* lidhet me formën *cok* (si më lart). *Kingjin e cokata dhe e hodha*.
- ***cikth:*** *Maja e mullarthit*, tek pjesët e mullirit, pjesë prej hekuri me formë konike. *Mulliri nuk punon pasi është prishë cikthi*. Fjala *cikth* shërben për të emërtuar edhe *shpirtërat e të vdekurve*, që *vijnë në mbrëmje përqark shtëpive duke cicëruar*. I një burimi dhe kuptimi me *cifun*, pjesa që mbledh ujin për ta dërguar me forcë në fletët e mullirit.
- ***cakërr:*** Ka kuptimin *ngreftë, krekosun*. Me fjalën *cakërr* janë formuar edhe fjalët *cakrroj, cakrruar*. *Bimët janë cakrrue* (janë ngjallë, forcuar); *Hajde, cakrroma gotën* (pop.).
- ***car:*** Përveç kuptimeve tek Çabej, kjo fjalë shërben ka dhe kuptimin *u thamë, mërdhihëm*: *u carâmë nga të ftohti*, por edhe u *carâjtëm*.
- ***celinë:*** Një llojë toke argjilore joprodhuese. *Tokë celinë*. Jo si tek Çabej për fjalën *calinë - celinë*.
- ***cupajt:*** Ka kuptimin vë në shenjë: *Mori pushkën dhe iu cupajt dhelprës*.
- ***cigon*** / ʦ***igɔn*** / ***cígon-i:*** Fëmijë i lëvizshëm.

# TREGIM ALEGORIK

## Takimi me belanë




*Populli, kur do ta nëmi dikë, i thotë: "Të daltë mendja mbi kësulë", domethënë, "T'u rrittë mendja!". Një burri i ishte rritur mendja aq shumë, sa e mbante veten më trimin e më të mençurin e krahinës. Dilte rrugëve të katundit dhe thërriste: "Oj bela, ku je?!" Kur nuk e gjeti në katundin e vet, doli me e thirrë nëpër vende të tjera. Takoi në rrugë një burrë, i cili u habit kur dëgjoi që thërriste ashtu.*

*Ky ishte Hizri mrekullibërës. E shndërroi burrin në gomar. I hipi dhe ra një teposhteje. Hasi në do punëtorë që ndërtonin një urë. Ata ia kërkuan gomarin me qira për një muaj, por ai ua la pa asnjë lekë.*

*Punëtorët nuk e lanë një minutë të pushonte: i vunë arkat dhe e çuan për rërë. Pjesën tjetër të ditës mbajti gurë. Kështu, çdo ditë: rërë - gurë, gurë - rërë, pa pushuar. Nuk donin ta mundonin, por ashtu ishte puna. Edhe vetë punonin shumë. Gomari u tret dhe u dobësua aq shumë, sa të vinte keq kur e shikoje.*

*Ditën që mbaroi ura, i zoti i gomarit, sikur ta kishin lajmëruar, erdhi te punëtorët. Nuk priti as ta falënderonin, por i hipi gomarit dhe u nis për udhë. Nata e zuri tamam në katundin prej të cilit ishte gomari. Shkoi pikërisht te shtëpia e tij. Kafsha, sa hyri në oborr, lëshoi një pallmë të fuqishme. Doli gruaja për të mësuar ç'ishte ajo pallmë në oborrin e saj. Gomari bëri hov t`i hidhej në qafë. I zoti e largoi nga dera me zor dhe i tha gruas:*

*Mos ke vend, moj zonjë, për këtë gomar ta lë sonte këtu. Do shkoj deri në qytet dhe vij e marr nesër.*

*Vend kam sa të duash, - i tha gruaja. - Më fal, jam grua pa burrë se do të të ftoja në shtëpi...*

*Do të shkoj në qytet, të thashë. Ti vetëm më rregullo gomarin.*

*Gruaja e tërhoqi për litari gomarin ta fuste në ahur të bagëtive, por ai nguli këmbët në tokë nuk lëvizte, edhe pse ishte kockë dhe lëkurë. Bënte hov nga dera e shtëpisë dhe donte të hynte brenda.*

*Jo këtu, jo këtu, - i thoshte gruaja dhe e tërhiqte nga ahuri.*

*Kur ai, me gjithë tërheqjen nuk luajti nga vendi, ajo kapi një thupër thane dhe ia zhamreti aq fort, sa i mbetën vijat e thuprës në shpinë e në vithe.*

*Në mëngjes erdhi i zoti dhe bashkë me gruan hynë në ahur me marrë gomarin. Kafsha kishte kundërshtuar për të hyrë në ahur, por, për të dalë, e kishte ndarë mendjen të dilte vetëm i ngordhur. Gomar për gomar, deshi t'i shërbente shtëpisë së vet. I zoti e kapi për litari dhe e tërhoqi sa mundi, kurse gruaja e shtyri për nga dera. Po luante ai! Kockë e lëkurë, por këmbët i kishte të forta.*

*- Kap drurin, kap drurin, se nuk merr vesh me të mirë ky.*

*Gruaja, se ku gjeti një thupër thane të trashë dhe bjer e bjer aq sa gomari, me gjithë qëndresën heroike, doli në oborr. I zoti i hipi dhe e çoi pikërisht tek ai vendi ku ai pat kërkuar belanë dhe e gjeti. Hizri bëri një dua dhe gomari u shndërrua prapë në njeri, siç kishte qenë.*

*- Hë, si t`u duk belaja? - e pyeti Hizri.*

*Tashmë nuk ishte ai xhagadurri e kapadaiu që nuk bëhej fjale me të, por një njeri i telendisur, që mezi rrinte në këmbë. Tha:*

*Nuk tregohet ç`kam hequr! Mbase një ditë do t`i harroj të gjitha vuajtjet, veç dajakun që më ka dhënë gruaja, nuk kam për ta harruar kurrë...*

*(Marrë nga libri "Tregime alegorike" i Xhafer Martinit, Botimet M&B, Tiranë, 2019)*

*Librin mund ta gjeni duke kontaktuar pranë librarisë së botimeve M&B, rrjetit të librarive Adrion ose libraria Art's te stacioni i trenit në Tiranë.*

Rruga e Arbërit nr. 157

**Profesor Murati shpesh është vënë në mbrojtje të interesave krahinore e dibrane për probleme të ndryshme, siç kishin bërë paraardhësit e tij, në epoka pushtimesh të huaja.**

portret

# **Murat Koltraka**, *stërnipi i Kastriotëve...*

*Nga* **OSMAN XHILI**

Murat Koltraka ka lindur në Kukaj të Çidhnës, në fshatin e mbushur me histori trimërie e burrash të lavdishëm. Sikur të mos kishte asgjë tjetër, do të kishte mjaftuar Pal Kukaj, dora e djathtë e Skënderbeut, për ti dhënë nder e lavdi këtij fshati, që më pas mori emrin e këtij heroi legjendar. Ngjitur me këtë vendbanim është dhe Kastrioti. Historianët na japin detaje se Kastriotët dhe Kukaj janë dy fise ngjitur, që luftuan bashkë kundër turqve në beteja të pashembullta. Deri vonë varrezat e këtyre dy fshatrave kanë qenë të përbashkëta, xhamia është e njejtë, kurse banorët thirren për mirë e për keq, si një fis i vetëm.

Kur isha në klasë të pestë, tregon Murati, kishim një mësues, Petraq Pepa, me njohuri të thella shkencore dhe një ditë na bëri një bisedë tek Kodra e Gështenjasit. Me kuriozitetin e fëmijës e pyeta sa ishte ushtria e Skënderbeut dhe sa prej tyre ishin dibranë. Mësues Petraqi e sheh djalin, pak i habitur nga pyetja që i bëri. Ai i shpjegon se ushtria e kryetrimit nuk ka qenë gjithnjë e njëjtë në numër, por gjithsesi, të paktën gjysma e tyre kanë qenë dibranë.

Më të moshuarit na tregonin emra toponimesh, si Pusi i Gjonit, Ogradja e Gjonit, Kalaja e Gjonit, Mulliri, po me të njejtin emër, Kodra e Pareve, Varret e dragonjve, e plot të tjera si këto. Në mendjen tonë ngjiteshin e ngjizeshin emrat e tyre, bashkë me historitë që i shoqëronin ato. Që atëherë, kur lexonim historitë për Skënderbeun, na dukej se ai na përkiste të gjithë shqiptarëve, por ne që ishim aty, ca më tepër.

### SHKOLLA E MESME

Murati, djali i dikurshëm filloi shkollën e mesme pedagogjike në Peshkopi. Kishte hedhur goxha shtat e qe burrëruar. Ishte stërvitur mjaftueshëm në lojrat e shumta fëminore, në përpjekje për të imituar Skënderbeun dhe trimat e tij. Shpejt u ingranua në ekipet e shkollës, sidomos volejbollin e kishte më për zemër. Mësuesi i edukimit fizik, Dan Doçi nga Tropoja, kishte mbaruar në Çeki dhe kishte njohuri shumë të mira në këtë drejtim, por dhe dëshirë për të punuar. Çdo vit bëhej spartakiada kombëtare e shkollave të mesme dhe Murati ishte gjithnjë pjesëmarrës në to. Përveç përgatitjeve gjatë periudhës së shkollës, bënin dhe një muaj stërvitje plotësuese në pushimet verore. Djali kishte dhe një pasion tjetër, hedhjen e gjyles. Dy herë zuri vendin e tretë në renditjen kombëtare, për nxënësit e shkollave të mesme, duke i shtuar mjaft pikë ekipit të tij në renditje.

Vitin e fundit të shkollës, garat zhvilloheshin në Vlorë. Murati ka një kujtim të bukur dhe na e tregon: "Një nga garat e shumta që zhvilloheshin, ishte dhe hedhja e shtizës. Ne, si ekip nuk kishim njeri të përgatitur për këtë lloj gare dhe vendosën që ti përfaqsoja unë. Në fakt, merrja pjesë dhe në dy gara të tjera, kështu që e treta nuk lejohej. U regjistrova me një emër tjetër dhe të nesërmen do të konkuroja. Në mëngjes, pashë një sportist bregut të detit, që bënte stërvitje për hedhje shtize. Nga mënyra si e kapte shtizën, si e rrotullonte, si e vërtiste, dukej që kishte kohë që merrej me të. U afrova si me droje në fillim. Ai më përshëndeti dhe më pranoi në shoqërinë e tij, pasi ja sillja shtizën sërish, kur ai e hidhte. Më tregoi se ishte kampion me të rinjtë e Dinamos. Në një moment më tha ta provoja dhe unë, sa mund ta hidhja. E bëra një provë, porse shtiza nuk shkonte drejt, sikur e hidhte ai, por në një pozicion tjetër, për së gjëri. Eja këtu, më thirri, e më tregoi sekretin. Me njërin gisht, duhet ta rrotullosh e shtiza duhet të shkojë përpara, sikur ecën plumbi. Veprova ashtu siç më thanë dhe rezultati ishte vërtet tejet parashikimit. Nuk di pse u tregua aq



i sinqertë, kur pasdite do të më kishte rival në garë. Në fakt, ashtu ndodhi. Në garën e pestë unë e kisha fluturuar shtizën më shumë se ai, por gjyqtarët vërejtën një prekje të vizës prej një centimetri. Të paktën, kështu vendosën ata dhe unë duhej të kënaqesha me vendin e dytë në kampionatin që po zhvillohej".

Profesori, - siç i thërrasin të gjithë në Dibër, - ka dhe një dashuri të rinisë së tij dhe kjo ishte violina. Në vitin e dytë të shkollës, ai u



lidh shumë me këtë vegël muzikore. Për pesë gjashtë muaj ai fillon të punojë si i pavarur me tekste të ndryshme. E tërhiqte kryesisht muzika e Paganinit. Punon deri në orët e vona të natës dhe aftësohet për të zbërthyer çdo pentagram. Mësuesi i talentuar i muzikës, Munir Shehu, i propozoi të hyjë me orkestrën e shtëpisë së kulturës të Peshkopisë dhe vitin tjetër të vazhdonte shkollën e muzikës. Murati i ri nuk e pranon këtë ide. Le të ishte muzika vetëm një shok, që do ta shoqëronte gjatë jetës dhe jo profesion i tij.

Një ditë, mësuesi i matematikës, Ismail Erebara, e gjen të papërgatitur në lëndën e gjeometrisë. Orët e vona me violinën e kishin bërë të vetën. Profesori nuk i jep mundësi të dytë dhe i vendos një dysh në regjistër. Nuk mund të mbaheshin dy kunguj nën sqetull dhe me shumë dhimbje djaloshi e braktisi violinën e dashur.

Një ditë të vitit të largët 1961, instruktori i komitetit të rinisë të asaj kohe, i thotë se duhej të bënte një foto të formatit të madh dhe ajo do të vihej tek tabela e heronjve dhe personaliteteve të kohës. Më pas i thotë se ka dhe një sihariq për të. E thirri lart te zyra e tij, u kërkoi

**Profesor Murati ka rreth 20 vjet që ka dalë në pension dhe tani po drejtohet tek të tetëdhjetat. Ai është kujdesur që ta ruaj veten nga mosha, duke mos hequr dorë nga dy aleatë të fuqishëm, aktiviteti mendor dhe fizik. Nëse sot i thua se duhet të ngjitet në këmbë në Lurë, ai është gati, tamam me profilin e sportistit, që ka pasur gjithë jetën.**
**Gjatë gjithë kësaj kohe ai ka botuar dhjetra artikuj në organe të ndryshme të shtypit për origjinën dibrane të Skënderbeut, duke mbledhur dëshmi e fakte të shumta në favor të kësaj ideje.**

ndjesë dy punonjëseve, që ti linin vetëm dhe atëherë i jep lajmin e bukur, se do të shkonte në Kinë për të vazhduar studimet e larta. – Dokumentat janë nisur dhe gjenden në ministri të arsimit, shtoi më pas, si për të garantuar se lajmi nuk ishte llaf kafenesh.

E kush nuk do të kënaqej po të ishte në vendin e tij, Kina ishte një ëndërr e madhe dhe e largët, por ja që fati po ja sillte në derë dhe ishte gati ta prekte. Kaluan javë. Murati u dha kafe shokëve të ngushtë për rastin në fjalë. Por tamam kur pritej përgjigja përfundimtare, fytyrën e tij e kaploi trishtimi. Ndjeu ti troshitej gjithë ajo kala që kishte thurrur në mendje. Në vend të studimeve në Kinë, i thanë se e kishin caktuar si mësues në shkollën e Shumbatit. Njerëz të ulët, pa shpirt e pa nivel kishin gërmuar si minj gjirizesh në biografinë e tij dhe kishin gjetur aty nja tre kushërinj që ishin arratisur herët për në Amerikë. Kaq kishte mjaftuar për ta përmbysur situatën në sensin negativ

### DYZET VJET NË ARSIM

Profesor Murati tregon për mëdyshjet e asaj kohe, të shkonte apo jo, atje ku e kishin caktuar. Ditën e parë do ta shihte situatën nga afër. Dy kolegët e tjerë, nëse do të vazhdonte, ishin Ahmet Çaushi dhe Naim Plaku. Kur kaluan pak orë dhe zhvilluan një ndeshje futbolli, nuk kishte më vend për diskutim. Që tani e për dyzetë vjet me rradhë, Murat Koltraka do të ishte pjesë e armatës së madhe të arsimtarëve shqiptarë.

Shumbatit i dhamë nga forca dhe shpirti rinor, por dhe morëm shumë në këmbim, kujton profesor Murati. Që në atë kohë kishim laborator fizike të ardhur nga Gjermania lindore, por dhe ne bënim përpjekje maksimale në mësimdhënje. Ora e mësimit ishte e shenjtë. Kishin kaluar vetëm shtatë muaj në punën e re, kur vjen një ekip kontrolli nga rrethi, që kryesohej nga vetë shefi, Selim Alliu, njeriu që përmendet me admirim dhe sot e kësaj dite. Puna jonë kishte lënë gjurmë dhe nuk u muar asnjë notë negative. Në përfundim shef Selimi i thotë se duhej të referonte në sesionin shkencor të rrethit, temën: "Lidhja e teorisë me praktikën në matematikë". Veç kësaj e shpërblen me fletë nderi dhe një pagë mujore.

Më pas transferohet në Fushë Alie, ku i ngarkojnë detyrën e drejtorit të shkollës, kur kishte mbushur vetëm 22 vjeç. Për gati 20 vjet do ta bënte këtë detyrë, duke drejtuar me kompetencë dhe duke arritur rezultate të shkëlqyera. Gjatë kësaj kohe e më tej, ai ka marrë pjesë aktive me referime të dobishme për kolegët, si në aktivitetet e rrethit, por dhe në veprimtari që janë zhvilluar në Tiranë. Ka botuar artikuj me vlerë tek revista pedagogjike e kohës.

### PENSIONI

Profesor Murati ka rreth 20 vjet që ka dalë në pension dhe tani po drejtohet tek të tetëdhjetat. Ai është kujdesur që ta ruaj veten nga mosha, duke mos hequr dorë nga dy aleatë të fuqishëm, aktiviteti mendor dhe fizik. Nëse sot i thua se duhet të ngjitet në këmbë në Lurë, ai është gati, tamam me profilin e sportistit, që ka pasur gjithë jetën.

Gjatë gjithë kësaj kohe ai ka botuar dhjetra artikuj në organe të ndryshme të shtypit për origjinën dibrane të Skënderbeut, duke mbledhur dëshmi e fakte të shumta në favor të kësaj ideje. Ato janë vetëm maja e ajsbergut, pasi materiali i shkruar prej tij kap shifrën e gati dymijë faqeve, që mund të zerë hapësirën e dy librave.

Vitin e kaluar botoi shkrimin: "Kur do të vijnë arkeologët, të studjojnë për vete, e tu shpjegojnë të tjerëve historinë e Çidhnës?" Nuk vonoi shumë kohë pas kësaj. Marin Mema, historiani Pëllumb Xhufi, arkeologu Skënder Muça e tre të tjerë më të rinj, erdhën për të studjuar krahinën. Profesor Murati i shoqëroi në çdo hap, duke u dhënë detaje e histori, pa të cilat do ta kishin pasur shumë të vështirë misionin. Grupi u ngjit deri te kalaja e Skënderbeut, kaloi në Trojas, përshkoi luginën e Setës dhe vazhdoi tek Kodra e Gështenjasit, duke nxjerrë në dritë materiale me vlera të padiskutueshme.

Profesor Murati shpesh është vënë në mbrojtje të interesave krahinore e dibrane për probleme të ndryshme, siç kishin bërë paraardhësit e tij, në epoka pushtimesh të huaja.

Diku nga viti 2000 vjen në Dibër ish kryeministri Fatos Nano, me një grup pune për ndërtimin e hidroçentralit të Skavicës. Profesor sheh të dhënat që kishin me vete grupi i punës, ku binte në sy shuma totale e shpronësimit të banorëve prej 44 miljon eurosh. U thotë atyre se kontrata e Ronaldos kishte qenë 160 miljon euro, pra katër herë më e madhe se shuma në fjalë. Ju o njerëz, u drejtohet atyre, doni që me një grusht para të fshini pronat e njerëzve, historinë e tyre mijravjeçare, pra vetë identintetin e tyre. Jo, ky është krim dhe ju nuk duhet ta bëni! Ne nuk do t'ju lejojmë!

Profesor Murati ka një familje të shkëlqyer, tre vajza dhe një djalë, të gjithë me arsim të lartë. Ai banon në qytet, por verës, gati për çdo ditë e viziton banesën e tij në fshatin Kukaj. Punon nga pak në kopështin dhe në bahçen e tij. Pemëve të shumta që ka mbjellur aty, vitin e kaluar u shtoi dhe tre dynymë arra, të cilat kanë shpërthyer në gjelbërim. Shpresojmë dhe urojmë që profesor Murati të ketë jetë të gjatë, të shkruaj sa më shumë dhe të mbledhë prodhimin e arrave që ka mbjellur me dorën e tij.

përshtypje



# Maqellara
## vendi i njerëzve pozitivë

*Nga* DIONIS XHAFA

Sot shtati më është rritur dhe si gjithëseci-li në këtë jetë duhet t'ia dalë vetë ne sfidat që ofron ajo dhe janë të shumta. Secili nga ne mbron vendlindjen a vendin nga vjen a është rritur dhe kjo është normale. Aromë e vendlindjes nuk bën dhe nuk ka sesi të krahasohet me asnjë tjetër. Për fat të mirë, ajo na sjell erën nga vijmë, startin tonë, fillimin. Ndërsa, sot në këto rreshta do të shkruaj në fakt për një zonë ku jam rritur dhe që është një ndër ata vende ku vërtetë ka njerëz punëtorë e pozitivë.

Maqellara është një ndër zonat ku ofro-het afria, freskia, mrekullia dhe bashkë me natyrën e bukur, bëhet njësh edhe njerëzia punëtore. Njerëzit e këtyre anëve, në tërësinë e vet kanë me vete pozitiven, të mirën, familjen. Dhe familjen këta njerëz janë të gatshëm ta ruajnë me nder e gjak edhe në sfidat më të errëta, edhe ndër fushatat më të egra, edhe në sfidat më të rënda. Një trevë që të do nëse je njeri, nëse dashuron lirinë dhe ke principe të sakta të jetës, në udhën e mundimshme, që të mund ta zgjidhësh atë sa më mirë e bukur.

Kjo trevë e ka të veten edhe historinë, edhe të renë, edhe modernen, të shkrira bukurisht në një, në një sfond të mrekullueshëm, si një festival lulesh. Maqellara ka qenë sidomos një qendër e rëndësishme historike e politike, si dhe mbetet edhe e tillë. Kjo për shkak të pozicionit të saj gjeografik të favorshëm. Ndodhur mes dy qendrave më të rëndësishme të Dibrës, Dibrës së Madhe dhe Peshkopisë, ose ta thuash mes Dibrës së Madhe dhe asaj të Vogël, ka luajtur një rol me rëndësi në përbashkimin e vlerave dibrane, andej dhe këtej kufirit. Përpos his-torisë, Maqellara ruan vlera e tradita, shkrirë me modernitetin. Zona ka biznesmenë, njerëz që pasurinë e kanë arritur me punë dhe vlera, me kazmë e lopatë dhe disa të tjerë duke u çuar që në mëngjes e duke ikur në shtëpi në darkë. Një zonë e pasur me fusha dhe me vargmale në krye të saj, me Drinin tëposhtë, me udhë të shtruara, që e bëjnë të mrekullueshme.

**Kjo trevë e ka të veten edhe historinë, edhe të renë, edhe modernen, të shkrira bukurisht në një, në një sfond të mrekullueshëm, si një festival lulesh. Maqellara ka qenë sidomos një qendër e rëndësishme historike e politike...**

### NJERËZIT POZITIVË, VLERA E JASHTËZAKONSHME

Jam rritur për 15 vite në këtë zonë dhe ajo që kam marrë ka qenë një pozitivitet nga njerëzit. Ata dinë të respektojnë të zo-tin, kushdo qoftë ai, atë që ka vlera dhe të përçmojnë të keqen.

Të freskuar në mendje nga valët e Drinit, të mrekulluar nga dëshira dhe të pajisur me vlera punëtorie me famë në emigrim, ata janë qeniet njerëzore që ia dinë vlerën punës, djersës, lodhjes dhe nga ana tjetër lir-isë, mendimit ndryshe, duke qenë se është treva që ndër të parat e ka "shpërthyer" re-voltën ndaj komunizmit demonian të vendit tonë dhe ardhjes së lules së demokracisë.

Dhe kështu, Maqellara vjen e bukur si rreze dielli bashkë me demokracinë. Vlerat dhe dëshirat janë ende prezente në këtë zonë. Kjo sepse kjo zonë ka shpirtin e madh, ka banorët me zemër të madhe, ka dëshirën për liri të gjerë, ka punëtorinë sa një vargmal Korabi.

### FSHATRAT, NJË MREKULLI PIKTORESKE

Në mes të Maqellarës dikur kalonte rru-ga nacionale, ndërsa tashmë që janë bërë ndryshime (që e vërejta edhe në udhëtimin e fundit që kam pasur), kalohet në Peshkopi dhe në Dibër të Madhe vetëm nga rreth-rrot-ullimi. Maqellara vetë ka njohur një zhvillim tepër të madh dhe në vizitën që pata, ndjesitë që mora janë mall dhe sigurisht edhe pozi-tivitet. Me vende ku mund të hash e pish lirisht, me vende ku mund të luash çfarë do lloj loje, Maqellara ngjante si vend mrekullie.

Ndërsa edhe fshatrat e saj janë fantastikë. Ata dominohen prej një strukture normale si të gjithë fshatrat e Shqipërisë, me çezmat në qendrat e tyre dhe pastaj me shtëpi diku si vila dhe diku të vjetra si dikur. E reja dhe e vjetra bashkohen, jeta ecën, dëshira për më mirë është e madhe dhe kjo duket në atë se emigrimi është sektori ku mbahet më së shumti popullata. Fshatrat kanë tradita, kanë zakone të vjetra. Ndërsa në emigrim, bashkë me ruajtjen e vlerave atje dibrane, sillet edhe

**Kudo të shkosh dhe të pyesësh për këtë zonë, gjëja e parë që përmendet është punëtoria. Dhe punëtorinë këta njerëz nuk e kanë as të cunguar, as me cene, por të plotë dhe e shohin si rreze dielli për zhvillim ...**

e reja e Italisë, Greqisë, shteteve të huaja, ku sigurisht për të renë është derdhur edhe djersa e njerëzve shumë punëtorë të këtyre anëve, që në udhën e jetës njohin thuajse pafundësisht përulësinë.

### PUNËTORË SI NJERËZIT E KËSAJ ANE

Kudo të shkosh dhe të pyesësh për këtë zonë, gjëja e parë që përmendet është punëtoria. Dhe punëtorinë këta njerëz nuk e kanë as të cunguar, as me cene, por të plotë dhe e shohin si rreze dielli për zhvillim e për presporitet. Njerëzit e kësaj ane zgjedhin të vuajnë, të përjetojnë mall e largim prej vendit, vetëm që një ditë të shijojnë djersën që kanë derdhur jashtë vendit.

Punëtoria e tyre përzier me krenarinë, mospëruljen ndaj së keqes, mrekullinë njerëzore mbi të gjitha, e bëjnë Maqellarën një zonë të jashtëzakonshme. Një trevë si Maqellara ndoshta nuk ka nevojë për shumë reklamë, sepse bardhësia dhe yjet e bukurisë së saj duken që larg. Maqellara di të shkëlqejë si një yll blu në qiellin e pamatë dibran e shqiptar. Këta njerëz në tërësi e kanë besën, dinë të ruajnë respektin, dinë të respektojnë mikun, të zhvillojnë biseda, të përgjigjen për pengesat dhe sfidat e shumta të jetës, duke punuar pa fund për një të ardhme më të mirë.

E gjithë kjo punë ka bërë që sot Maqel-lara të marrë zhvillim. Punëtoria e ngre atë në pietestal të lartë, e bën krenarë si bijë e Dibrës, si zonë që shtrihet gjeografikisht mes dy Dibrave, që rrezaton dashuri e mrekulli, mahnitje e zbavitje pozitive. Lumturia dhe gazi janë kryefjala e Maqellarës, një zonë që ka diellin mbi qiell dhe diellin në njerëz, të cilët dinë të bëjnë krenarë zonën, Dibrën dhe Shqipërinë.




*Foto © fb Maqellara - vendi im*



**Njeriu që fali dekadat e moshës
në veprat e dritës**

# **Shaban Bitri,** *njeriu i urave dhe digave të mëdha*

*Nga* **SHAQIR SKARRA**

Atë mëngjes gushti të vitit 1974, në autobusin e linjës Peshkopi -Fierzë që kalonte mes përmes Rrugës së Rinisë, rrugë e cila ishte hapur që në vitin 1946, mes shumë punëtorëve që shkonin në kantierin më të madh hidroenergjetik në vend, siç ishte Fierza, udhëtonte edhe një djalë i ri nga Blliçja, Shaban Bitri, i cili sapo kishte mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit. Udhëtarët e shumtë në autobus nuk interesoheshin fare për të riun që po udhëtonte për herë të parë në këtë linjë. Nuk u bënte përshtypja as veshja e tij ndryshe, as heshtja e tij e madhe. E mendonin si ndonjë punëtor të ri që po vinte të bashkohej në atë kantier të madh ndërtimi. Bisedonin me njëri-tjetrin, qeshnin e bënin humor dhe kur autobusi po kalonte ngushticën e Skavicës, të gjithë e lanë humorin dhe filluan diskutimin rreth digës së re e të madhe që pritej të vendosej këtu, në këtë ngushticë. Shabani vështronte gjithë kureshtje atë ngushticë vërtet të bukur, e cila do të ishte dhe diga e fundit që do të hidhej mbi lumin Drin.

Ishte futur në pranverën e njëzet e pestë, djalë i ri, sapo kishte dalë nga auditoret e fakultetit e nuk përzihej fare në bisedat dhe shakatë e shumta që bënin pasagjerët në autobus, por lugina e bukur e Drinit e rrëmbeu dhe kjo panoramë që i shfaqej përpara syve në Skavicë vërtet ishte një mrekulli. Valixhen e vjetër prej dërrase e kishte vendosur tek këmbët, e cila e bezdiste sa herë që autobusi do të merrte kthesat e shumta e të vështira luginës së Drinit. Në valixhe kishte futur vetëm pak rroba, se më shumë e kishte mbushur me libra, libra që do t'i duheshin në kantierin e madh energjetik. Shabani ishte specializuar për inxhinier ndërtimi dhe jo hidroteknik, por ja që i takoi të punonte gjatë në vepra hidroteknike, në veprat e dritës, të cilat në ato vite radhiteshin si vepra të rëndësisë së veçantë.

Pas një rruge të gjatë e tepër të lodhshme, pasdite vonë më së fundi autobusi arriti në Fierzë. Dritat e qytetit të bukur e të vogël ishin ndezur dhe në fakt në sajë të dritave e gjallërisë që kishte në çdo orë të ditës dhe natës, Fierza dukej një qytet i madh. Shabani kurrë më parë nuk e kishte menduar se Fierza mund të ishte një qytet vërtet kaq i bukur dhe i madh.

Dibranët e shumtë që punonin në Fierzë nuk e lanë inxhinierin e ri të sorollatej gjatë



nëpër udhët e qytetit, por e strehuan në një nga bujtinat e tyre.

Dhe unë tek po rropatem sot të hedh këto pak fjalë e të bëj portretin e inxhinier Shaban Bitrit nuk e kam aspak të lehtë.

Shabanin e kam njohur tepër vonë. Ishte fillimi i vitit 2006 e po përgatitej dalja e numrit të parë të gazetës "Rruga e Arbërit". Bashkë me të do të promovohej edhe shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Shabanin e kisha parë në këto mbledhje të vogla që bënim ne një grup i vogël nismëtarësh. Kisha dëgjuar të flitej për të dhe vetëm kaq. Shpeshherë, kur do të mblidheshim, njerëzit e pranishëm do të shpreheshin: "Erdhi inxhinieri? Po vjen inxhinieri? Akoma nuk paska ardhur inxhinieri?" Takimi im i parë ishte kur u takuam në atë zyrën e vogël në marketin e Musait. Ishte i heshtur, por shumë serioz kur fliste. Dalëngadalë fillova të njoh një Shaban njerëzor, të komunikueshëm, human, të sinqertë.

Të shkruash për inxhinier Shabanin është sa e lehtë, aq edhe e vështirë. Është e lehtë, sepse vlerat, veprimtaria e kontributi i tij në vepra të rëndësishme të vendit tonë është i madh. Pikërisht këtu qëndron edhe vështirësia, sepse nga ato vepra ai mori shumë vlera të larta cilësore dhe është vështirë të përzgjedhësh më të mirën, për t'i renditur brenda këtij portreti. Figurën e tij në radhë të parë e karakterizon dashamirësia dhe respekti për njerëzit dhe shoqërinë. Ulesh me të në tavolinë dhe përmes bisedave të ngrohta e me kulturë, sinqeritet e pak humor, mes avujve të këndshëm të kafesë së mëngjesit, të krijohet ndjesia sikur rrethohesh nga një botë pa halle dhe shumë probleme.

**Të shkruash për inxhinier Shabanin është sa e lehtë, aq edhe e vështirë. Është e lehtë, sepse vlerat, veprimtaria e kontributi i tij në vepra të rëndësishme të vendit tonë është i madh. Pikërisht këtu qëndron edhe vështirësia, sepse nga ato vepra ai mori shumë vlera të larta cilësore dhe është vështirë të përzgjedhësh më të mirën, për t'i renditur brenda këtij portreti. Figurën e tij në radhë të parë e karakterizon dashamirësia dhe respekti për njerëzit dhe shoqërinë.**

Shabani ka lindur më 20 janar të vitit 1949 në fshatin Blliçe, në një familje me tradita të mëdha atdhetare, ku sivjet larg zhurmës e bujës së madhe, në një rreth tepër të ngushtë familjar festoi 70 vjetorin e lindjes, pasi thjeshtësia, çiltërsia e modestia e kahershme ende kanë lënë gjurmë si virtyte që nuk shlyhen lehtë.

Babai i tij Qazimi e donte arsimin dhe kishte dëshirë që fëmijët e tij t'i arsimonte të gjithë, me gjithë kushtet e vështira në ato vite që po kalonte i gjithë vendi ynë.

Shabani vazhdoi shkollën fillore në vendlindje, të cilën e mbaron me nota të mira. Dëshira për të mësuar ishte e madhe e ndaj Shabani vazhdon shkollën shtatëvjeçare në Fushë-Alie, pasi në Blliçe ende nuk ishte hapur.

Nga vetë goja e tij kam mësuar shpesh të tregojë histori e ndodhi të vërteta, që sot do të dukeshin deri edhe të pabesuara. Shkolla nuk ishte shumë larg nga fshati i tij, por për kushtet e vështira atmosferike në ato vite bëhej rrugë e largët, sidomos kur fryhej e inatosej përroi i Blliçes. Kishte raste që e ndërprisnin dhe shkollën, kishte raste që mësuesit i shoqëronin vetë nxënësit, por më shpesh dhe vetë prindërit, por edhe pse mjaft vështirësi e peripeci të tilla, Shabani nuk u tërhoq nga shkolla, nuk bëri mungesa dhe e përfundon shkollën shtatëvjeçare me notën maksimale pesë.

Nuk ka pengesë që të ndalë njeriun, nëse ai ka vullnet. Në rrugë e sipër një njeri i vetëdijshëm për atë që bën, do të kuptojë se nuk do t'i duhet as gjysma e forcës që ka pasur ndërmend të përdorë.


Dhe Shabani kishte kuptuar se injoranca e vërtetë, tek kushdo qoftë, i vogël apo i rritur, nuk ishte mungesa e njohurive, por refuzimi për t'i përfituar nga librat. Kështu, pas përfundimit të shkollës shtatëvjeçare i doli e drejta e studimit për në shkollën e mesme të Teknikumit të Ndërtimit në Tiranë, e drejtë studimi, por me gjysmë burse, një pagesë kjo që për familjet shqiptare kushtonte shumë.

E shkuara e familjes dhe historia e saj janë si një busull që e orientojnë dhe e udhëheqin njeriun për të inspiruar hapa të sigurt drejt një objektivi tjetër të lartë. Pra, vetëm në këtë mënyrë rrugëtimi, duke u mbështetur te tradita familjare, ai shikon dhe përjeton të kaluarën, të tashmen, por që i shërben edhe si për të shkuar tek e ardhmja. Dhe familja e Shabanit e donte arsimin, e dinin se të gjitha vijnë falë arsimit, ndaj për arsimimin e plotë të Shabanit bënë gjithçka. Me këtë sedër dhe dashuri për shkollën, Qazim Bitri i edukoi edhe fëmijët e tjerë.

Shabanit, ende fëmijë, iu desh që verës të vazhdonte punën në një sektor të ndërmarrjes Rruga-Ura në Qukës të Librazhdit. Këtu u njoh më mirë me jetën dhe punën që bënin punëtorët kantiereve, u lidh dhe u miqësua me të gjithë, fitoi një përvojë të mirë për punë dhe vullneti i tij u forcua edhe më shumë.

E mbaron shkollën e mesme me nota të larta dhe sapo mbaron shkollën e mesme, Shaban Bitri do të transferohet në Pukë, në një kantier ndërtimi i cili varej nga Ndërmarrja e ndërtimit Shkodër.

Dy vite më vonë i doli e drejta e studimit për në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit. Ishin vitet 1970-1971. Në vitin e tretë, kur dhe ndaheshin degët, Shabani caktohet për ndërtime civile dhe industriale.



*Planimetria e përgjithshme e digës së hidrocentralit të Fierzës.*



*Ekspertë të Institutit të Teknologjisë dhe specialistë të Ministrisë së Ndërtimit në Koman, 1984.*

cyan magenta yelloë black

**Shabani fitoi shumë në veprat ku punoi, fitoi edhe disa cilësi të veçanta që vazhdon t'i ruajë me fanatizëm edhe sot që është në pension. Nga natyra shumë i prerë, serioz e fjalëpakë, këmbëngulës e me një vullnet mjaft të fortë, besnik ndaj të tjerëve.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

QYTETAR NDERI

z. Shaban Bitri

Për kontributin e dhënë në fushën e ndërtimit për 45 vjet si inxhinier, duke punuar me pasion, përkushtim, profesionalizëm, ndershmëri e përgjegjësi në veprat e mëdha e të vështira hidroenergjetike si hidrocentralet Fierzë e Koman, në infrastrukturën rrugore e hekurudhore, ndërtimin e urave kudo në Shqipëri, për ndihmesën e çmuar teknike e shkencore në zgjidhjen e problemeve në këtë fushë; si dhe për mbështetjen e artit dhe kulturës, duke nderuar gjithmonë me punën e tij vendlindjen, dibranët dhe Dibrën.




Duke e parë veten nga pozitat që aty kishte ardhur për t'u përgatitur, për të justifikuar të gjithë atë çka bënë prindërit për shkollimin e tij, ai zbatoi pikë për pikë atë që duhej të dilte me rezultate të larta dhe gjatë gjithë periudhës së studimeve, Shabani e justifikoi tamam besimin e prindërve të tij, duke dalë nga viti në vit me rezultate të larta.

Në këto vite kur inxhinieri i ardhshëm ndiqte me zell të madh studimet, hidrocentrali i Fierzës një kantier i madh energjetik kishte filluar punë. Drinit po i vinin pritë në Fierzë, që ujin e tij ta kthenin në energji elektrike.

E kishin ndjekur hap pas hapi ecurinë e studimeve të inxhinierit të ardhshëm dhe kështu edhe vendin e punës ia kishin siguruar ende pa i përfunduar dy provimet e fundit.

Thonë se njohuritë e marra në shkollë, sido që të kenë qenë rezultatet, nuk mjaftojnë. Ata duhet të bëhen të prekshme, të gjejnë zbatim në praktikë. E ndaj inxhinier Shaban Bitri atë ditë gushti kur udhëtonte drejt kantierit të Fierzës, në valixhe kishte më shumë libra se sa rroba. Kishte marrë libra me vete se e dinte mirë që do të përplasej me të reja dhe vështirësi në atë vepër që po hidhte shtat, e kur teoria gërshetohet me praktikën, vështirësitë si do që të jenë bëhen të kapërcyeshme.

Me korrektësi, pasion e aftësi të dukshme profesionale, me dashuri e idealizëm të kulluar, fali dekadat e moshës më të mirë në veprat e dritës, në digat e hidrocentraleve.

Hidrocentrali i Fierzës ishte një vepër e rëndësisë së veçantë, vepra ma e madhe hidroenergjetike në vendin tonë. Shabani u përball me të gjitha këto vështirësi që haseshin në këtë vepër, por kurrë nuk u tërhoq. Shabani nuk skuqej të pyeste më të moshuarit, shokë e kolegë, por herë pas herë do t'u kthehej edhe librave që kishte marrë me vete.



*Ura e Blliçes.*

Edhe pse ende i ri në moshë, Shaban Bitri bënte pjesë në ato kuadro drejtues që mirësia dhe ndershmëria ishin "kostume" që vërtet i shkonin bukur. Dhe i tillë ka mbetur ende sot, tek i gëzohet pensionit të pleqërisë.

Kënaqësia më e madhe arrihet pasi njeriu heq dorë nga ambiciet, nga smira për të bërë karrierë në rrugë të pandershme. Shaban Bitri nuk e kishte për pjesë të karakterit të tij.

Fierza në ato vite u bë një ndër qytezat punëtore më të populluara, ku kishte afro 12 mijë banorë dhe me një gjallëri në çdo orë të ditës dhe natës. I gjithë personeli inxhiniero-teknik këtu ishte i kualifikuar, por kishte dhe shumë specialistë të huaj kinezë. Siç tregon vetë Shabani, specialistët kinezë punonin me përkushtim dhe nuk dinin të gënjenin, pasi ishin të pajisur me një ndershmëri absolute.

Fierza shërbeu edhe si një shkollë e dytë për Shabanin, pasi këtu u rrit më shumë, mësoi më shumë dhe përfitoi një përvojë që në çdo vend tjetër të kishte qenë, nuk do ta kishte marrë. Fierza ishte dhe mbeti ajo shkollë për mjaft punëtorë dhe kuadro të rinj që vinin direkt nga bankat e shkollës. Pas Fierzës inxhinier Shaban Bitrin do ta gjenim në Koman, në një tjetër vepër të madhe hidro-energjetike. Mbi katërmbëdhjetë vite nëpër veprat e dritës e më së shumti në zbatim, aty ku ishin dhe vështirësitë më të mëdha.

Shaban Bitri kishte aftësi për të shikuar e vepruar, por pa gjykuar të tjerët. Edhe nëse gjatë punëve tek të tjerët shikonte të meta dhe dobësi, Shabani do t'i kështillonte, do t'u tregonte se si mund të eliminoheshin dhe kurrë nuk i bënte objekt diskutimi e debati të mirëfilltë.

**FAMILJA**

Krahas punës, domosdo që një rol kryesor ka edhe familja dhe roli parësor ishte edhe edukimi i fëmijëve. Shabani ishte i angazhuar shumë me punët e ngarkuara, me përgjegjësi të mëdha, ku vetëm pak orë i mbeteshin me familjen, por e ndiente se kishte përgjegjësi edhe në rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tij, megjithëse këto përgjegjësi ia lehtësonte Vita, bashkëshortja e tij, jo vetëm si grua model, por edhe si mësuese në profesion. Detyra e saj nuk ishte vetëm të përkujdesej për zhvillimin dhe rritjen normale e pa brenga të tyre, por edhe t'i përgatiste për jetën, duke nderuar punën, cilado qoftë ajo, fizike apo intelektuale.

Pikërisht nga periudha e gjatë në këto vepra, Shabani fitoi shumë, fitoi edhe disa cilësi të veçanta që vazhdon t'i ruajë me fanatizëm edhe sot që është në pension. Nga natyra shumë i prerë, serioz e fjalëpakë, këmbëngulës e me një vullnet mjaft të fortë, besnik ndaj të tjerëve.

Pas Fierzës e Komanit do ta gjejmë në hekurudhën e re që kishte filluar të zgjatej nga Miloti në Rrëshen dhe ku destinacioni i fundit i hekurudhës do të ishte Klosi. Ing. Shaban Bitrit këtu iu besuan urat dhe veprat e artit për afro në 6 kilometër trase. "Urat kanë qenë pasioni im i madh në jetën time si ndërtues, - thotë Shabani. Ato kërkojnë guxim, njohuri të thella, ekzaktësi, preçizion të madh, siguri që ka të bëjë me një sërë faktorësh. Të gjitha urat më kanë dhënë gëzim dhe kënaqësi, por ura e ndërtuar mbi Blliçe më ka dhënë një kënaqësi që nuk e kam përjetuar kurrë. Kjo ka mjaft arsye, sepse kjo urë lidhet me jetën time. Dhe jo vetëm me jetën time, por edhe të bashkëfshatarëve të mi dhe të shumë brezave njerëzorë që kanë vuajtur nga përroi i Blliçes".

Pas kantierit të hekurudhës, Shabani transferohet në Shkodër në Ndërmarrjen e Ndërtimit. Pas një periudhe dyvjeçare kalon në vitin 1988 si kryeinxhinier pranë Ndërmarrjes së Rrugëve Shkodër. Ishin pikërisht këto kantiere të rëndësishme që ishin hapur në vendin tonë, që inxhinier Shaban Bitri të vlerësohej e rivlerësohej disa herë.

Në hidrocentralin e Fierzës, të Komanit dhe hekurudhë inxhinier Shaban Bitri është vlerësuar për punën që ka bërë me medalje dhe urdhra pune. Ndërsa Këshilli Bashkiak Dibër e nderoi Shaban Bitrin me titullin më të lartë "Qytetar Nderi" i Dibrës.

Dituria është pasuri që fitohet me përvojë, por edhe kur kërkesat ndaj vetes qëndrojnë të ingranuara, në lidhje të pandërprerë me përparimin e teknikës dhe të shkencës në shkallë botërore. Dhe Shabani edhe sot lexon, lexon shumë, lexon libra të ndryshëm, por edhe literaturë bashkëkohore për veprat e ndërtimit.

**Kaluan shumë vite, rrodhën shumë ngjarje dhe ujëra të rrëmbyeshme në jetët njerëzore. Te personaliteti i Shaban Bitrit nuk ka ndryshuar asgjë. Është po ai inxhinieri i dikurshëm i digave të mëdha, kërkues ndaj vetes e të tjerëve, korrekt e fjalëpakë, dinamik, i dashur dhe respektuar nga të gjithë.**

**Dhe sot, pas kaq vitesh, çdo mëngjes tek i njëjti lokal e gjejmë, tek e njëjta tavolinë, por nuk e shijon kafen si atëherë. Pret, hap sytë nga dera që tavolina të mbushet plot. Është mësuar Shabani me njerëz shumë, është mësuar kantiereve...**

Shaban Bitri u njoh mirë me jetën, sepse e njohën veprat e mëdha të dritës që sot, edhe po të duash, vështirë se ndërtohen më, me uljet e ngritjet e saj, duke e filluar atë nga hiçi, për të arritur më vonë shumë në formimin e tij, do t'i falnin "mëvetësinë" për të ndërmarrë më pas veprime që në fund të fundit do të ishin si një shtrëngatë për t'i dhënë vetë jetës drejtimin e duhur.

Jeta ka provuar se ai që shpërfill mundimin, vuajtjet, përgjithësisht sakrificën për të arritur diçka të virtytshme, në fund ndjehet i lumtur dhe i plotësuar në shpirt e në ndërgjegje. Shaban Bitri i ngjan pa dyshim, është "binjak" me çdo njeri që i ngjit shkallët e karrierës me urtësi, duke e konsideruar pozicionin apo një detyrë të lartë qoftë partie, qoftë administrative, si një premtim të mundimit për të arritur deri aty.

Kur gjykojmë rreth aftësive drejtuese e organizuese të Shaban Bitrit, të mençurisë së tij, për zgjidhjen e problemeve të shumta që i dilnin përpara, të shumta e të komplikuara, në objektet e rëndësisë së veçantë siç ishte Fierza e Komani, me urtësinë që e karakterizonte ai dinte që t'i zgjidhte të gjitha e t'u jepte udhë. E vetmja mënyrë për të bërë punë të dobishme, ndoshta jo të mëdha, por që të jenë të mirëpritura nga njerëzit, është që ta duash atë që bën dhe të lodhesh e të sakrifikosh për të arritur gjithçka.

Punoi e jetoi në një kohë të vështirë, në një moshë të re. U përplas me dallgët e jetës nga më të vështirat, por Shaban Bitri ishte një pinjoll i një familje të mirë, të njohur jo vetëm në Blliçe, por dhe jashtë sinorit të saj. Ai veproi me kujdes dhe çau përmes dallgëve dhe furtunave, se i tillë ishte brumosur.

Kaluan shumë vite, rrodhën shumë ngjarje dhe ujëra të rrëmbyeshme në jetët njerëzore. Te personaliteti i Shaban Bitrit nuk ka ndryshuar asgjë. Është po ai inxhinieri i dikurshëm i digave të mëdha, kërkues ndaj vetes e të tjerëve, korrekt e fjalëpakë, dinamik, i dashur dhe respektuar nga të gjithë.

Flokët i janë zbardhur, mosha i rëndon pak mbi supe dhe përsëri nuk ka dëshirë ta quash pensionist. Kujton gjithë nostalgji kafenë e mëngjesit kur e pinte me shokë e kolegë pa vajtur në punë, aty në kantier. Dhe sot, pas kaq vitesh, çdo mëngjes tek i njëjti lokal e gjejmë, tek e njëjta tavolinë, por nuk e shijon kafen si atëherë. Pret, hap sytë nga dera që tavolina të mbushet plot. Është mësuar Shabani me njerëz shumë, është mësuar kantiereve dhe nuk i shijon as kafja e mëngjesit në vetmi.

**Tani që "Rruga e Arbërit" po bëhet një realitet, ne kujtojmë të gjithë ata intelektualë idealistë që e ngritën të parin zërin për një vepër të tillë.**

# **Ramadan Perhati,** luftoi si spartan, jetoi si skllav

*Nga* **ISUF MIHA**



**Ramadani ka lindur në Qafë Murrë me 20 janar 1930 në një familje me tradita të vyera dhe fisnike.**

**Këshillit Bashkiak i Dibrës, me datë 30 prill 2019, me 17 vota pro, i akordoi Titullin "Qytetar Nderi" me motivacionin "Për kontribut të shquar si inxhinier, kryeinxhinier i Drejtorisë së Përgjithshme të Kërkimeve të Naftës dhe Drejtor Drejtorie të shpimeve të naftës i metodave të reja e bashkëkohore në kantiere".**

Të shkruaj për profesor doktor Ramadan Perhatin nuk është e lehtë, sepse është personalitet i shumanshëm.

Shkak për të shkruar u bë vendimi i Këshillit Bashkiak të Dibrës, i cili me datë 30 prill 2019, me 17 vota pro, i akordoi Titullin "Qytetar Nderi" me motivacionin "Për kontribut të shquar si inxhinier, kryeinxhinier i Drejtorisë së Përgjithshme të Kërkimeve të Naftës dhe Drejtor Drejtorie të shpimeve të naftës i metodave të reja e bashkëkohore në kantiere".

Ramadani ka lindur në Qafë Murrë me 20 janar 1930 në një familje me tradita të vyera dhe fisnike.

Ishin këto virtyte që ndikuan në formimin e këtij djaloshi 14 vjeçar dhe ndjenjat e atdhedashurisë që vetë i dyti, së bashku me Mustafa Bibën, rrokën armët, pushkët me gjalma të dhuruar nga prindërit e tyre, dhe u rreshtuan në formacionet e Brigadës 18 Sulmuese.

Luftoi deri në Jugosllavi për çlirimin e vendit.

Ramadani vazhdoi studimet në shkollën "Skënderbej" me vitet të përshpejtuara dhe atë të maturës e kreu në liceun e Shkodrës. Ndërsa arsimin e lartë e kreu në Moskë në Institutin IM Guplim të naftës.

Diplomimi i tij u shoqërua me Distinktivin e Argjendtë, dhënë nga Ministria e Arsimit të lartë të Bashkimit Sovjetik.

Me t'u kthuer në atdhe, emërohet specialist në komunitetin gjeologjik shtetëror të naftës, pastaj në ndërmarjen e shpimeve të naftës në Patos, ku kreu detyra të rëndësishme si inxhinier i thjeshtë, kryeinxhinier, drejtor i drejtorisë së shpimeve të naftës.

Për punë të palodhur shkencore është vlerësuar me tituj e grada shkencore.

Por kaleidoskopi i profesor Perhatit i thelloi dijet, duke botuar tekste, manuale në revista prestigjioze brenda dhe jashtë vendit.

Ka mbajtur kumtesa në simpoziume, ka botuar monografi, "Zjarre e Fontana", "Unë kamikaze naftëtare dhe Ministri", "Një jetë për arin e zi", e shumë artikuj në shtypin periodik e leksione në auditore studentësh.

Jo pa qëllim e titulluam "Luftoi si spartan", sepse diktatura, pavarësisht vlerave, ia ndërpreu në mes mundësinë për të investuar për atë që studioi e punoi.

Në vitin e mbrapshtë 1975, Partia e Punës ndërmori shpartallimin e punës armiqësore në naftë, për të cilat u dënuan deri në masa kapitale.

Por për inxhinier Ramadanin nuk u gjet asnjë provë që të dënohej me heqje lirie,por dallga për ta dënuar profesor Ramadanin, njeriun me vlera, e dënon të punojë direkt si punëtor sondist, punë me turne e vështirësi, pavarësisht moshës e meritave. Ai, siç thotë dhe vetë, e ndjente veten të distancuar nga ish bashkëpunëtorët, madje edhe në radhën e bukës i rrinin larg si armik i Partisë.

Jo vetëm ai, por edhe bashkëshortja, prof. Nezihaja, u dëbua në fshatrat e Fierit, duke dhënë mësim për edukimin e brezave.

Ramadani, edhe pse në pension, nuk pushon së shkruari, duke qenë aktiv si në jetën shkencore,shoqërore e kudo, për të dhënë kontributin si intelektual.

Do të ishte e tepërt të përsëritnim punën vetëmohuese të këtij njeriu me tipare që brezat e rinj kanë se çfarë të mësojnë.




# Vëllezërit Xhaferri: **Isufi** dhe **Hamiti**

*Nga* **XHAFER MARTINI**

**Isufi dhe Hamiti e kishin ngritur zërin edhe për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Ata tani nuk janë më. Po ne të tjerët që jetojmë, dhe të tjerët që do të vijnë mbas nesh, do t'i kujtojnë me respekt dhe dashuri pionierët e parë të emancipimit dhe të përparimit shoqëror. Natyrisht, kur të bëjnë këtë, do të ndalen edhe te dy vëllezërit e mrekullueshëm, Isuf dhe Hamit Xhaferri.**

Para pak ditësh Shoqata e Intelektualëve Dibranë bëri një sesion shkencor për ecurinë e deritanishme të Rrugës së Arbërit.

Sesioni shkencor kishte qenë përgatitur shumë mirë, si çdo gjë ku vë dorë profesor Bashkim Lleshi, që është aq shumë i përkushtuar dhe skrupuloz në çdo detyrë që merr përsipër.

Kam këtu mbi tryezën e punës "Disa të dhëna për projektin teknik të "Rrugës së Arbërit", përgatitur nga prof. Bashkimi, që na i dha ditën që vizituam këtë Rrugë. Këto të dhëna rezultojnë jo vetëm shkencë, por edhe dashuri dhe përkushtim të madh për vendin e lindjes. Në sesion shkencor u referuan me kompetencë nga disa studiues çfarë mund të bëhet për zhvillimin ekonomik e kulturor për qarkun e Dibrës mbas përfundimit të "Rrugës së Arbërit", që do të shkurtojë distancën. Ishin platforma studimi shumë të hollësishme me vlerë të madhe praktike. Kjo veçanërisht duhet thënë për studimin e prof. as. Vesel Hoxhës.

Tani që "Rruga e Arbërit" po bëhet një realitet ne kujtojmë të gjithë ata intelektualë idealistë që e ngritën të parin zërin për një vepër të tillë. Atëherë ata na dukeshin si Donkishotisë, si njerëz që shikonin ëndrra në diell. Por kjo i nderon ata, se të gjithë njerëzit largpamës kanë ecur një hap para shoqërisë në të cilën jetonin dhe nuk janë kuptuar prej saj. Mua më erdhi shumë mirë që atë ditë, në fund të sesionit shkencor, Hysen Uka, që është edhe vetë një nga këta idealistë, përmendi pionierët e parë të "Rrugës së Arbërit", ata që luftuan që kjo rrugë të ndërtohej. Midis tyre kanë qenë edhe vëllezërit e mrekullueshëm Xhaferri: Isufi dhe Hamiti, të cilët dua t'i kujtoj dhe t'i nderoj në këtë shkrim, mbasi kanë shumë kohë që nuk janë më në jetë. Ishin nga Zerqani.

Isufi, si mbaroi shkollën pedagogjike të Peshkopisë në vitin 1968, ka punuar mësues dhe drejtor shkolle në Zerqan. Natyrisht, që i plotësoi studimet. Me Isufin kam pas fatin të jem në shkollën pedagogjike, natyrisht jo në një klasë, unë në të dytën, ai në të katërtën. Por, meqë klasa ime kishte mbi shtatë- tetë lojtarë që përbënin ekipin e futbollit të të rinjve të Peshkopisë, bënim shpesh ndeshje me ata të klasës së katërt, ku bënte pjesë edhe Isufi. Herë mundeshim, herë i mundnim, por rëndësi kishte fakti që një klasë "Xhagadurrësh", siç ishte ajo e Isufit, pranonte të luante me një klasë dy vjet poshtë saj. Isufi ishte shumë tifoz sporti, por nga ata më të lezetshmit, me një humor të këndshëm. Ai çtensiononte çdo situatë me humorin e tij dhe të gjithë e shikonim me adhurim. Mbasi mbaroi shkollën dhe filloi punën, vinte më rrallë në Peshkopi, por vinte. Ishte njeri shumë i shoqërueshëm, si gjithnjë me humor, dhe unë e kisha kënaqësi të takohesha me të dhe të pija një kafe.

Zakonisht vinte të shtunave dhe unë, të them të drejtën, e prisja të shtunën me një gëzim të veçantë, pikërisht se kishte mundësi të takohesha me Isufin. Ka dhënë një kontribut të madh jo vetëm për arsimin, por edhe për kulturën.

Në Zerqan u ngrit një grup i famshëm artistik në fushën e estradës prej punës së madhe të Isufit. Në vitin 1973, nëse jam i saktë, ky grup, pasi fitoi në festivalet amatore në shkallë rrethi, përfaqësoi Dibrën në Festivalin e estradave amatore për Zonën e Veriut që u zhvillua në Burrel. Edhe atje zuri vendin e parë. Për mua ato dhjetë ditë, nën shoqërinë e Isufit, të preokupuar për diskutimet për artin, kanë qenë nga më të bukurat e jetës sime.

Vdekja e tij, siç e thonë të gjithë, shkaktoi një traumë jo vetëm familjes, por edhe shoqërisë. Në çdo problem, sado delikat të ishte, ndërhynte Isufi dhe e zgjidhte. Ishte edhe burrë kanuni, por edhe akademik mendjendritur.

Hamiti, i vëllai, kishte një profil tjetër shpirtëror, ndryshonte edhe nga cilësia e humorit me Isufin, punonte në spital, si teknik radiolog. Ishte me shkollë të mesme, por njeri me shumë kulturë: dinte gjermanisht dhe frëngjisht dhe e gjeje vazhdimisht në bibliotekë tek Ulvi Shehu. Ishte njeri pasionant dhe i papajtmueshëm me padrejtësitë. Kishte shpirt disidenti dhe sigurisht prej kësaj cilësie ka vuajtur. U martua vonë dhe, ngaqë nuk kishte mjete financiare, mezi mundi të gjejë një dhomë ku të fuste kryet. U bë me fëmijë në këtë kolibe. E deshi shumë demokracinë dhe ka luftuar shumë për ardhjen e saj. Kuptohet se arma e intelektualit ishte fjala, por fjala e Hamitit ishte shumë e goditur, e helmët për ata që donte t'i denigronte dhe e ëmbël, si fllad pranveror, për ata që i donte t'i lartësonte. Ishte mjeshtër i madh i përdorimit të fjalës së folur.

Ruaj një kujtim të dhimbshëm, familjar, prej tij: gruaja ime shkon për të parë të vëllian të operuar në spitalin e Peshkopisë. E gjen atë në një gjendje shumë të rëndë, kur po jepte shpirt. Janë ato ndërlikimet pas operacionit. Ajo fillon të qajë, se asnjë nga infermieret nuk mund të bënte asgjë, kurse doktor Irfani që e kishte operuar, kishte ikur në shtëpi dhe nuk dilte në telefon. Pyet Hamiti gruan time përse po qante dhe, kur merr vesh shkakun, merr vrapin dhe mbas dhjetë minutash kthehet bashkë me doktor Irfanin. I sëmuri shpëtoi në sajë të ndërhyrjes së doktorit, por atë e solli Hamit Xhaferri.

Prej këtij veprimi unë dhe Hamiti u bëmë miq. Kisha pririjen për t'i dashur njerëz të tillë, por veprimi i tij human më afroi më shumë. U sëmur rëndë në atë kolibe nga një sëmundje që nuk të jep shpresë. Demokratët që ai aq shumë i kishte mbështetur, tani ishin në pushtet, por nuk bënë asgjë për t'ia përmirësuar gjendjen Hamit Xhaferrit. Vdiq në mjerim, pa e gëzuar jetën.


Isufi dhe Hamiti, siç e thashë në krye të këtij shkrimi, e kishin ngritur zërin edhe për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Ata tani nuk janë më. Po ne të tjerët që jetojmë, dhe të tjerët që do të vijnë mbas nesh, do t'i kujtojnë me respekt dhe dashuri pionierët e parë të emancipimit dhe të përparimit shoqëror. Natyrisht, kur të bëjnë këtë, do të ndalen edhe te dy vëllezërit e mrekullueshëm, Isuf dhe Hamit Xhaferri.

recensë

Përshkrim rreth librit të Justin Godart "Shqipëria në vitin 1921", përkthyer nga Mirdash M.Shehu

# Shqipëria me syrin e Justin Godart

*Nga Prof. Asoc. Dr.* **BERNARD ZOTAJ**




**NJË RRUGË ME EMRIN "JUSTIN GODART"**

Kohë më parë kam lexuar librin e Justin Godart "Shqipëria në vitin 1921", të përkthyer me mjeshtëri nga Mirdash M. Shehu prej Dibrës. Kjo më zgjoi interesin për të bërë lidhjen dhe shkruar për rrugën dhe librin me të njëjtin emër. Një dibran i ndershëm që përkthen librin e tij dhe një Vlorë e Flamurit që vendos emrin e një rruge nga më historiket e saj.

Në zemër të qytetit të Vlorës, ku ende ruhet identiteti, gjurmët e ndërtimeve në fund të shek. XIX dhe fillimet e shek. XX, gjendet Rruga "Justin Godart". Kjo ishte rruga kryesore e qytetit në periudhën e Rilindjes dhe të shpalljes së Pavarësisë Kombëtare. Në këtë rrugë hyri dhe Isa Buletini me trimat e tij për të marrë pjesë në festën e flamurit të vitit 1912. Në këtë rrugë Isa tha dhe thënien lapidar se "burri ulen në gjunjë vetëm një herë, kur puth flamurin kombëtar". Në fund të rrugës nga perëndimi gjendet Sheshi i Flamurit, ndërsa në lindje shtrihet Lagjja Partizani. Nga lagjja shkohet për në Babicës, prej këtej hynë fitimtarë në Vlorë luftëtarët e 1920. Shtëpitë e kësaj rruge janë dy kate, me ballkone të vegjël. Degëzimet e rrugës të shpien në tek ish-pazarin, "lagjja e hebrenjëve", klubi "Laberia" dhe ish-Sinagoga.

Në fund të rrugës në anën lindore deri pas çlirimit gjendej xhamia e Tabakëve, që ishte më e madhe për kohën. Rruga kishte dhe ndërtesa shoqërore në shek. XIX, si sahat tip kullë dhe postën e qytetit. Rrugës i është çuar emri i juristit të njohur francez Justin Godard. Në Konferencën e Paqes në Paris, më 1919, Justin Godart ka mbrojtur të drejtat e Shqipërisë.

**POROSIA E MUNIR F. SHEHU, RUANI BIBLIOTEKËN**

Munir F. Shehu ka qenë një intelektual nga Dibra. Ai ishte një mësues patriot, i cili gjithçka jua mësoi nxënësve të tij. Gjithashtu ai ka qenë dhe kompozitor, si dhe mbledhës i folklorit në Dibër. Edhe i biri i tij, Mirdash M. Shehu ka mësuar prej mësuesit baba.

Libri doli në dritë në saj të frëngjishtes që babai i mësoi të birit. Libri ka qenë për shumë vite pjesë e bibliotekës së Munir F. Shehu. Shqipëria gjithmonë ka pasur intelektualë të cilët kanë luftuar dhe mbrojtur më dashuri dhe pasion dijen. Një prej tyre ishte Munir Shehu, që u dallua që herët dhe ju përkushtua mësimit të historisë të vendit të tij. Në bibliotekën e tij gjenden rreth 80 libra të rrallë do të mësonte, se sa gjëra të mbrapshta bëheshin nga fqinjët dhe Fuqitë e Mëdha të kohës për fatet dhe copëtimin e Shqipërisë së vuajtur.

Por historia për librat e intelektualit Munir do të ishte një rrugëtim i gjatë. Munir Shehu kishte kulturë të gjerë, por dhe bindje demokratike. Me çlirimin e vendit dhe vendosjen e demokracisë popullore, në vitin 1945, Muniri arrestohet dhe shpallet "armik i popullit", burgoset, lirohet, burgoset e lirohet përsëri. Gjatë gjithë kësaj periudhe kishte vetëm merakun e shkatërrimit të bibliotekës. Bibliotekën e kishte ngritur me shumë sakrifica, me shumë mund dhe brenda saj gjendeshin shumë vlera. Gjithmonë tepër i shqetësuar pyeste dhe porosiste të afërmit ti ruanin dhe ti fshinin librat në vende të sigurta.

Biblioteka e tij u end gjatë në të gjithë Dibrën e ngarkuar në kuaj e në mushka, natën, librat udhëtonin nëpër nga një shtëpi në tjetrën për t'u ruajtur nga e keqja që i kishte zënë. Shumë libra u grisën dhe mbetën rrugës faqe-faqe, një pjesë humbën rrugëve të Dibrës, të tjera notuan në ujë në bodrume, ndërsa shumë shkrime të tij, ndezën zjarrin në odat dibrane për të ngrohur fëmijët. Pas këtyre vuajtjeve e rraskapitjeve të bibliotekës së madhe të Munir Shehu ngelën pa u prishur siç shkruan i biri në parathënien e librit një Larus i 1936, një metode solfezhi, ndonjë gjë tjetër dhe... libri i Godartit. Vetëm ky shpëtoi si dëshmitar i tërë këtyre vuajtjeve dhe i përpjekje për të treguar histori. I biri, Mirdashi si një "borxh" që i kishte babait, libri foli shqip.

**KONTRIBUES PËR LIBRIN E JUSTIN GODART**

Në mars 1997 në qytetin e Peshkopisë kishte plasur çmenduria e njerëzore. Rrugëve njerëz të armatosur, qëllonin pa pushim, ndërsa Mirdashi luftonte dhe kërkonte paqen. Dhe paqen e gjeti në librin e J. Godart, duke e cilësuar si libër i paqes. Sistemi socialist i hoqi të drejtën e arsimimit të lartë, po jo dashurinë për librin. Krismat e armëve të llojeve të ndryshme dëgjoheshin pa pushim natën në qytet, Mirdashi lexonte Godartin. Nisi kështu përkthimin fjalë pas fjale, rresht pas rresht dhe germë pas germe. Ishin bashkë stërmundim dhe kënaqësia. Në fëmijëri Mirdashi e kishte prekur me mijëra herë këtë libër, pasi ishte me kapak të trashë dhe përdorte për koleksionin e pullave postare. Duke shfletuar këtë relikte të fëmijërisë, për pulla, kurioziteti e shtyu të lexoj pa ndonjë qëllim, rreshtin e parë të parathënies së librit. Këtë e kishte shkruar nobelisti i paqes, sekretari i komisionit të caktimit të kufijve të Shqipërisë me Malin e Zi, D'estournelles de Constant, ku theksohej se "unë i kam shumë borxh Shqipërisë; unë do ta paguaj këtë borxh të rinisë".

Lexoja për herë të parë një diplomat të huaj, në gjuhën e tij, frënge, që shfaqte pendesë për qëndrimet ndaj Shqipërisë, të shkruar në vitin 1921. E lexonte pa u ndaluar dhe kishte mbërritur në fund. Kështu vendosi dhe e përktheu me durim dhe dashuri, që t'u sillte lexuesve një libër. Ky libër kishte për autor Justin Godart, politikan i shquar francez dhe njohës shumë i mirë i shqiptarëve, të cilin, e drejta e bëri mik të tyre. Ky libër është "historia e Shqipërisë, historia e padrejtësive të diplomacisë së Fuqive të Mëdha për të fshirë nga harta një nga kombet më të vjetër në Evropë, historia e përpjekjeve të paepura të presidentit Uillson në mbrojtje të shqiptarëve, historia e vuajtjeve dhe përpjekjeve të tyre për të mbijetuar, duke luftuar kundër të gjithëve, të braktisur, krejt vetëm".

Justin Godart ishte ndër të paktët njerëz që vepruan me guxim, mbrojtën të vërtetën dhe nuk i braktisi kurrë shqiptarët. Gjërat duken si të ditura, por duhet menduar thellë. Ky libër me këndvështrim të drejtë, me shikim të sprovuar, me këshilla të ndershme, vlen edhe sot më shumë për të kuptuar forcën e fjalëve. Përvoja e Godart na vjen nëpërmjet librit si një vlerë e madhe për të njohur veten dhe të tjerët. Në libër është pasqyruar me vërtetësi dhe paanshmëri të gjitha intrigat që u bëheshin shqiptarëve nga fqinjët dhe nga Fuqitë e Mëdha. Libër ju jep përgjigje shumë pyetjeve për ngjarjet që po ndodhin edhe sot. Ndaj faleminderit Mirdash M. Shehu për këtë libër me vlera të sjellë për shqiptarët.

**Munir F. Shehu ka qenë një intelektual nga Dibra. Ai ishte një mësues patriot, i cili gjithçka jua mësoi nxënësve të tij. Gjithashtu ai ka qenë dhe kompozitor, si dhe mbledhës i folklorit në Dibër. Edhe i biri i tij, Mirdash M. Shehu ka mësuar prej mësuesit baba.**

**Justin Godart ishte ndër të paktët njerëz që vepruan me guxim, mbrojtën të vërtetën dhe nuk i braktisi kurrë shqiptarët. Gjërat duken si të ditura, por duhet menduar thellë.**

**PERSONALITET ME KONTRIBUTE TË VEÇANTA**

Autori i librit "L'Albanie en 1921" (Shqipëria në 1921), politikan dhe personalitet i shquar francez Justin Godart, ishte një nga njerëzit me kontribute të veçanta në plan kombëtar e ndërkombëtar. Në botë gjenden njerëz përparimtarë, të cilët të parët ngrenë zërin në mbrojtje të lirisë dhe luftojnë pa u lëkundur për paqe e drejtësi. Në këtë drejtim Godart nuk ndaloi gjatë gjithë jetës së tij përpjekjet në mbrojtje të të drejtave të popujve, për çlirimin e tyre, për progres shoqëror. Ai është cilësuar si "I drejti i kombeve", pasi tërë jetën ju kushtua drejtësisë dhe lirisë. Ai gjtë jetës së tij ishte deputet e senator në Francë, nënsekretar shteti, ministër i Punës e i Higjenës, ministër i Shëndetësisë, mbante gradën shekencore Doktor në Drejtësi. Ai ka qenë dy herë Kryetar i Konferencës Ndërkombëtare të Punës, këshilltar bashkiak, si dhe kryetar bashkie.

**MIK I SHQUAR I POPULLIT SHQIPTAR**

Ai në jetën e tij përkrahu luftën e re, që ishte lufta e masave popullore për demokraci dhe kundër reaksionit çifligar. Në këtë luftë me dy fronte për popullin shqiptar, popullin fisnik dhe me histori të lashtë, ngjalli simpatinë e Godart për Shqipërinë. Godarti nisi kështu tu kundërvihej hapur diplomacisë franceze, e cila nga koniuktura politike ndërkombëtare, mbante qëndrim të padrejtë ndaj problemit shqiptar. Ai krijoi besimin se populli shqiptar do ishte fitues ndaj atyre që e pengonin në rrugën e tij për prosperitet e përparim. Në hyrje të librit shkruan se "ne do të përshkruajmë, Shqipërinë e sotme drejt përparimit që ka nisur dhe që do vazhdojë, në sajë të lirisë, për të cilën ajo do të luftojë në të ardhmen, ashtu siç ka bërë edhe në të kaluarën dhe vendosmërisht, po të jetë nevoja".

Nga kjo kohë e gjatë gjithë jetës së tij J. Godart mbeti mik i Shqipërisë. Si mik i vjetër i Shqipërisë, në fund të vitit 1950, në moshën 80 vjeç, mori pjesë në festat e nëntorit. Në mitingun e Tiranës do të shkruante se "Jam këtu, si një nga miqtë më të vjetër të Shqipërisë dhe mund të them, nga më besnikët e saj". Ai ishte i zgjedhur nga miqtë francezë të Shqipërisë, President nderi i shoqatës Francë-Shqipëri. Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka vlerësuar J. Godartin duke e dekoruar me Urdhrin e Lirisë të Klasit të Parë.

Justin Godart ka mbetur në kujtesë si një mik i vjetër e besnik, ku populli shqiptar e kujton dhe ndero gjithmonë.

**SHQIPËRIA REZISTOI...**

Në një fragment të vogël të librit të Justin Godart shkruhet prej tij: "Hymë në Shkodër, nën vështrimin e rojeve serbe që ruanin, të armatosura lartësitë e Taraboshit që është shqiptar. Në një gjatësi të madhe kufijtë e Shqipërisë u dhunuan dhe aty kishte ende një front shqiptar mbrojtje. Cilido vend, në të tilla kushte, do të zhytej në anarshi dhe do të ligështohej. Dhe, megjithatë, Shqipëria rezistoi. Ajo ka ruajtur rregullin në shtëpi. E plagosur, e lënduar, ajo qëndron e palëkundur, me krenari gjatë shekujve të gjatë të rezistencës së saj, nga papajtueshmëria patriotike që gjithmonë, nuk e ka lejuar atë, veçse të zgjedhë alternativën ndërmjet vdekjes dhe lirisë.

Por, në të vërtetë, është Shqipëria që duhet të akuzojë për t'u thënë Fuqive të Mëdha: "Ju më keni shtypur, ju më keni rrënuar, ju më keni ndarë. Jeni ju që jeni grindur për të coptuar tokën time dhe jeni ju që guxoni të më adresoni qortime!". Ndaj Shqipërisë, Fuqitë e Mëdha përmbushën një vepër të ndershme shlyerjeje. Ato i janë moralisht borxh asaj.

**SHQIPTARËT, VIKTIMA SHEKULLORE**

Justin Godart do të theksonte fort se "Fat i çuditshëm dhe tragjik, shqiptarët, viktima shekullore dhe megjithatë të pazvogëluar nga Perandoria osmane, u trajtuan si subjekte turke nga Fuqitë e Mëdha. Ata që i qëndruan fort sundimit, për të ruajtur zakonet, fenë, gjuhën, racën, së fundi personalitetin e tyre, të ndryshëm nga gjithë të tjerët, Fuqitë e Mëdha e gjenin komode t'i injoronin, qoftë për t'i braktisur, qoftë për t'i rrjepur, qoftë për t'ua shitur atyre që kërkojnë më fort, ose atyre që paguajnë më shtrenjtë në pazarin ndërkombëtar. Askush nuk u qante hallin shqiptarëve. Ata ishin vetëm. Ata nuk ekzistonin.

Më kot qëndruan me një burrëri të pamposhtur, në robërinë turke; aq sa Kostandinopoli nuk guxonte as t'u kërkonte taksa; më kot qeverisen vetën, qëndruan të bashkuar, pa dallime fetare, katolike, ortodokse, myslimane dhe formuan një bllok kombëtar kundër turkut. Nuk duhej t'u mbeteshin as turqve, për të mund t'u ndarë vonë, me pjesën tjetër të perandorisë. Kjo është abc-ja e diplomacisë që praktikohej dhe imponohej dhe do të imponohet akoma sot, ndofta, në qoftë se do të lejohet ta bëjë...

**ÇFARË QORTIMESH MUND T'I BËJNË SHQIPËRISË?**

...nën pushtimin turk, çdo inteligjencë që zgjohej, çdo dëshirë që forcohej, persekutohej dhe syrgjynosej. Kohët e lirisë erdhën? Çfarë mund të bëjë Shqipëria?

Gjatë gjithë rrugës tonë kemi parë shkatërrime. Kush i ka bërë, kemi pyetur? Këtu, na thonë, Greqia; atje Italia; atje Austria; atje Serbia.

Pamë turma të mjeruara burrash dhe grash pa shtëpi, fëmijësh që kanë uri dhe të ftohtë. Nga vijnë, pyetëm? Nga fshatrat e tyre që u plaçkitën dhe u dogjën nga serbët. Në një gjatësi të madhe kufijtë e Shqipërisë u dhunuan...


**Dr. Bajram Ndreu është njeriu që sot flet me heshtjen e tij. Prej katër vitesh ai na mungon, por ky boshllëk nuk ndihet aspak, sepse gjurmët që doktori la pas, shfaqen thuajse çdo ditë, me mbresat, punët dhe veprat e mira që bëri në jetë.**

# **Dr. Bajram Ndreu** *njeriu që flet me heshtjen e tij…!*

*Nga* **DEFRIM METHASANI**

Njerëz të shumtë kishin zënë vend që në mëngjes pranë njësisë vendore të kujdesit të shëndetit Dibër, aty pranë spitalit të qytetit të Peshkopisë, në respekt të një emri të ri që do të stampohej tashmë aty, Dr. Bajram Ndreu. Kryetari i bashkisë Muharrem Rama, kryetari i këshillit të qarkut Hajri Laçi, por edhe drejtues vendor dhe qytetarëishin protagonistë të kësaj dite, ku doktori fliste me heshtjen e tij. Pasi ka përshëndetur, drejtori i kësaj njësie vendore të kujdesit shëndetësor familjarët dhe drejtuesit vendorë kanë zbuluar pllakën ku shkruhet emri i ri i kësaj qendre, Dr. Bajram Ndreu. Me duartrokitje të gjata nga të pranishmit, pllaka është zbuluar dhe aty janë bërë foto të shumta, nga familjarë miq dhe personalitete të shumta që ishin të pranishëm. Post këtij inaugurimi, qindra njerëz të ardhur edhe nga vendlindja e doktorit, por edhe fshatra e qytete të tjera, kanë zënë vend në pallatin e kulturës Peshkopi, i cili është tejmbushur, si shenjë respekti për gjurmët që doktori i la pas. Fillimisht është shfaqur një dokumentar i RTSH i titulluar "Njeriu që flet me heshtjen e tij", kushtuar figurës së respektuar të mjekut humanist dhe njeriut të mirë Bajram Ndreu. Dokumentari evidentonte gjithë jetën e tij që nga vendlindja e deri ditën e ndarjes nga jeta, një jetë që ia dedikoi mjekësisë dhe shëndetit të njerëzve. Më pas në skenë janë ngjitur shumë përfaqësues dhe drejtues të pushtetit vendor, mjekë, miq dhe kolegë , të cilët kanë zbuluar mjaft kujtime e mbresa, por edhe kanë treguar vlerat që e karakterizonin këtë burrë të Palamanit e Ujë e m'Ujës...

Momenti kulminant ka qenë kur kur anëtari i këshillit bashkiak Astrit Ademi dhe kryebashkiaku Muharrem Rama, kanë dorëzuar vendimit e këtij këshilli për vënien e emrit në njësinë e kujdesit shëndetësor familjes se doktorit dhe djalit të tij Arben Ndreu, por edhe drejtorit të këtij institucioni Hasan Manja, i cili ka premtuar se do ta mbante me nder dhe do të kishte një përgjegjësi më shumë për ta mbajtur lart emrin e dr. Bajram Ndreut.



Më pas me këngën e mjekut është bërë mbyllja e këtij takimi që u duk se e riktheu në jetë doktorin edhe pse prej katër vitesh ai na mungon fizikisht.

Gjithsesi ky emër i bukur dhe domethënës do t'i shkojë shumë për shtat kësaj qendre të rëndësishme të shëndetit në Dibër, duke lartësuar më shumë emrin e dr. Bajram Ndreut dhe duke i dhënë më shumë vlerë figurës së pastër dhe humane të mjekut dhe njeriut të mirë të këtij komuniteti.

**KUSH ISHTE BAJRAM NDREU?**

Bajram Ndreu u lind në fshatin Palaman, më 10 maj të vitit 1935. Arsimin fillor e kreu në fshatin e tij të lindjes, ndërsa atë shtatëvjeçar në Sllovë. Si rezultat i aftësive të tij u zgjodh ndër nxënësit më të mirë dhe u dërgua në Shkodër, për të kryer kurset e kualifikimit për mësues. Pasi kreu kurset me sukses, punoi mësues në disa shkolla në Dibër, si në Cerjan, Lugje dhe Vleshë, nga vitet 1951 deri në vitin 1854. Më pas, ai mbushi moshën për ushtar dhe vijoi të kryejë shërbimin ushtarak në repartin 7250 në Durrës. Si djalë i etur për dije, ai u regjistrua në shkollën e mesme të përgjithshme "Naim Frashëri" dhe e mbaroi atë me rezultate të shkëlqyera. Pas mbarimit të shkollës, në vitet 1960-1965, kreu studimet e larta për mjekësi dhe u diplomua Mjek i Përgjithshëm. Ai njihte edhe gjuhët e huaja, si rusisht dhe anglisht. Me mbarimin e studimeve në Fakultetin e Mjekësisë, punoi për më shumë se një dekadë, deri në vitin 1975 në spitalin e Sllovës, duke qenë edhe drejtues i tij. Ndërkaq, që nga vitet 1976 e deri në vitin 1983, ai u ngrit në detyrë dhe emërohet drejtor i spitalit të Peshkopisë, si vlerësim për punën e palodhur, nivelin dhe aftësitë që shpalosi në Sllovë. Më pas, nga viti 1983 e deri në vitin 2004, ai punon drejtor i Drejtorisë së Kualifikimit dhe Edukimit Shëndetësor. Kujtojmë faktin që Bajram Ndreu është zgjedhur edhe deputet në legjislaturën e 7-të të Kuvendit Popullor në vitet 1970-1974.

Për vlerat e spikatura dhe rezultatet e larta të arritura në vite, si shërbëtor i komunitetit dhe drejtues i institucioneve shëndetësore, ai është vlerësuar edhe nga Presidiumi i Kuvendit Popullor i kohës me tituj dhe medaljet përkatëse.

Gjatë gjithë jetës së tij, doktor Bajram Ndreu është karakterizuar nga përgjegjësia dhe vlerat, puna, korrektesa, urtësia, pa mohuar edhe aftësitë e mëdha profesionale. Ai ishte dhe mbetet një prind, mik dhe shok model, duke lënë pas gjurmë kujtese të pashlyera në çdo vend, fshat apo qytet ku punoi me përkushtim dhe devocionin e tij të pashoq.

Vendimi i Këshillit Bashkiak Dibër, për t'i vendosur emrin njësisë vendore të kujdesit shëndetësor, është një nderim i merituar, për emrin e tij dhe kontributin e madh që dha zoti Bajram Ndreu në fushën e mjekësisë.



# Nderim për **tre dëshmorët** e Tërnovës

*Nga* **EDUART RAMÇI**

**TËRNOVA, FSHATI QË U SHËNDRRUA I GJITHI NË BAZË LUFTE DHE QË I DHA ATDHEUT 42 PARTIZANË DHE 3 DËSHMORË**

Tërnova ndodhet në brëndësi të tokës shqiptare dhe të Dibrës, ajo mbështetet në pjesën qendrore të Shqipërisë Veriore, me territor që shtrihet përgjatë krahut të majtë të Lumit të Okshtunit, që nga Zerqani pothuajse në Verilindje, Kaptina e Martaneshit në Perëndim.

Në kuptimin figurativ, ajo është zemra e maleve të Bulqizës, Librazhdit, Martaneshit, Çermenikës dhe për pak orë duke ecur përmes pyjeve rë dendur e të bukur shkon në këmbë në Tiranë.

Në kuptimin ushtarak, Tërnova është pararoja e Tiranës, mburoja e saj. Jo më kot, këtu kanë qenë përqëndruar të gjitha vendkomandat dhe pikat e vrojtimit të ushtrive mbrojtëse shqiptare kundër sllavëve, turqve, italianëve e gjermanëve kur kanë sulmuar në drejtimin Dibër e Madhe – Tiranë. Nëpërmjet Tërnovës shtabet partizane kalonin nga Tirana për në Dibër dhe anasjelltas nga Dibra për në Tiranë. Haxhi Lleshi në kujtimet e tij shkruan me imtësi dhe dashuri për pritjen dhe përcjelljen që i ka bërë populli i Tërnovës.

**DËSHMORË TË LUFTËS**

**HALIL HAMZA HASA (1900 – 1943)**

**Lil**ë **Hasa, nga Tërnova e Dibrës , vrarë në Luftën e Peshkopisë, tetor 1943**

Halil Hasa ka lindur në Tërnovë të Dibrës në vitin 1900.

Atë e kanë thirrur Lilë. Halili ndodhej në Durrës për të punuar për të siguruar bukën e gojës për vehte dhe për fëmijët me 7 prill 1939 kur pushtuesit italianë zbarkuan. Ai së bashku me Isak Metalinë nga Strikçani luftoi përkrah Mujo Ulqinakut. Lajmin për vrasjen e Isakut në Dibër e solli Lila. *(Ushtima e Maleve , 12 janar 1989, E. Zeneli)*



Në fund të vitit 1941 tej Kroi i Mitkut në Tërnovë ai mori pjesë në një mbledhje së bashku me Nazmi Rushititn, Irfan Hajrullain dhe Demir Gashin dhe që kjo ditë ai ra në kontakt me lëvizjen antifashiste nacional çlirimtare. Bashkë me Asllan Zenelin nga Tërnova, mësues në Lejçan u rreshtuan në Çetën e Gollobordës dhe të Batalionit të Dibrës. Mori pjesë në Luftën e I të Dibrës së Madhe dhe në Luftën e Peshkopisë. Bashkëluftëtari i tij, i plagosur në të njëjtën betejë, Esat Cami tregon:

«Të nesërmen, pasi u takuam me Shtabin Partizan të Qendrës së Peshkopisë, çeta u caktua në Dobrovë dhe qëndroi aty për 5-6 ditë.

Më pas u dha u dha urdhëri, që çeta të kalojë në Staravec.

Në të gdhirë të datës 17 tetor 1043, filloi pushka nga forcat mercenare. Çeta jonë e Gollobordës, megjithëse ishte në një terren të hapur, bëri shumë rezistencë, për të mbrojtur qytetin. Çetës nuk i erdhi asnjë nga çetat e tjera në ndihmë, kështu që u dëmtua shumë.

Në këto luftime u plagos rëndë komandanti, Ahmet Cami si dhe partizanët Hidër Manjani, Esat Cami, Bajram Toçi, Asllan Zeneli, Ibrahim Lumi. U vra në vend mitralieri italian Salvadore.

Pasi u tërhoqën të plagosurit, shkuam tek shtëpia e Koleceve, për t'u strehuar, tregon ish partizani i plagosur në këto luftime Esat Cami. Por aty erdhen krerët e mercenarëve si Halil Alia, Beqir Sina, Selim Kaloshi. Erdhën për të na ndihmuar menjëherë Vehap Kadria, Shaban Kadria, Arif Kadria dhe Sabri Kadria nga Dohoshishti si dhe djali i Muharrem Bajraktarit. Halil Alia i kërkoi misionit anglez, për t'i çuar në spitalin e Dibrës së Madhe, meqenëse në Peshkopi nuk kishte mjek.

Në mbrëmje erdhi një makinë dhe një anglez na shoqëroi deri në spitalin e Dibrës së Madhe. Nga Dibra e Madhe, Ahmeti, që të nesërmen është dërguar për në spitalin e Tiranës dhe ka vdekur me 30 tetor të vitit 1943 në spital nga plagët që mori në luftën e Peshkopisë. Ndërsa Halil Hasa ka vdekur që atë mbrëmje në spitalin e Dibrës së Madhe.

"Partizani Halil Hasa, që u plagos në luftën e Peshkopisë ndërroi jetë me 28 tetor 1943 në spitalin e këtushëm (Dibrës së Madhe), shkruan Haki Stërmilli në ditarin e tij të luftës. Është *shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin Nr 50, datë 30.06.1972 të këshillit popullor Dibër*

**FEJZULLA SULEJMAN GJIKA**, (1924 – 1945) nga Tërnova, rënë në Kalanë e Dodës

Fejzullai u lind në fshatin Tërnovë të Dibrës në vitin 1924. I rritur në një familje të varfër, por me tradita atdhetare ai përqafoi dhe u përfshi në lëvizjen antifashiste nacionalçlirimtare, në Brigadën e 18 Sulmuese. Nga fshati Tërnovë u përfshinë shumë djem të rinj në këtë luftë. Ata u mobilizuan në maj të vitit 1943 në Çetën e Gollobordës, të komanduar nga Ahmet Cami, më pas me 26 korrik 1943 në batalionin e Dibrës, të formuar në Gjoricë dhe të komanduar nga Haxhi Lleshi.



Pas mbarimit të luftës, Fejza nuk e lëshoi armën nga krahu. Ai u rreshtua në Forcat e Mbrojtjes së Popullit. Fejzullai ishte vetëm 21 vjeç. Kishte sy të mprehtë shqiponje dhe trup të bëshëm. Çdo detyrë të ngarkuar e kryente me përpikmëri. Kapelen akoma nuk e kishte hequr, megjithëse lufta kishte mbaruar që në fund të dhjetorit 1944.*(E.Zeneli, R.Uka, Ushtima e Maleve, 11 tetor 1986)*

Kohë më vonë Fejzullain e dërguan në zonën e Kalasë së Dodës. Sipas të dhënave të marra banditët do të lëviznin në drejtim të Shishtavecit të Kukësit dhe të Prizrenit. Në këtë detyrë që ju ngarkua Fejzullai, në përbërje të skuadrës së tij, mbeti i vrarë në përpjekje me bandat. Ishte fundi i viti 1945. Ishte vetëm 21 vjeç.

*(Dëshmor i Atdheut me vendimin Nr 72, datë 23.05.1978 të këshillit popullor Dibër*

**XHELADIN AVDI MURATI**

Lindur në Tërnovë në vitin 1927 Rënë në Lushnjë në vitin 1946

Lindur në Tërnovë në vitin 1923 në një familje të varfër që nuk siguronte as bukën e gojës, pasi toka ishte e pakët dhe tereni malor.



Ishte kjo arsyeja që Xheladini, ndonëse i ri u detyrua të largohej nga fshati për të siguruar bukën e gojës për vehte dhe për familjen në Shijak dhe në vende të tjera të Shqipërisë së mesme si usta. . (Heronj të heshtur, Vëllimi II, Faqe 534). Në qershor të vitit 1944 Xheladini u bashkua me Batalionin e Martaneshit dhe në gusht 1944 me Br. XVIII. *(E.Zeneli, R.Uka, Ushtima e Maleve 27 dhjetor 1986)*

I arrestuar nga nazistët për t'u dërguar në Kampin e Prishtinës, aty ku u ekzekutuan 104 partizanë shqiptarë, por shpëtuar nga shokët e tij të luftës.

Pas çlirimit ai u rreshtua me Divizionin e Mbrojtjes së Popullit në brigadën që vepronte në zonën e Lushnjës. Rënë në Lushnjë në vitin 1946.

Është *shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin Nr 50, datë 30.06.1972 të këshillit popullor Dibër.*

**Ostreni mblodhi mijëra njerëz që shijuan këngën, vallen, traditën, veshjet dhe sportin...**

# **Golloborda,** *aty ku mundja kthehet në festë!*

*Nga* **DEFRIM METHASANI**

Mjafton një ditë e organizuar bukur, që Golloborda të shpalosë vlerat e saj artistike dhe sportive, veçmas në sportin e traditës, atë të mundjes, që thuajse ka kampion në çdo shtëpi. Prej kaq shumë vitesh, pikërisht në qendër të fshatit Ostren i Madh, qindra njerëz mblidhen për të festuar dhe për t'u ndeshur në tapetin e jonxhës, duke garuar për të fituar më i forti. Bashkia e Bulqizës, Shoqata "Golloborda" dhe Shoqata Kombëtare e Mundjes janë trioja që merret me këtë organizim fantastik, që mbledh kaq shumë njerëz, aq shumë saqë kjo trevë nuk i ka parë ndonjëherë.

### FESTA, STARTI DHE CEREMONIA E SAJ

Fillimisht është muzika e bukur e krahinës së Gollobordës dhe veshjet karakteristike që të joshin me magjinë që ofrojnë, duke shtuar kureshtarët të ardhur edhe nga jashtë Bulqize e Dibre, deri në Tiranë dhe rrethe. Vallet e vajzave janë një tregues se kjo trevë ka një gen artistik që josh me pamjet dhe melodité e saj, duke ftuar në oborrin e shkollës 'Elez Koçi' edhe djem dhe vajza jashtë shkollës apo grupit artistik. Ceremonia pranë shkollës lauron disa nga ish mundësit kampionë, ndërsa sipas traditës banorët e zonës dhe të pranishmit i përshëndesin, disa prej organizatorëve dhe të ftuarve specialë, si kryetari i bashkisë Melaim Damzi, Presidenti i KOKSH Viron Bezhani, kryetari i Shoqatës "Golloborda" Razi Rama, drejtori i shkollës Banush Koçi dhe Xhelil Cibaku, sekretar i Shoqatës Kombëtare të Mundjes, njeheresh edhe organizator dhe inicues prej kaq vitesh. Ndërkaq që komisioni i festës ka lauruar disa prej emrave të njohur të mundjes së Gollobordës e njohur kudo në Shqipëri, si Fehmi Sejdini dhe Fiqiri Rama, dy ish kampion dhe mjeshtra të shquar ëe këtij sporti.. Në këtë podium, ka vend edhe për një djal kampion të kësaj zone në mundje, si Skënder Rama, që premoin fituesit dhe është njëri prej donatorëve dhe mbështetës i kësaj feste dhe shoqatës sportive të mundjes me emrin e zonës 'Golloborda". Një tjetër biznesmen i sukseshëm dhe dashamirës për këtë ngjarje të bukur sportive, është edhe Përparim Dauti i cili edhe pse jeton në Greqi, vjen çdo vit dhe jep kontributin e tij modest.

Më pas ngjitemi në katin e dytë të shkollës, aty ku Duro Ibrahimi, etnograf i njohur nga kjo zonë, sjell mundësinë për të parë nga afër të gjitha llojet e veshjeve kombëtare që ajo zonë i vesh, veëmas në raste festash, dasmash e gëzimesh. Eshtë një bashkëpunim interesant edhe në këtë fushë mes bashkisë Bulqizë dhe shoqatës "Golloborda", për ta pasuruar atmosferën e këasaj feste të bukur.



### PAK HISTORI

Razi Rama është kryetari i shoqatës sportive të mundjes "Golloborda", njëherësh kryeorganizator i kësaj kupe dhe feste sportive. Ai rrëfen se mundja në këtë trevë ka shumë histori. Mjfton një fakt domthës, kur kujton që garat e para kanë nisur në vitin 1954, madje është bërë edhe kampionati i parë i mundjes. Ostreni, por edhe fshatrat e tjerë, kanë nxjerrë kampion dhe emra të shquar, të njohur brebda dhe jashtë vendit. Dasamt sipas tij, kanë qënë pikënisjet e sportit të mundjes, ku mateshin djemt e fshatit, apo ato që vinin nga fshatrat dhe zonat e tjera. Keshtu kjo u kthye në traditë dhe tashmë prej pesë vitesh, organizohet kjo festë e bukur, ku edhe gjyqtarët vijnë nga Tirana, apo Maqedonia e Kospova.

### NDESHJET DHE FITUESIT E TYRE

Ndërkaq që zbresim sërish poshtë dhe shkojmë tek arena ose amfiteatri sportiv i mundjes, aty ku gara ka filluar e ashpër, sepse nuk është thjesht një dash që fituesi e bën pronë të tij, por emri dhe dinjiteti i kësaj zone që shquhet për djem të fortë dhe kampionë. Të duket se je në një amfiteatër sportiv, ku mijra njerëz kanë mbushur atë, duke shuar kureshtjen për më të fortin dhe më të mirin. Thuajse e gjithë zona është aty, pranë dhe rreth tapetit të gjelbërt.

Në fillim janë ndeshur moshat e reja deri në 15 vjeç, që kanë përcaktuar edhe fituesit e parë të kësaj dite. Ai quhet Vilson Tola, një djal i fortë dhe i përgatitur që ka mundur në finale Klodjan Karasanin.

Shiu që ka nisur të bjerë aspak nuk e pengon ecurinë e garës e cila ka përmasa të jashtëzakonshme. Pasi janë ndeshur moshat 15 vjeç, adrenalina rritet kur sheh të dalin në

**Kënga e vallja s'kishin fund në një fshat piktoresk si Ostreni, një vend që fliste me gjuhën e sportit të bukur dhe burrëror të mundjes. Kupa, medaljet, dhurata, por mbi të gjitha dashi në qafë për fituesin, ishin simbolika më e veçantë e një djali kampion, që me meritë bëri për vete këtë sukses ...**

fushën me jonxhë edhe djemtë 20 vjeçarë. Tashmë numri i tyre është i madh dhe po e tillë është edhe konkurenca. Ndeshjet kanë zgjatur më shume, sepse lufta sportive bëhet më e ashpër dhe çiftet janë tepër të fortë. Tashmë kanë ardhur edhe djem nga një fshat i Maqedonisë së Veriut, por që është kufitar me fshatrat e Gollobordës, pikërisht nga Xhepishti. Pas një beteje të gjatë dhe lufte të fortë sportive, është shpallur edhe këtu fituesi që me meritë ka bërë për vete certifikatën e fituesit, peshqirin, por edhe një stimul material që organizatorët kishin menduar ta dhuronin. Fituesi është Ilir Osmani i cili ka arritur ta bëj për vete titullin kampion për 20 vjeçarët, pasi ka mundur në finale rivalin e tij Ervin Karasanin.

Më pas vjen ora e madhe e atyre që luftojnë si luanë në tapetin e blertë. Dashi qëndron i lidhur në cep të tapetit, ndërsa qindra njerëz thërrasin në kor emrat e konkurentëve. Ndeshjet për të rritur zgjasin shumë, madje ka raste që duhet ti thërrasish në ndihmë shortit, ose mirkuptimit mes konkurenteve. Ka edhe kundërtshi..., sepse sporti është edhe objektiv, pasterti, ndershmëri, gëzim, por edhe dështim, që pakush e pranon... Pas shumë ndeshjesh të forta, debatesh, por edhe ovacionesh, djali nga Trebishti Ardit Kanxha, nip në Ostren, është shpallur fitues, pasi ka hedhur në tuç kundërshtarin nga Xhepishti edhe ky një mundës shumë i fortë, Qamil Dileski. Ai ka merituar bashkë me kupën, dhuratat, medaljen dhe peshqirin edhe dashin që sipas zakonit, shkon si peshqesh për atë që fiton dhe shpallet më i miri.

### NË VEND TË MBYLLJES...

Kënga e vallja s'kishin fund, ashtu si atmosfera brilante që pushtoi atë fshat piktoresk si Ostreni, një vend që fliste me gjuhën e sportit të bukur dhe burrëror të mundjes. Kupa, medaljet, dhurata, por mbi të gjitha dashi në qafë për fituesin, ishin simbolika më e veçantë e një djali kampion, që me meritë bëri për vete këtë sukses që ishte i pari në jetën e tij. Kamerat e shumta dhe fotoreporterët kanë fiksuar një ditë për tu mbajtur mend gjatë, ditë e cila u kthye në një festë të madhe për banorët e atyre anëve, por edhe miqtë e shumtë të Gollobordës. Ajo ishte një ditë për të mos e harruar, por edhe për të korrigjuar disa detaje që mund të përmirësojnë akoma më shumë këtë organizim, që duhet të ketë edhe përmasa kombëtare.

Gjithsesi, organizatorët dhe donatorët kanë meritën e madhe që Gollobordës i rikthyen emrin e mirë dhe një ditë që ata ta gëzojnë përmes sportit të mundjes, një sport ky tradicional dhe burrëror, që i bëri të njohur kudo në Dibër, Bulqizë, por edhe në Shqipëri dhe në botë.

### Thanë per festen:

**XHELIL CIBAKU- SEKRETAR I SHOQATES KOMBETARE TE MUNDJES**

*Për të pestin vit radhazi organizohet një kupë e tillë me nismën e Shoqatës Kombëtare, asaj "Gollobrda" dhe mbështetjen e bashkisë. Përmendim angazhimin e Shoqatës sportive "Golloborda", shkollës së mesme Ostren dhe shkollave 9 vjeçare të zonës së Gollobordës për pjesëmarrjen masive të të gjithë nxënësve, si dhe gjithë banorëve në emigracion në vendet e Europës. Për t'u theksuar është fakti që kanë ardhur sportistë veteranë nga ishujt e Greqisë dhe Gjermania, konkurrentë për të fituar çmimin. E ardhmja është e konsoliduar. Ky aktivitet nuk është vetëm sportiv, por edhe kulturor, përmes valleve, këngëve patriotike shqiptare, ekspozitë me veshje tradicionale, ekspozitë të punimeve me dru dhe gurë dhe muzeu historik i shkollës me 600 foto të të gjithë mundësve dibranë dhe të zonës në vite. Fituesi mori jo vetëm dashin, por edhe flamurin kombëtar, që do të qëndrojë për një vit në shtëpinë e fituesit Ardit Kanxha, derisa të shpallet fituesi i radhës. Vitin që vjen do të ketë edhe më shumë pjesëmarrje dhe ky aktivitet do të ketë edhe ngjyrime turistike. Dua të përgëzoj djem të tillë si Skënder Rama, mbështetës i një organizimi të tillë.*







**Në altarin e shenjtë të atdheut, në altarin e lirise dhe nderit të kombit, shtohet edhe dëshmori më i ri Klodian Tanushi, i cili dha jetën, duke nderuar e lëshuar rreze trimërie, guximi në krye të detyrës...**

# Dëshmori Klodian Tanushi

*Nga* **SELMAN MËZIU**

Është në nderin e çdo shqiptari kudo ku jeton e punon të njoh nga afër jetën, veprimtarinë jetsore të dëshmorëve të tijë, që dhanë jetën në lulëzimin e moshës, për çështjen e atdheut apo të popujve të ndryshëm të botës.

Një i tillë, që shpalosi trimërinë, mençurinë e devotshmërin e tijë ishte edhe major Klodian Tanushi, i cili lindi me 31 tetor 1980 në lagjen Tanushe të Fushë - Muhurrit të Dibrës së vogël. Shkollën fillore dhe tetëvjeçare i mbaroi shkëlqyer në vendlindjen e tij, ku laget nga ujrat e kthjellta të Drinit të Zi dhe nga lumi Murra.

Ai vazhdon studimet në shkollën ''Nazmi Rushiti,, në qytetin e Peshkopisënë profilin "Motorist xhenerik" ku nuk munguan rezultatet shumë të mira. Vullneti për të studiuar, deshira për të ndjekur udhën e babait Basriut, Klodiani ndjek studimet e lartanë Akademinë Ushtarake ''Skënderbej,, nga viti 2000 e përfunduar ato në vitin 2003, duke u diplomuar oficer.

Familja e tij ndjeu gëzimin e pafundëm dhe të lumnuem sa s'ka kufi, martojn Klodin fëmijën e tyre të parë, i cili tani ka tre fëmijë, dy djem përkatësisht 14 dhe 11 vjeç dhe vajzën pesëmbëdhjet muajshe.

Puna e tij këmbëngulse, dashuria e tij për profesionin, modestia, korrektësia në detyra të ndryshme dhe duke zbatuar një disiplinë të fort, ai arriti qëme urdhër nr.9628 datë 18.09.2003 të marrë gradën e "Nëntogerit" ndërsa. Veçse trevjet më vonë pikërisht në vitin 2006 gradohet "Toger", ndërsa në vitin 2010 merr gradën e "Kapitenit" dhe së fundi në vitin 2017 ka marrë gradën e "Majorrit".

Gjatë karrjerës së tij ushtarake, Klodian Tanushi ka kryer detyra të ndryshme, me plotë përgjegjësi dhe përkushtim, me ndërgjegje dhe kultur profesionale si Komandant Toge, Komandant Kompanie, Shef Seksioni, Specialist Operacionesh. Aktualisht kryente detyrën si Komandant i Togës së pare të EOD. Por ky ushtarak shembullor, pasuronte njohurit e tija në fushën ushtarake, jo vetëm duke studiuar individualisht por duke kryer edhe një seri kursesh si atë të EOD Niveli I-rë "Për asgjesimin e municioneve me eksploziv" si dhe në kursin "EUFOR Mine Aëareness Instructor Course".

Nuk kanë munguar vlerësimet e punës së tij si ushtarak shembullor, përshembull me edaljen e "Karrierës" nga Komandanti i Forcës. Përsëri me medaljen e "Shërbimit" nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, në vazhdim me medaljen e Shërbimi në Mision jashtë vendit,, dhe se fundi me medaljen "Për pjesëmarrje në shërbime ndërkombëtare" nga Ministri i Mbrojtjes.

Por veprimtaria e tij në kryerjen e detyrave të ndryshme ushtarake, virtytet e tij të shkëlqyera prej dibrani trim, të zgjuar e gjakftohtë në gjykime e veprimet ushtarake si dhe aftësitë e tija shkencore e profesionale në artin ushtarak, e shtyne Ministrinë e Mbrojtjes që më 20 dhjetor 2018 t'a dërgoj Major Klodian Tanushin me mision në ''Operacionin Ushtarak të NATO-s,, në Riga, Kryeqytetin e e Republikes së Letonisë, që shtrihet në europën veri - lindore, në përbërje të Grup-Batalionit kanadez me detyrën e Komandantit të Kontigjentit shqiptar dhe si përfaqësues i lartë ushtarak, për gjysëm viti.

Por ja që në krye të detyrës duke çminuar një minë luftarake me datën 6 maji 2019 bie në krye të detyrës, ushtarakja tropojane Zarife Hasanaj, plagoset me copra predhash në kokë, Major Klodiani, ndërsa lëndohet ushari Julian Kapaj.



Klodiani shtrohet urgjentisht në "Riga eastUniversity hospital, në Letoni. Pas një operacioni prej pesë orësh dhe nje kohëzgjatje prej katër ditësh në luftën e egër, të dhimbëshme, të pabarabart me vdekjen, Majori Tanushaj, mbyll sytë përgjithmone ditën e premte në oren 21 e 2'' të dates 10 maji. Duke lanun të rregjistruar mesazhin e tijë të fundit në zyrën e tij, ku deklaron:''Misioni shqiptar është i përbërë nga 21 persona, të cilët sipas tij kryejnë veprimtari të ndryshme në Letoni.,,

Ndërsa vjen kumti i përfaqeuesve të lart të traktatit ushtarak atlantik (NATO) të cilët shkruajn:''Humbja e major Tanushit ditën e djeshme ishte një dhimbje e madhe, se për Aleancën ka vdekur një "vëlla nën armë".Ndërsa flamuri ulet në gjysëm shtizenë nëaleancës atlantike në Bruksel të Belgjikës .

Ndërsa me 15 maji 2019 mbrriti me avion ushtarak në airoportin ''Nenë Tereza,, arkivoli me trupin e major Klodian Tanushit. Ai ishte mbuluar me flamurin kombëtar ku u prit nga të afermit familiaret dhe ushtaraket sidhe Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka

Ndërkohë bëhet ditur në te gjitha rrjetet e radiove e televizioneve: ''Këshilli i Ministrave ka nderuar major Klodian Tanushin, i cili ra në krye të detyrës gjatë misionit të NATO në Letoni, duke e shpallur ditën e enjte, datë 16 maj 2019, ditë zie kombëtare.,, Ndërsa Komisioni Qendror i Statutit "Dëshmor i Atdheut", nën drejtimin e ministres Olta Xhaçka, e ka shpallur major Klodian Tanushin, "Dëshmor i Atdheut".

Në altarin e shejtë të atdheut, në altarin e lirise dhe nderit të kombit, shtohet edhe dëshmori më i ri Klodian Tanushi i cili dha jetën në kryqytetin e Letonisë, duke nderuar e lëshuar rreze trimërie, guximi në krye të detyrës, në lulen e jetës, me uniformën ushtarake, me gradën e majorit e detyrën e komandantit.



**Veprimtaria e tij në kryerjen e detyrave të ndryshme ushtarake, virtytet e tij të shkëlqyera prej dibrani trim, të zgjuar e gjakftohtë në gjykime e veprimet ushtarake si dhe aftësitë e tija shkencore e profesionale në artin ushtarak, e shtynë Ministrinë e Mbrojtjes që më 20 dhjetor 2018 ta dërgojë major Klodian Tanushin me mision në ''Operacionin Ushtarak të NATO-s,, në Riga, me detyrën e Komandantit të Kontigjentit shqiptar dhe si përfaqësues i lartë ushtarak, për gjysmë viti.**

## Përse kështu Klodian trimi?

*Rrënjët thelle në dheun tim i lëshove. Nga parmenda tek plugu e arti i gjyleve të topave kalove. U mëkove dhe me bukën e misrit të thekur në prushin e druve. E ngjyve atë në tamlin prej deles së mjelun. I rritun bashkë me lisat, ahet, manat, qërshitë, arrat e mollët, misrin gjushtak u ngrohe, u ushqeve dhe ndjeve aromën e shijen e tyre. Keto ishin peisazhet e ngrohta joshese e jetëdhuruese të Muhurrit të Dibrës. Etjen e shuajte me ujët e burimeve të ftohta ngado ku kalove natyrës bujare te krahines tone reliev butësisht të thyeshme. I parë në pasqyrën e ujrave të Drinit e Murrës, i freskuar e pushura në brigjet ranore të tyre u rrite i fortë fizikisht i burrnuem për nga zgjusrsia. E ndaj mendërisht e me trimëri u gatove në kohë e hapsirë në mushtën e natyrës e kulturës të vendlindjes. Po, po, aty ku malet hijeranda e kryelarta përshëndesin njëra me tjetrën në perjetësi, por, duke ndërruar ngjyrat e rritun djelmëri trima, me plotë kulturë e trup fuqishëm.*

*Hodhe farën e vazhdimësisë ashtu natyrshëm me martsën me plotë gëzim, lumturi çifti, ngrohtësi shpirti të prindërve të tu Basriut e Kimetes. Dy djemt dhe vajzën, babës, nanës e gruas amanet ua bëre, për të vazhduar misionin tand diku larg truallit të lindjes e mëmedheut. Por për të hedhur hapat kështu larg duhesh të shkollohesh e të ishe shembulli i shkëlqyer. Pra, u gatove me shkollen''Motorist xhenerik,, në qytetin e Peshkopisë e më pas lartësive të dijes me vullnet e zjarrmi u ngjite. Në Akademinë Ushtarake ''Skënderbej,, veten e farkëtove, e kulturove profesionalisht. E përsëri rriteshin djemte e vajza e babai hidhte me plotë dinjitet shtatin e dijes të kulturës si një ushtaraku shembullor.*

*Ngjitje të zbukuruara nga sjelljet e edukata, zhdërvjelltësia, nga mençuria e trimëria, nga korrekteia e devotshmeria shkallët e karrjerës nga nëntoger, në toger, nga kapiten e së fundi major t'i dhane me plotë meritë në fushën plotë yje të praktikës e teorisë. Muhurri krenohesh bashkë me Dibrën me komandantin e kontingjentit shqiptar në misionin e NATO "Enhanced Forward Presence", por, tanima diku larg, po larg fëmijeve, gruas, babait nanës e të afërmive, ne veri lindje të europës në Lituani.*

*Rrezatimet e tua në veprimet ushtarake, mjeshtria juaj, qëndrimi i paepuri e thërrisnin, ushtarakun si Major Klodianin e beteja të reja me punë intensive, por, gjithmonë të kujdesshme e me nerva të tendosura. Dhe ja që çminim e një mine, në një bazë ushtarake në Letoni i shkaktoi humbjen e jetës ushtarakes, trimëreshës tropojane Zarife Muharrem Hasanaj. Ndërsa coprat e minës plagosin në kokë muhurrakun Klodian Tanushi. Ndërhyrja kirurgjikale e cila zgjati përmbi 5 orë dha pak shpresa. Ato copeza kishin hyre thellë, rrezikshëm, pamëshirshëm, në pjesët e ndryshme të kokës së Majorit Klodian Tanushi përgjatë katër ditëve. Dhe ja si një mjergull e zezë përhapet lajmi i trishtueshëm se sonte me datën 10 maji 2019 rreth orës 21 të natës, majori trim nuk i përballoi dhimbjet e coprave të predhave dhe ndërhyrjen kirurgjikale të mjekëve. Ai mbeti pishtar i shpëtimit të popullit lituanez nga plagosjet, vrasjet nga fatkeqësit e armëve vdekje prurëse.*

*Majori, komandanti, ushtaraku shembullor Klodian Tanushi, la pas femijët, gruan, prindërit të afërmit me zemra e shpirtëra të coptuara nga humbja e parakohshme. La pas tre yje që do të rezatojne dituri, shembëlltyren e vyrtyteve të një babai që luftoi pa reshtur me sakrefica të panumurta, për të patur një familje shembullore si dhe me vetmohim, dije, kulturë, shkencë për të mbrojtur atdheun e vetë, biles për të shpëtuar jetën e mbrojtur popujt e tjerë.*

*Ndërsa banorët e Muhurrit dhe të kudondodhurit, do të ruajn fort si një pishtar dritëlëshues birin e tyre Klodianin, që ngriti ne maja të reja trimërinë, heroizmin, zgjuarsinë, pasionin e devotshmërine ndaj punës e detyrave të popullit të krahinës së muhurrit të Dibrës në pergjithësii dhe të shqiptareve kudo anekand atdheut dhe kudo që janë.*

*S.Meziu*

përkujtim

**Jeta e Qemal Xhafës ishte jetë me punë të frytshme e me përpjekje të jashtëzakonshme në shërbim të familjes, të detyrave profesionale në shërbim të qytetit...**

# Mbetesh fisnik dhe madhështor në kujtesën tonë

*Nga* **QERAM LLESHI**

Ndarja e papritur nga jeta e zotëri Qemal Xhafës më befasoi, më shqetësoi e më la një peng të parrëfyer nga ajo ditë që lajmin e mora larg, në Itali. Lajmi i hidhur më preku në shpirt. Ishte lajm për vdekjen e qytetarit tonë më të respektuar, i cili me punën dhe sjelljen më korrekte dhe më shembullore, me karakterin e fortë edhe me modestinë njerëzore, na impononte besim dhe respekt, na jepte shembullin më të mirë se si duhet të jetë një familjar e si duhet të jetë një profesionist në detyrën e tij, si duhet të jetë një intelektual që merr detyrat me përgjegjësi të lartë qytetare dhe kombëtare, siç ishte detyra e drejtuesit të partisë së parë demokratike dhe detyra e kryetarit të Komunës së Dibrës, në ditët e vështira të viteve '90, në një kohë që pasonte nga një e kaluar e rëndë për qytetarin shqiptar.

Kalojnë ditët, ecën koha me ritmin e saj të pandalshëm dhe ja ndahemi nga njerëzit e dashur. Ndarje e papritur dhe e dhimbshme. Familja humbi kryefamiljarin e saj të dashur e të shtrenjtë dhe mbarë qyteti intelektualin dhe veprimtarin e shquar të tij. Të humbësh babanë, të humbësh bashkëshortin, të humbësh vëllanë e madh, që pas babait ju kishin busull në jetën familjare, të humbësh mikun e shtrenjtë e të nderuar, intelektualin dhe veprimtarin e palëkundshëm për lirinë e prosperitetin, për të drejtat tona kombëtare të mohuara nga regjimet diktatoriale, është një humbje e pakompensueshme jo vetëm familjare, por edhe mbarëqytetare.

Jeta e Qemal Xhafës ishte jetë me punë të frytshme e me përpjekje të jashtëzakonshme në shërbim të familjes, të detyrave profesionale në shërbim të qytetit, jetë me drama të dhimbshme, me sfida e përpjekje, me suksese e me mundime, jetë që ka për sinonim nderin dhe dinjitetin e njeriut të papërkulur në rrugën e idealeve. Ajo nisi me fëmijërinë, kur prindërit u vendosen në pronat e tyre në fshatin Sollokiq, buzë Drinit. Familja Xhafa, pas mbylljes së kufirit me Shqipërinë, u detyrua të ndahet nga pjesa tjetër e trungut familjar për t'u vendosur në pronat e tyre në anën tjetër të kufirit. Kufiri në atë kohë sillte shumë mundime. Të jetoje në fshatrat kufitare në atë kohë nuk ishte e lehtë. Ishte një jetë me trauma, me kufizime, me regjime të rrepta kufitare. Por, edhe në këto kushte, derisa u vendosët në qytet, familja i mbijetoi vështirësive. Ajo u vlerësua për bujarinë, solidaritetin dhe harmoninë ndërvllazërore dhe fqinjësore që kultivoi babai i tij, Ruzhdiu, burrë i shkolluar dhe nëna Hamdie, një grua e edukuar dhe fisnike, si dhe anëtarët tjerë të familjes.

Jeta ka gëzimet, sukseset, por ka dhe momentin e hidhur të ndarjes, pas së cilës mbesin të pavdekshme kujtimet për veprat që lë pas, veprat që mbeten për brezat në vijim. Kanë kaluar disa javë e do të kalojnë muaj e vite e ju do të jetoni përjetësisht në zemrat tona. Do të jetoni dhe do të kujtoheni me krenari. Me dhembjen në shpirt të familjes, të bashkëshortes, zonjës Shadije, të vajzave Valbona dhe Ulumbijes, të vëllezërve Bardhylit, Muharemit, Bajramit, Shpëtimit, Qaniut dhe Shkëlqimit, motrës Gëzime, nipërve dhe mbesave e të gjithë të afërmve tjerë, me dhembjen e miqve, shokëve dhe qytetarëve të Dibrës do të jetojë edhe krenaria e për shemullin tuaj




**Një shpirt të tillë madhështor e pate dhe ruajte në jetë mik i nderuar. Qëndrimi i juaj, durimi dhe mbizotërim i dhembjes mbetet i veçantë. Ky qëndrim burrëror më kujton një varg të poetit të njohur Azem shkreli kushtuar vdekjes së malësorit, kur thotë: "Asnjë lot asnjë/ se ja shteroni krojet". Këto kroje të pashteruara për ju ishin vajzat, nipërit e mbesat, vllezërit dhe motra me të cilët jetoje dhe të cilët i deshe dhe i mbështete në të gjitha çastet e jetës**

të përkryer si familjar, si profesionist, si veprimtar politik dhe si atdhetar i veçantë në ditë të vështira për kombin tonë. Do të mbeten e do të nguliten në kujtesë angazhimet e tuaja me shokë për t'ju bashkuar nismës së intelektualëve shqiptarë në krijimin e partisë së parë demokratike të shqiptarëve në Maqedoni, Partinë e Prosperitetit Demokratik, e cila ngriti zërin kundër politikës diskriminuese të pushtetit maqedonas dhe luftoi fuqishëm për liri e të drejta kombëtare. Ato vite kthesash në jetën shoqërore ishin kohë të turbullta, kohë dyshimesh, ankthesh e dilemash. Jehona e akuzave ndaj shqiptarëve, vazhdimësia e shtypjes dhe diferencimit kishin lënë pasojat në psikologjinë e shqiptarëve. Të marrurit me politikë në atë kohë për ne ishte dukuri jo e zakontë, një makth që shumëkush i shmangej, ndërsa padrejtësitë ishin të pranishme në çdo sferë të jetës. Jo çdokush merrte riskun e rrezikut për të sfiduar sistemin, për të thyer një koncept që sillte nënshtrim e diskriminim kombëtar. E kujtojmë mirë atë kohë, e ndjej si sot lëvizjen qytetare, formimin e degës se PPD-së, kryetar i së cilës ju zgjodhën Ju. Ishit Ju njeriu i duhur, intelektuali i duhur, veprimtari i duhur që nuk u step dhe nuk nguroi në asnjë çast në denoncimin e padrejtësive që i bëheshin kombit tonë dhe në përpjekjet që këto padrejtësi të eliminohen.

Qemal Xhafën e njihnim për principet dhe virtytet, për karakterin e fortë e të pathyeshëm, për korrektësinë dhe objektivitetin, për humanizmin dhe solidaritetin. Këto virtyte t'i njihnin familja, t'i njihnin shokët dhe miqtë tuaj të afërt, t'i njohën qytetarët, kolegët e punës në Dibër dhe jashtë saj. Ishe dhe mbete gjithmonë njeri i vendosur dhe i nderuar, i virtytshëm e fisnik, mbajtës premtimesh dhe besnik i pashembullt në jetë dhe në punë. Jeta të dërgoi të punosh e veprosh në vende të ndryshme. Punove në Kosovë, më vonë gjete punë në Dibër, si inxhinier, si kryetar komune e detyra tjera. Kurdo dhe në çdo kohë, në çdo punë e detyrë, në çdo situatë e rrethanë që u krijuan në jetën tuaj, në jetën familjare, në raporte me kolegë, me miq e me shokë, ju ishit shembull i njeriut të përgjegjshëm, i intelektualit të ditur dhe të vendosur që në jetë e cilëson ndershmëria, profesionalizmi, durimi, e shumë cilësi të tjera që e madhështojnë personalitetin tuaj. Ndaj dhe Dibra të nderoi, të vlerësoi dhe të zgjodhi të parin e vendit, Kryetar të Komunës së Dibrës në zgjedhjet e para të sistemit shumëpartiak. Qytetarët e saj të besuan dhe ju besimin jua kthyet me punë e ndershmëri, me angazhime për afirmimin e jetës kulturore dhe arsimore, me përpjekje të pandalshme për zhvillimin e Dibrës në ditët e saja të vështira.

Qemal Xhafa do të kujtohet ndër mote. Personaliteti i tij i dinjitetshëm me shpirt të pastër si kristali do të mbetet shembull i rrallë dhe i papërsëritshëm në historinë e Dibrës. Ju ka kujtuar dhe do t'ju kujtojë përjetësisht personeli i Universitetit të Tetovës si një nga tre kryetarët e komunave që nënshkruan aktin e themelimit të Universitetit të parë shqiptar në Maqedoni.

**Qemal Xhafën e njihnim për principet dhe virtytet, për karakterin e fortë e të pathyeshëm, për korrektësinë dhe objektivitetin, për humanizmin dhe solidaritetin. Këto virtyte t'i njihnin familja, t'i njihnin shokët dhe miqtë tuaj të afërt, t'i njohën qytetarët, kolegët e punës në Dibër dhe jashtë saj. Ishe dhe mbete gjithmonë njeri i vendosur dhe i nderuar, i virtytshëm e fisnik...**

Do të kujtoheni për angazhimet në pritjen dhe sistemimin e familjeve kosovare të dëbuar gjatë Luftës në Kosovë dhe për shumë e shumë aktivitete të tjera atdhetare. Do të kujtoheni gjithashtu edhe për përkrahjen që dhatë si kryetar komune në zhvillimin e aktiviteteve kulturore, simpoziumeve e konferencave shkencore në nivele kombëtare për njohjen e historisë dhe kulturës dibrane. Aktiviteti i juaj shfaqej në çdo moment dhe në çdo ngjarje që kishte të bëjë më jetën shoqërore dhe politike.

Do të desha të shkruaj shumë për ju, për personalitetin tuaj. Ju takonim në raste të ndryshme që i afron jeta me ngjarjet e saj. Na bënte përshtypje gjithnjë qëndrimi juaj i afërt me të gjithë, qëndrimi i një intelektuali që madhështohet nga fjala e urtë dhe mendimi i qartë.

Jeta ka dhe vuajtje, ka dhe dëshprime. Një fat i pamëshirshëm ju goditi me vdekjen aksidentale të djalit, Ilirit. Atë që se mban mali e mban dhe duron njeriu, thotë një flalë e urtë e popullit, e mban madhështia e shpirtit të tij. E thellë ishte dhembja juaj dhe e bashkëshortes suaj Shadies, e nuses së djalit, Artës me fëmijët: Rinori, Rina dhe Iliri, djali ivogël që mori emrin e babait, djalit tuaj të ndjerë. Ju e mbajtët thellë në shpirt dhembjen e pandalur që nuk rrëfehet. E vështirë për një baba dhe nënë që humbën më të dashurin e tyre, dritën dhe shkëlqimin e syve të tyre, për bashkëshorten dhe dy fëmijët që humbën prindin në moshë shumë të re, për motrat që humbën vëllanë e tyre të vetëm, për tërë familjen. Përtej dhimbjes mbeti mbresëlënës kujdesi juaj për jetën e familjes së gjërë, duke u përpjekur t'i përkrahje me sa mudësi kishit në rrugët e sukseseve dhe gëzimeve të tyre.

Një shpirt të tillë madhështor e pate dhe ruajte në jetë mik i nderuar. Qëndrimi i juaj, durimi dhe mbizotërim i dhembjes mbetet i veçantë. Ky qëndrim burrëror më kujton një varg të poetit të njohur Azem shkreli kushtuar vdekjes së malësorit, kur thotë: "Asnjë lot asnjë/ se ja shteroni krojet". Këto kroje të pashteruara për ju ishin vajzat, nipërit e mbesat, vllezërit dhe motra me të cilët jetoje dhe të cilët i deshe dhe i mbështete në të gjitha çastet e jetës. Ju ishit prindi që gjer në fund të jetës e mbajti shpresën e jetës dhe të gëzimeve për dy vajzat Valbonën në Dibër dhe Ulumbijen në Amerikë me bashkëshortët dhe fëmijët e tyre, për nipërit nga djali në Belgjikë dhe tërë farefisin. Vepra dhe mundi i juaj, fisnikëria e jetës suaj, madhështia e juaj shpirtërore dhe intelektuale do të mbetet krenaria e vajzave dhe nipërve dhe mbesës për babanë dhe gjyshin e tyre. Dashuria dhe kujdesi si baba dhe si gjysh do të rezatojë dhe do të ndikojë si një shembull i përkryer në jetën e tyre dhe në jetën e tërë fisit tuaj. Gjeni fisnik i familjes do rrugëtojë drejt virtyteve të larta që do të mbartin në jetë, se ata kanë një kapital familjar që do t'u ndriçojë rrugët e jetës së dinjitetshme.

Do të kalojnë ditët, muajt dhe vitet, por ju i nderuari Qemal do të mbeteni i paharruar në kujtesën familjare dhe mbarëqytetare. Do të kujtoheni gjithmonë me respekt si intelektuali mëi sinqertë, më i vendosur e më korekt i qytetit tonë, si atdhetari që e deshi Dibrën dhe Dibra e respektoi me nderimin më të thellë të qytetarëve të saj.


# Big market në Peshkopi

## Oferta të shumta

















Ulje të mëdha

*Hapur* 7:00 AM - 10:00 PM

Unaza e Vogel Peshkopi, Dibër, Albania

bigpeshkopia@gmail.com

cyan magenta yelloë black